

RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Për programin e studimit të Shkollës Doktorale në Shkenca Juridike Universiteti Europian i Tiranës

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Phd. Arnisa Gorezi

Dr. Juelda Lamçe

Dokt. Blerta Aliu

Tiranë, Prill 2013

RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Për programin e studimit të shkollës së doktoratës 'Dokoratë në Shkenca Juridike', Fakulteti Juridik, UET

HYRJE

Pas përgatitjes së gjatë për rritjen e standardeve akademike, thellimin e kërkimit shkencor dhe botimeve shkencore, si dhe zhvillimeve cilësore në procesin e mësimdhënies në programet e studimit në dy ciklet e para (Bachelor, Master Profesional dhe Master i Shkencave), të licencuara dhe akredituara, UET u vlerësua pozitivisht nga Këshilli i Akreditimit më 29 korrik 2011 se i plotëson kushtet për zhvillimin cilësor të programeve të studimit të ciklit të tretë, doktoraturës.

Programet e doktoraturës janë të reja, të konsultuara dhe të krahasueshme me ato që zhvillohen në universitete cilësore e prestigjioze ndërkombëtare.

Programi i studimit të doktoratës në Fakultetin Juridik, UET, është në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e arsimit të lartë dhe konkretisht bazohet mbi:

- Urdhërin Nr. 503, dt. 07-10-2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në “Shkenca Ekonomike”, “Shkenca Sociale”, dhe “Shkenca Juridike” të Universitetit Europian të Tiranës.
- VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 “Për ndryshimin e emërimit nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Europian i Tiranës, në “Universiteti Europian i Tiranës”;
- Statutin e Universitetit Europian të Tiranës.
- Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e programit, Nr.14, Datë 22.12.2010.

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)

Raporti është përgatitur nga Grupi *ad-hoc* i ngritur për këtë qëllim në Fakultetin Juridik, me Urdhër të Rektorit të UET-it, nr. 2, dt. 06.03.2013. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca e tyre profesionale, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkallën e nevojshme të njohjes, si dhe reputacionin e anëtarëve të Grupit. Grupi ka një strukturë organizative me drejtuesin e tij dhe anëtarët, ku një prej tyre është përfaqësuese e studentëve doktorantë.

Përbërja e GVB *ad-hoc* për Fakultetin Juridik është si më poshtë:

1. Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku (kryetar)
2. Prof. Dr. Ksenofon Krisafi (anetar)
3. Phd. Arnisa Gorezi (anetar)
4. Dr. Juelda Lamçe (anetar)
5. Dokt. Blerta Aliu (anetar, përfaqësuese e studentëve doktorantë)

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me përkushtim dhe përgjegjësi të qarta. Në konsultim me personelin akademik dhe studentë, anëtarët e Grupit në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të Programeve që i nënshtrohen

akreditimit, ecurisë së personelit akademik përgjegjës për realizimin e tyre; në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si dhe kanë evidentuar parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, aktet nënligjore përkatëse në fuqi, në mënyrë të veçantë udhëzimet e APAAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it.

Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat statistikore që nevojiten për procesin e akreditimit, të cilat të strukturuar në formën e tabelave janë përfshirë në Raport.

Në mbështetje të Raportit është përgatitur Dosja e Vlerësimit të Brendshëm, në përbërje të së cilës vend qendror zë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm. Në përmbajtjen e Dosjes përfshihet edhe dokumentacioni në mbështetje të vlerësimit.

POLITIKAT E DREJTIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike të UET

Në statutin e Universitetit European të Tiranës, shprehet qartë Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike të UET, dhe Programi i Studimit të doktoratës në Fakultetin Juridik është në përputhje të plotë me to.

Vizioni i UET: Të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve tanë, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike, juridike, të edukimit e të teknologjisë së informacionit në vend, me ndikim në rajon e më gjerë, si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor në drejtimet specifike ku zotëron potencial.

Misioni i UET: T'u japë studentëve një edukim cilësor, *duke përkthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm*, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare.

Për realizimin e Vizionit dhe Misionit të tij, UET-i ka keto Objektiva Strategjike:

- Arritjen e ekselencës në të gjitha fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit;
- Mbajtjen e një profesorati të shquar që zotëron vlerat dhe aftësitë më të larta profesionale;
- Cilësinë e lartë në proceset akademike dhe të infrastrukturës së institucionit;
- Pajisjen e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisin dijet, aftësitë dhe eksperiencën e tyre të vlefshme;
- Ndërtimin e urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Krijimin e një mjedisi nxitës e zhvillues për profesoratin, punonjësit dhe studentët;
- Sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm për ndjekjen e ekselencës;
- Sigurimin e fleksibilitetit dhe përgjegjshmërisë.

Në Statutin e UET cilësohet që “Studime të ciklit të tretë” do të thotë studimet në programet e studimeve të Doktoratës. Programet e studimeve të Doktoratës janë me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura. Këto studime zgjasin të paktën 3 (tre) vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite të studimeve të organizuara. Në përfundim të programeve të studimit të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr). Për administrimin e këtyre programeve, në UET ngrihet Shkolla Doktorale.

Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi i studimit të doktoratës në Fakultetin Juridik është organizuar brenda një projekti të madh kerkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur dhe është duke u realizuar në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarive të kerkimit të Universitetit European të Tiranës. Objektivat formuese të programit të studimit të doktoratës janë të gjera, të motivuara dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushën e zgjedhur.

Formimi i Doktorit të Shkencave kërkon që një pjesë e studimeve të thelluara teorike (30 kredite) të zhvillohet nën drejtimin e profesorëve të huaj, në UET ose në Universitetin e Astonit, në Birmingham, UK dhe Universitetin Politeknik të Tiranës si dhe kryerjen e punës kërkimore në universitete ose institute kërkimore jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (tre) mujore dhe jo më të gjatë sesa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës. Universiteti European i Tiranës, *Fakulteti Juridik, UET i ofron programet e doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Astonit, Birmingham, UK* dhe Universitetin Politeknik të Tiranës në të janë angazhuar edhe pedagogë të njohur të universitetit shqiptar (Universiteti i Tiranës), Shkolla e Magjistraturës apo nga SEEU, Maqedoni dhe Universiteti AAB, Kosove.

Programi përmban veprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thelluar teorik, të përvetësimit të metodologjive të kerkimit dhe të teknikave operative të posaçme, të realizuara nëpërmjet moduleve mësimore, seminareve me kualifikim të lartë, periudhave të kerkimit pranë strukturave të kualifikuara etj. Këto veprimtari janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe janë të lidhura me objektivat formues të programit të studimit të doktoratës dhe gjithashtu janë të kontrollueshme. Programi përfshin kerkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur si bazë për punimin e tezës së doktoratës dhe mbrojtjen e suksesshme që çon në marrjen e gradës "Doktor".

Ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën

Programi i studimit të doktoratës në Shkenca Juridike, është një shkallë e avancuar e studimit dhe kerkimit universitar i cili kërkon që të ofrojë në përputhje me filozofinë e Universitetit Evropian të Tiranës, trajtim dhe zgjidhje për problemet me të cilat përballet shoqëria bashkëkohore shqiptare nëpërmjet krijimit të kërkuesve/shkencëtarëve të cilët kanë një formim akademik që u lejon të ofrojnë një mendim të thelluar shkencor, një mendim analitik të plotë. Gjithashtu, Universiteti European i Tiranës ka vënë në dispozicion të kandidatëve për doktorë, infrastrukturat, metodologjitë, dhe informacionet shkencore më të plota dhe të gjera në fushën e shkencave juridike.

Ky program i doktoratës, për vetë fushat e studimit në të cilat zhvillohet, ka një qasje të gjerë rreth problemeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria shqiptare, në një shoqëri dinamike që po zhvillohet me ritme progresive, duke pasur parasysh zhvillimet e brendshme dhe ato ndërkombëtare si dhe proceset integruese të vendit. Kandidatët për gradën shkencore doktor, janë duke kryer një studim të thelluar në një fushë të përcaktuar qartë të problemeve juridike, në të cilën do të dëshmojnë një qasje analitike e të thelluar studimore, si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik, në përputhje me problemet e shoqërisë sonë. Kjo synohet të arrihet duke zhvilluar marrëdhënie të ngushta pune e bashkëpunimi me një ose më shumë pedagogë dhe duke shkruar si bashkautorë me ta studime, kumtesa apo artikuj.

Programi i studimit të doktoratës në Fakultetin Juridik, në Universitetin European të Tiranës, përfshihet në ciklin e tretë të studimeve universitare, dhe në përfundim të tij lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor". Ai ka kohëzgjatje së paku 3 (tre) vjeçare si më poshtë:

- Viti I Formim i thelluar teorik/60 ECTS
- Viti II Veprimtari kërkimore
- Viti III Kërkim/krijim/përpunim të dhënash/botime/referime/mbrojtje teze

Në "Rregulloren për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës", janë të shprehura qartë afatet e përfundimit të programit të studimit.

Organizimi dhe veprimtaria e Programit të Studimit të Doktoratës në Shkenca Juridike bazohet në:

- Ligi nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM Nr. 864, datë 5.12.2007, "Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotesojë studentit, për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor," i ndryshuar;
- VKM Nr. 796, datë 22.7.2009 "Për Hapjen e Programeve të Reja të Studimit, "Master i Nivelit të Dytë", Pranë Shkollës Së Lartë Universitare, Private, "Universiteti Europian i Tiranës"
- Udhëzim MASH Nr. 24, Datë 2.9.2009 "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Udhëzimin Nr. 30, Datë 26.9.2007 "Për Përcaktimin e Procedurave dhe Dokumentacionit që Duhet të Paraqesë Subjekti Juridik, për Hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë ose Programeve të Studimit, në Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë të Studimeve", të ndryshuar;
- Udhëzim MASH Nr. 5, datë 22.1.2008 "Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementëve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse";
- Udhëzim MASH Nr. 20, datë 29.7.2009 "Për disa ndryshime në shtojcën 1 të udhëzimit Nr. 5, datë "Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementëve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse";
- Udhëzim MASH Nr. 21, datë 30.7.2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë";
- Udhëzim MASH Nr. 39, datë 08.12.2009 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 21, datë 30.7.2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë".
- Udhëzim MASH Nr. 22, datë 14/09/2012 (i cili do të fillojë të zbatohet nga ky vit e tutje)
- Urdhri Nr. 503, datë 07-10-2011 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, për "Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në "Shkenca Ekonomike", "Shkenca Sociale", dhe "Shkenca Juridike" të Universitetit Europian të Tiranës.
- VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 për ndryshimin e emërimit nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës, në "Universiteti Europian i Tiranës";
- Statutin i Universitetit Europian të Tiranës.
- Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e programit, Nr.14, Datë: 22.12.2010.

Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit

Viti I -- Formim i thelluar teorik

Viti i parë synon një formim të thelluar teorik në fushën e zgjedhur juridike, përvetësimin e metodologjive të kërkimit dhe aplikimin e këtyre metodologjive në mënyrë të pavarur në fushën e interesit të studentit. Studentët e vitit të parë të doktoratës ndjekin programin e teorik (60 ECTS) që ofron UET; një pjesë e krediteve merren përmes lëndëve të zhvilluara nga lektorë të huaj të Universitetit të Astonit, Birmingham, UK. Në varësi të interesit të tyre, kandidatët përzgjedhin drejtimet 'E drejtë Publike', 'E drejtë private' me profilet respektive që ofrohen në këto dy drejtime. Në fund të vitit të parë ata testohen në një provim për gjendjen teorike të disiplinës (10 ECTS)- *comprehensive exam*- i cili synon të testojë themelin e formimit të tyre teorik. Programi i këtij provimi përbëhet nga një listë tekstesh klasikë dhe të rinj, të cilët përfaqësojnë kontributet kryesore në fushën juridike. Pasi kanë grumbulluar 60 ECTS kandidatët mund të kalojnë në vitin e dytë të doktoratës. Plani mësimor për vitin e parë është ndërtuar dhe përputhet plotësisht me legjislacionin në fuqi. Studentët e vitit të parë aktualisht ndjekin një program teorik prej 7 lëndësh, 4 të përbashkëta dhe 3 të specialitetit apo profilit të zgjedhur prej tyre. Lëndët e propozuara janë

të përshtatshme në raport me objektivat dhe vetë përmbajtjen e këtij programi studimi. Ato reflektojnë më së miri dhe eksperiencën e strukturën e lëndëve që universitete cilësore përëndimore ofrojnë në cikle të ngjashme studimesh doktorate.

Viti II -- Veprimtari kërkimore

Në vitin e dytë të studimeve doktorale kandidati zgjedh temën e disertacionit të doktoraturës, e cila miratohet nga Këshilli i Profesorëve i universitetit. Bashkë me miratimin e temës dhe udhëheqësit, nga udhëheqësi shkencor miratohet plani individual i punës studimore-kërkimore të kandidatit. Menjëherë pas kësaj, kandidati nis punën kërkimore duke mbledhur të dhënat e nevojshme në terren (në rast se studimi ka karakter empirik), apo në burime të tjera informacioni sipas rastit. Në fund të vitit të dytë, kandidati duhet t'i paraqesë për miratim udhëheqësit shkencor propozimin për dizertacionin e doktoraturës, apo "prospectus". Sugjerohet fort që brenda vitit të dytë të studimeve doktorale, studenti të mund të paraqesë një punim nga tema e disertacionit të tij në një konferencë apo seminar shkencor dhe, mundësisht, të ketë botuar një artikull (si autor i vetëm apo si bashkautor) në një revistë shkencore, brenda apo jashtë vendit, apo të ketë marrë zyrtarisht konfirmim për botimin e tij nga redaksia e një reviste shkencore. Studentët kalojnë në vitin e tretë pasi të kenë dëshmuar njohjen e gjuhës angleze, përmes testeve të njohura ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi.

Viti III -- Kërkim / krijim + përpunim të dhënash + botim artikujsh + referime

Gjatë vitit të tretë, kandidati vazhdon të thellohet në punën e tij studimore. Ai analizon teorikisht dhe përpunon të dhënat e mbledhura dhe fillon të shkruajë disertacionin. Në proces e sipër, studenti punon për të paraqitur një kumtesë tjetër nga tema e disertacionit në një konferencë apo seminar shkencor dhe të botojë artikuj (si autor i vetëm ose në bashkautorësi) në revista shkencore, brenda apo jashtë vendit. Kandidati harton tezën e doktoraturës dhe e mbron atë sipas procedurës së përcaktuar nga ligji dhe rregullorja e programit të studimit.

Një element mjaft i rëndësishëm procedural i studimeve doktorale është fakti që pedagogët udhëheqës së bashku me doktorantët e tyre janë të ndarë sipas profileve të Programit të Studimit, më tej sipas Drejtimeve të Mëdha Kërkimore brenda Profileve, duke pasur në konsideratë Akset Kërkimore të çdo pedagogu. Kjo gjë bën që studentët gjatë udhëheqjeve të tyre të punojnë në grupe të vogla pune në formën e "klasave doktorale" duke shkëmbyer eksperiencën e tyre me njëri-tjetrin.

Gjithashtu garantimi i zbatimit të standardeve të kërkimeve shkencore në zhvillimin e programit të doktoratës vjen si rezultat edhe i verifikimit dhe pranimit të propozimit doctoral, (si një prej elementëve më thelbësore, që mundëson ndërjegjesimin e studentëve për temën që ata dëshirojnë të kërkojnë, si edhe mundësimin e përshtatjes më të mirë midis udhëheqësve shkencore dhe doktorantëve) që doktorantët dorëzojnë që në momentet e para të regjistrimit të tyre, organizimit të ditëve doktorale, koomisioneve të ditëve doktorale, dhe më tej të verifikimit të dosjeve të tyre prej Këshillit të Profesorëve, gjë që mundëson që programi i studimeve të doktoratës të sigurojë harmonizim të synimeve të studentit në fushën kërkimore-shkencore, projekteve kërkimore të miratuara.

Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor

Kreditet teorike: Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoraturës studenti ndjek lëndët e parashikuara në programin përkatës, sipas planit mësimor të miratuar, për të grumbulluar 50 kredite, nga të cilat një pjesë e krediteve merren ose përmes kurseve të zhvilluara nën drejtimin e personelit akademik të huaj, në UET ose në Aston University, UK. Studenti i cili ka përfunduar ose vijon studimet në një program studimi të ciklit të tretë mund të transferojë kreditet e fituara në programin e doktoraturës, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit.

Provimi për gjendjen teorike të disiplinës. Në fund të vitit të parë studenti i nënshtrohet një provimi që përbën themelin e formimit të tij teorik dhe ka peshën e 10 krediteve. Nënshtrimi ndaj këtij provimi është detyrim për cilëndo kategori studentësh të regjistruar në programet e doktoratës. Provimi për gjendjen teorike të disiplinës jepet mbi bazën e një liste librash të hartuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale, dhe të miratuar nga Këshilli i

Profesorëve. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një Komisioni i përbërë nga 5 (pesë) profesorë të fushës kërkimore përkatëse ose të përafërt me të. Kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e doktoratës. Pasi ka grumbulluar 60 kredite studenti kalon në vitin e dytë të doktoratës.

Detyrimet e tjera akademike: Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, përpara paraqitjes në provimin e doktoratës, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë realizuar, si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje duhet të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare, në një vend të zhvilluar (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuara me kod ISBN-je.

b) Të ketë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku dy prej artikujve duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të njohura të vendeve të zhvilluara sipas listës së miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të KALSH-it, KVTA-së dhe Konferencës së Rektorëve;

c) Të ketë përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e Profesorëve dosjen e plotë që përmban edhe disertacionin e përfunduar. Disertacioni paraqitet në shqip, shoqëruar me përmbledhje në shqip dhe anglisht (rreth 20 mijë fjalë), të miratuar nga udhëheqësi shkencor i studentit, së bashku me një përmbledhje, të miratuara nga udhëheqësi shkencor.

d) Të ketë dhënë provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.”

Pas shqyrtimit të dosjes, Këshilli i Profesorëve i përcjell Drejtorit të Shkollës Doktorale vendimin për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës. Kur Këshilli i Profesorëve vendos pozitivisht, ai i propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale edhe jurinë për mbrojtjen e doktoraturës.

Të paktën një herë në vit, studenti raporton përpara një komisioni të përbërë nga Drejtori i Shkollës Doktorale, Koordinatori i programit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe udhëheqësi shkencor i temës, komisioni i cili vendos për vazhdimin normal të programit nga kandidati ose për plotësimet e nevojshme. Nëse nga këto analiza arrihet në përfundimin se studenti nuk është i aftë për vazhdimin e mëtejshëm të programit, komisioni mund t'i propozojë Këshillit të Profesorëve ç'rregjistrimin e tij nga programi.

Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit

Në Urdhërin Nr. 503, datë 07/10/2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në “Shkenca Ekonomike”, “Shkenca Sociale”, dhe “Shkenca Juridike” të Universitetit European të Tiranës”, specifikohet *Dokoratë* në “Shkenca Juridike” me profile:

- o E drejtë publike
- o E drejtë ndërkombëtare
- o E drejtë civile
- o E drejtë biznesi

Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Programi i studimit të doktoratës në Shkenca Juridike bazohet totalisht mbi objektivat kryesore për mbështetjen dhe realizimin e Strategjisë së UET për Mësimdhënien, përvetësimin e dijeve dhe kërkimin shkencor, të cilat përmbliken si më poshtë:

- o Edukimi i studentëve për një jetë qytetare aktive me impakt në zhvillimin e shoqërisë dhe promovimin e standardeve të demokracisë në Shqipëri.
- o Zhvillimi dhe konsolidimi i një baze të gjerë e të përshtatshme dijesh në shërbim të vendit.

- Formimi i një force pune të kualifikuar për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi dhe atij rajonal në veçanti.
- Përmbushja e aspiratave të brezit të ri për zhvillim.

Për të përmbushur këto objektiva, duke u mbështetur në nevojat e shoqërisë, UET krijon, zhvillon dhe transmeton njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në funksion të përditësimit dhe zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve si të mësimit dhe ofrimit të shërbimeve. Për realizimin e objektivave të mësipërme, UET punon dhe do të punojë në pesë orientime strategjike në vitet e ardhshme:

- *Sigurimi i shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, përshtatja e metodave dhe e niveleve të financimit për to dhe zgjerimi i sistemit, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.*
- *Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve në UET, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë.*
- *Përmirësimi i jetës studentore, eksperiencës universitare, shtrirja dhe diversifikimi i mundësive të studentëve për të zhvilluar karrierën e tyre si qytetarë të së ardhmes.*
- *Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve mbështetëse akademike në mënyrë që të plotësohen nevojat e UET me auditore cilësore, laboratore, biblioteka në perspektivën e arritjes së standarteve për integrimin në Bashkimin Europian (BE) dhe HEAL (në kuptimin treguesve për shkollimin terciar të popullsisë psh: hapësira akademike për numër studentësh, numri i studentëve në auditore, numri i pedagogëve për studentë, bibliotekat pasive, bibliotekat virtuale etj).*
- *Përmirësimi i mekanizmave të qeverisjes nëpërmjet zhvillimit të parimit të subsidiaritit, përkundrejt rritjes së cilësisë së menaxhimit me llogaridhënie dhe transparencë, në mënyrë që UET të funksionojë realisht si institucion demokratik.*

Me realizimin e këtyre prioriteteve UET-i angazhohet për të krijuar një mjedis që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë komunitetin universitar në arritjen e qëllimeve të tyre akademike dhe në realizimin e potencialit të tyre në përmbushjen e misionit të UET-it. Kjo strategji nuk përfaqëson vetëm iniciativa, por reforma në proces për zhvillimin e Universitetit.

Strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata

Ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka qenë një hap i rëndësishëm përpara për përmirësimin e sistemit. Mbështetur në këtë ligj, Universiteti Europian i Tiranës (UET), nëpërmjet *Strategjisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve (MPD)* shtron synime dhe objektiva afatgjatë për zbatimin e tij dhe paraqet politikat për prioritetet strategjike në mësimdhënie dhe përvetësim dijesh për vitet që pasojnë deri në vitin 2015-tën.

Strategjia është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të Arsimit të Lartë (AL) në Shqipëri, Europë dhe në botë, dhe në veçanti, me procesin e Bolonjës; qëllimi i saj është të përmirësojë mësimdhënien dhe përvetësimin e dijeve në nivel cilësor që UET të zerë vendin që i takon brenda Hapësirës Shqiptare të Arsimit të Lartë duke synuar Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL).

Strategjia pasqyron vizionin e UET për politikat afatmesme dhe afatgjata në mësimdhënie dhe përvetësim dijesh. Në të janë përfshirë sugjerimet e botës akademike dhe të grupeve të interesit brenda institucionit (UET) si dhe ato të ekspertëve të arsimit të lartë në Shqipëri. Një nga synimet themelore të Strategjisë është që UET të shndërrohet realisht në një Universitet privat në nivel cilësor. Ky transformim do të kërkojë përmirësime të mëtejshme të qeverisjes dhe menaxhimit të UET-së, si dhe ndryshime për përmirësim në mekanizmat e sigurimit të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme.

Strategjia e Kërkimit Shkencor

Vizioni i UET ka parasysh shndërrimin e Universitetit në një *qendër ekspertize* të specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, juridike, ekonomike dhe teknologjisë së informacionit. Synim i mëtejshëm është kthimi i UET në një *qendër ekselence* që të japë produkt cilësor në drejtime specifike të kërkimit shkencor, atje ku potenciali ekzistues e lejon këtë mundësi, me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me ndikim rajonal e më gjerë. Këto synime, UET përpiqet t'i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm.

Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së nivelit të kualifikimit dhe shkallës së ekspertizës të stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore (referime në konferenca e seminare shkencore, botime etj).

UET angazhohet në ndërtimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të një infrastrukture të kërkimit shkencor, për t'i dhënë frymëmarrjen e duhur punës studimore të stafit akademik të vetë UET, si dhe bashkëpunimit me institucione analoge. Kjo do të arrihet përmes tërheqjes së fondeve të akorduara nga institucionet publike, private dhe organizma të tjerë, brenda dhe jashtë vendit.

Dokumenti i *Strategjisë së Kërkimit Shkencor* pasqyron frymën/ filozofinë e realizimit të synimeve të mësipërme të UET. Konkretizimi i saj realizohet nëpërmjet katër përbërësve themelore: *mekanizmave të zbatimit*, të cilat përpunohen nga *Njësitë kryesore*, përpunimit të *planeve të integruara* që realizohet nga Dekanatet; procesit të *monitorimit* dhe *vlerësimit*, që përbën një detyrë parësore të *Këshillit të Shkencës*; dhe *financimit* të projekteve shumëdisiplinore, që miratohen nga *Shkolla Doktorale* dhe *Qendra UET*.

Zbatimi i Objektivave të Strategjisë

Planifikimi Strategjik i Universitetit nënkupton një proces ciklik, i cili fillon me vendosjen e *Objektivave Strategjike* dhe vazhdon me *përzgjedhjen*, duke u mbështetur në cilësinë, rigorozitetin shkencor dhe rëndësinë akademike e praktike të projekteve specifike që do të zbatohen. Zhvillimi i *Strategjisë së Kërkimit Shkencor (SKSH)* mbështetet në rëndësinë e efektivitetit që sjellin mekanizmat e rishikimit periodik të prioritetëve të kërkimit shkencor, si dhe të vlerësimit të mundësive dhe kërcënimeve.

Indikatorët Kritikë të Suksesit (IKS) zhvillohen për ndjekjen e realizimit të synimeve të UET për kërkimin shkencor, njëkohësisht ato shërbejnë për përcaktimin e rezultateve të pritshme që lidhen sidomos me objektivat bazë të *Strategjisë*. *IKS* listohen në *Strategji* me shembuj konkrete të produktit bazë. *Plani i Veprimit*, në mbështetje të realizimit të *Objektivave*, synon realizimin e *IKS*, të cilat miratohen në mbledhjet e *Këshillit të Profesorëve të Shkollës Doktorale* në fund të çdo viti akademik.

Planet e Integruara të Kërkimit Shkencor detajohen me afate kohore të realizimit të veprimeve, ato hartohen dhe plotësohen me përgjegjësitë konkrete për secilën nga hallkat e UET-it, që nga ato akademike (*Njësitë kryesore bazë*) deri te ato administrative dhe mbështetëse, duke përfshirë kostot financiare. *Raporti* përfundimtar mbi progresin e bërë në drejtim të realizimit të veprimtarive kërkimore dhe *IKS* i paraqitet *Këshillit të Profesorëve* dhe miratohet prej tij në mesin e muajit korrik të çdo fundviti akademik.

Duke filluar nga viti akademik 2010-2011, UET ka një pozicion të ri dedikuar posaçërisht Kërkimit Shkencor, që është pozicioni i *Zv/Rektore*s për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. Ky pozicion synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor që nga fakultetet/departamentet, Shkolla Doktorale dhe pasurimi i përhershëm i bibliotekës, si dhe ruajtja e standardeve të botimit në revistat shkencore të UET.

Kërkimi shkencor në UET zë një vend qendror dhe është baza e mësimdhënies për personelin akademik. Kërkimi shkencor bazohet në tre shtylla: Shkollën Doktorale, Revistat shkencore, si dhe Biblioteka dhe njësia e lëndëve metodologjike në UET, nga niveli Bachelor deri në atë Doktorat. Aktorët të cilët përfshihen në të tre shtylla janë së pari departamentet si dhe Qendra UET. *Zv/Rektori* për Kërkim Shkencor dhe Metodologji

bashkëpunon ngushtë me Qendrën UET për Projekte dhe Kërkim Shkencor, me synim koordinimin e burimeve njerëzore për projekte të ndryshme kërkimore.

Shkolla Doktorale dhe Kërkimi Shkencor

Shkolla doktorale ka një rëndësi kyçe, sepse nxjerr hulumtuesit e parë dhe punonjësit e parë shkencorë të përgatitur në UET. Po ashtu, Shkolla doktorale ofron udhëheqje shkencore për kandidatet dhe strukturon punën kërkimore të stafit akademik sipas drejtimeve specifike kërkimore.

Në bashkëpunim me Fakultetin Juridik, Shkolla Doktorale në UET ka strukturuar kërkimin shkencor dhe drejtimin e punës kërkimore të kandidatëve sipas Drejtimeve Kërkimore për programin e studimit. Drejtimet Kërkimore të Programit të Studimit udhëhiqen nga pedagogë dhe studiues me gradën më të lartë dhe numrin më të madh të botimeve në fushën përkatëse dhe përbëhet si nga studentë doktoralë, ashtu dhe nga 3 deri në 5 udhëheqës doktoralë. Konferencat doktorale strukturohen sipas Drejtimeve Doktorale. Organizimi sipas Drejtimeve Kërkimore synon të arrijë të paktën tre objektiva: së pari, të prodhojë ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në një fushë të caktuar dhe të kthejë Fakultetin Juridik (UET) në një burim të vazhdueshëm dijeje dhe konsulence si për komunitetin akademik, ashtu dhe për aktorë të tjerë; së dyti, rritja profesionale e stafit akademik dhe kërkimor të Fakultetit Juridik (UET) brenda ekspertizave dhe fushave të tyre të interesit shkencor; së fundmi, krijimi i një ose disa komuniteteve kërkimore, të cilët ndërveprojnë vazhdimisht me njëri tjetrin në funksion të gjetjeve dhe analizave sa më të arrira dhe bindëse.

Revista Shkencore Jus&Justicia

Fakulteti Juridik boton periodikisht dy herë në vit revisten shkencore ‘Jus&Justicia’ ku artikujt për botim i nënshtrohen procesit të ‘blind review’ ose recensimit anonim. Çdo numër i revistes paraprihet nga një ‘Thirrje për Kontribute’ të redaksisë, shoqëruar me kriteret që duhet të plotësojnë të interesuarit për botim, përcaktuar këto në Rregulloren e Revistës.

Revista shkencore “Jus&Justicia” është konceptuar për të shërbyer si periodik në funksion të formimit shkencor e profesional të stafit akademik, studentëve, por edhe të punonjësve të praktikës. Revista i shërben çdo mjedisi akademik dhe kërkimi shkencor brenda dhe jashtë UET-it. Në të, gjejmë pasqyrim risitë dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e së drejtës, qasja krahasimore, problematika që haset në praktikë, dhe nga kjo pikëpamje këto punime përmbajnë jo vetëm vlerë në pasqyrimin e aspektit teorik e doktrinar kontemporan por edhe vlerë praktike.

Departamentet

Departamenti si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive, nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik.

Po ashtu, një nga mbledhjet mujore në çdo departament ka për tematikë kërkimin shkencor brenda departamentit, zhvillime të reja në fushën e botimeve, promovimin dhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca, etj. Çdo departament i fakultetit harton planin e aktiviteteve dhe veprimtarive kërkimore, brenda vitit akademik dhe/ose kalendarik, i cili ndiqet me pas për zbatim. Ky plan i dorëzohet në fillim të vitit akademik Zv/Rektorit për Kërkim Shkencor dhe Metodologji, për ta integruar në planin e përgjithshëm të aktiviteteve në UET.

Përgjegjësi i Departamentit organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe shkencor të Departamentit. Ndër të tjera ai shqyrton planet mësimore dhe programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme; shqyrton dhe jep mendim për tekstet mësimore që do të përdoren; ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies, etj. Ai përgjigjet për shpërndarjen e ngarkesës mes pedagogëve si dhe ndjekjen e realizimit të saj, përfshirë këtu edhe aktivizimin në shkollën e doktoratës, dhe bashkëpunon për këtë qëllim me drejtuesit e Shkollës Doktorale.

Përshtatja e Programeve të Studimit me Vizionin, Orientimet dhe Strategjinë për Zhvillim të Institucionit

Shqipëria në shekullin XXI, si kudo në Europë, do të ketë nevojë për njerëz që kanë shprehur fleksibël dhe të adaptueshme të të menduarit, të analizës, krijimtarisë dhe zgjidhjes së problemeve, si në ekonomi ashtu edhe më gjerë për shoqërinë. Nevojat e të ardhmes së vendit kërkojnë nga të tre ciklet e ofertës akademike sigurimin e këtyre shprehive dhe ky është ndryshimi më i rëndësishëm që i nevojitet tërë sistemit universitar.

Aktualisht, oferta akademike e UET, ka arritur nivelet e standartizuara nga APPAL, e provuar kjo edhe nga akreditimet e marra për ciklin e parë, të dytë dhe stadin fillestar të ciklit të tretë (MND). Ndërkohë, për të përmirësuar cilësinë e ofertës akademike, kërkohet vazhdimisht zhvillimi dhe rifreskimi i saj. Në këtë kontekst, UET perpiqet vazhdimisht të fuqizojë programet ekzistuese, në mënyrë që këto të fundit të vazhdojnë të operojnë me këto standarde, dhe, për më tepër, të garantojë që çdo nismë për hapjen e programeve apo cikleve të reja, të plotësojë kriteret dhe standardet e përcaktuara.

Zgjerimi i UET është një prioritet që do të ndiqet në vijimësi, por pa cënuar cilësinë. Ky zgjerim nuk mund të jetë më i shpejtë se rritja e kontigjentit të përshtatshëm për shkollim të lartë, që kushtëzohet nga evolucioni i sistemit parauniversitar dhe mbi të gjitha nga politikat publike të Arsimit të Lartë në Shqipëri, si dhe numri i studentëve që duan t'i ndjekin studimet jashtë. Ky zgjerim, me afro 3.000 studentë për një periudhë 5-vjeçare, është rrjedhojë e (i) rritjes së pritshme vjetore të kontigjentit të nxënësve që përfundojnë me sukses shkollën e mesme, (ii) hapjes së programeve të reja të ciklit të dytë (master profesional), dhe (iii) zgjerimit të UET me programet doktorale. Ky objektivi zgjerimi është ambicioz sidomos në kushtet e rritjes së ndjeshme të % së studentëve në universitetet publike dhe në kushtet e një tregu ende informal të universiteteve private.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | | Vlerësimi sipas standardit/ kriterit¹ |
|--|---|--|
| Standardi I.1 - Kuadri i përgjithshëm | | |
| Kriteri 1 | Programi i studimit i ciklit të tretë (doktoratë) është një program i ri apo një program i riorganizuar; | Kriteri 1 Programi i studimit i ciklit të tretë (doktoratë) është një program i ri, hapur në bazë të Urdhërit Nr. 503, datë 07/10/2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për "Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në "Shkenca Ekonomike", "Shkenca Sociale", dhe "Shkenca Juridike" të Universitetit European të Tiranës'. |
| Kriteri 2 | Nëse është i riorganizuar, në ç`masë e ka prekur ai programin e mëparshëm; | Kriteri 2 N.A |
| Kriteri 3 | Numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit është në përputhje me politikat e Institucioneve të Arsimit Lartë (IAL) ku zhvillohet programi si dhe me politikat shtetërore për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës dhe me raportin e numrit të doktorantëve për një | Kriteri 3 Numri i përgjithshëm i doktorantëve që e ndjekin këtë program studimi, për vitin akademik 2011-2012 dhe 2012-2013 është 126. Aktualisht kane fituar të drejtën për të vazhduar në vitin e dytë të studimit (sipas ligjit të Arsimit të Lartë dhe Rregullores së Programit të Studimit) 18 studentë doktorantë. Procesi është në vazhdim sepse provimi i radhës i provimit për gjendjen teorike të disiplinës |

¹ GVB duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

| | | |
|-------------------------|--|---|
| <p>Kriteri 4</p> | <p>udhëheqës shkencor;</p> <p>Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga grupe kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare të akredituara për kërkim në fushën a fushat përkatëse të studimeve;</p> | <p>(comprehensive exam) do të jetë në muajin Prill 2013.</p> <p>Ky numër është në përputhje me politikat e UET, si një angazhim i Fakultetit Juridik në Programin e Studimit të Doktoratës në Shkenca Juridike, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e programit, Nr.14, Dt. 22.12.2010; si dhe me politikat shtetërore për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës dhe me raportin e numrit të doktorantëve për një udhëheqës shkencor.</p> <p>UET kryen veprimtari mësimore e kërkimore duke ndërthur, në mënyrë të integruar dhe në përputhje me planet mësimore, mësimdhënien me kërkimin shkencor, (të organizuar ose të pavarur); kryen këtë veprimtari në përputhje dhe në zbatim të ligjit Nr 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij; është i akredituar institucionalisht me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009, dhe po ky urdhër ka akredituar edhe programet e ciklit “Bachelor” dhe me urdhër Nr. 68 datë 14.02.2011, UET është akredituar për programet “Master i shkencave” dhe “Master profesional”; numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit është në përputhje me politikat shtetërore për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës.</p> <p>Përsa i përket raportit të numrit të doktorantëve për një udhëheqës shkencor, ai është totalisht në përputhje me këto politika dhe me konkretisht sipas Udhëzimit Nr.21, datë 30.7.2009 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe kjo garanton cilësinë e doktoraturave dhe formimin shkencor e kërkues të doktorantëve.</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Programi i studimeve të doktoratës si program i ri ndonëse nuk ka një mbështetje nga grupe kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare të akredituara për kërkim në fushën a fushat përkatëse të studimeve, por megjithatë ka një bashkëpunim me institucione të akredituara ndërkombëtare që kanë kontribuar në këtë program;</p> |
|-------------------------|--|---|

| | | |
|---|---|--|
| <p>Kriteri 7</p> | <p>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit të ciklit të tretë shqyrtohet nga Këshilli i Profesorëve.</p> | <p>Vendimi i Senatit të UET dt. 22.12.2010 reflekton kërkesat ligjore në lidhje me organizimin e programeve të doktoraturave.</p> <p>Universiteti European i Tiranës i ofron programet e doktorates në bashkëpunim me Universitetin e Astonit, Birmingham dhe Universitetin Politeknik të Tiranës.</p> <p>Formimi në këtë program studimi kërkon që një pjesë e studimeve të thelluara teorike të zhvillohet nën drejtimin e profesorëve të huaj, në UET ose në Universitetin e Astonit, në Birmingham, UK, si dhe kryerjen e punës kërkimore në universitete ose institute kërkimore jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (tre) mujore dhe jo më të gjatë sesa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës. Gjithashtu në këtë program marrin pjesë pedagogje prej universiteteve të ndryshme të vendit si: Universiteti i Tiranës, etj.</p> <p>Kriteri 7 Këshilli i Profesorëve në UET është organi përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës. Sipas Statutit të universitetit privat “Universiteti European i Tiranës” Këshilli i Profesorëve ngrihet në nivel universiteti. Ai drejton studimet e Doktoratës dhe të kualifikimit shkencor të personelit akademik në UET. Në “Rregulloren për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës”, pika 5.1. shprehet “Këshilli i Profesorëve, shqyrton raportin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit të doktoratës”. Në përputhje me të, ky Raport i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit të ciklit të tretë është shqyrtuar dhe aprovuar nga Këshilli i Profesorëve, në UET.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Prej vlerësimit të kriterëve vërehet se Standarti I.1 është përmbushur totalisht konform legjislacionit në fuqi të Arsimit të Lartë dhe të gjitha akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, në të gjithë kriteret e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Programi i studimit të ciklit të tretë (doktoratë) është një program i ri. ○ Numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit është në përputhje me politikat e Institucioneve të Arsimit Lartë (UET). ○ Numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit është në përputhje me politikat shtetërore për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës. ○ Numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit është në përputhje me raportin e numrit të doktorantëve për një udhëheqës shkencor; ○ Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga grupe kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare të akredituara. <p>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit të ciklit të tretë është shqyrtuar nga Këshilli i Profesorëve.</p> | | |

Dokumentacioni i nevojshëm:

- I gjithë legjislacioni përfshi statutin dhe rregulloret
- Marrëveshjet me institucionet bashkëpunuese
- Marrëveshjet me pedagogët vendas dhe ata të huaj
- Plani mësimor 60 ects i programit të studimit
- Programi i studimit i miratuar
- Plani individual i punës studimore kërkimore të doktorantëve
- Formati i Propozimit Doktorat
- Lista e literaturës
- Comprehensive exam procedura
- Teza e comprehensive exam
- Komisioni i comprehensive exam
- Udhëheqësit për çdo doktorant
- Strategjia e UET per mesimdhënie
- Strategjia e UET per kerkimin shkencor
- Vendimet e akreditimit

2. Struktura akademike e Shkollës së Doktoratës

Pjesa përshkrimore

Shkolla doktorale ka një rëndësi kyçe, sepse nxjerr hulumtuesit e parë dhe punonjësit e parë shkencorë të përgatitur në UET. Po ashtu, Shkolla doktorale ofron udhëheqje shkencore për kandidatet doktorale dhe strukturon punën kërkimore të stafit pedagogjik sipas drejtimeve specifike kërkimore. Në bashkëpunim me Fakultetin Juridik, Shkolla Doktorale në UET ka strukturuar kërkimin shkencor dhe drejtimin e punës kërkimore të kandidatëve doktoralë sipas një Drejtimi të Madh Kërkimor (DMK) dhe akteve kërkimore të vecanta. Drejtimi Kërkimor i Shkollës Doktorale është një projekt i cili brenda kuadrit kohor trevjeçar synon të arrijë të paktën tre objektiva:

Së pari, të prodhojë ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në një fushë të caktuar dhe të kthejë UET-in në një burim të vazhdueshëm dijeje dhe konsulence si për komunitetin akademik, ashtu dhe për aktorë të tretë. Së dyti, rritja profesionale e stafit akademik dhe kërkimor të UET-it vertikalisht, brenda ekspertizave dhe fushave të tyre të interesit shkencor. Ky konceptim i punës kërkimore ndryshon nga trainimi tradicional i trainimit të studiuesve me gamën e gjerë të literaturës dhe me probleme dhe çështje të ndryshme të disiplinës brenda të cilës secili prej nesh punon dhe jep mësim. Nëpërmjet konceptimit të kërkimit shkencor nëpërmjet drejtimeve dhe akteve kërkimore, ne synojmë krijimin e specializimeve dhe thellimin e vazhdueshëm të stafit dhe komunitetit të doktorantëve në UET.

Kërkimi në Shkollën Doktorale në UET është pjesë integrale e Kërkimit Shkencor në Universitetin Europian të Tiranës dhe shkalla më e lartë e hulumtimit dhe punës individuale kërkimore të ndihmuar nga stafi i lektorëve dhe studiuesve të UET. Por aq sa është hapi final i punës universitare, dhe rrjedhimisht dhe të supervizuar nga pedagogët, tema apo dezertacioni doktoral është dhe hapi i parë i karrierës akademike të secilit doktorant. Duke pasur këtë parasysh, mentorimi që ne u japim kandidatëve doktoralë në shkencat juridike është i shumëfishtë: që nga puna individuale e secilit kandidat me udhëheqësin e tij shkencor, pjesëmarrja dhe prezantimet e punimeve të kandidatit para pedagogëve dhe kandidatëve të tjerë doktorale brenda të njëjtit Drejtim të Madh Kërkimor. Personeli Akademik i saj ndahet në Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA). Gjithashtu, koordinimi i mësimdhënies me departamentet e Fakultetit Juridik bëhet përmes koordinatorit të programit.

Vendi që zë Shkolla e Doktoratës në organigramën e UET

Shkolla Doktorale është pjesë e strukturës organizative të UET. Shkolla ka në përbërje të saj Drejtorin e Shkollës Doktorale, Këshillin Drejtues dhe Koordinatorët e Programeve të

Studimit. Në dosjen e dokumentacionit bashkangjitur ndodhet edhe organigrama e UET, ku reflektohet edhe pozicioni që zë Shkolla doktrale në strukturën organizative të UET.

Në shkollën doktrale në tërësi janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i personelit akademik dhe administrativ, ku 45 prej tyre janë PAE, 45 PAK dhe 33 PA. (shih tabelën 1 më poshtë).

Këshilli i Profesorëve të UET është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e programit të studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës. Ai funksionon në nivel universiteti.

Të dhëna për personelin akademik përgjegjës për doktoratën në Shkenca Juridike

Personeli akademik që angazhohet në shkollën doktrale për programin e doktoraturës në shkenca juridike është i kualifikuar dhe ai përbën një garanci për mbarëvajtjen e studimeve të doktoratës në Shkenca Juridike pranë Fakultetit Juridik. Në mësimdhënie dhe udhëheqje janë të angazhuar gjithsej 23 pedagoge, nga të cilët 12 pedagogë efektivë dhe 11 pedagogë me kontratë (tek nr. i PAE përfshihen edhe 2 pedagogë të shkencave të tjera që zhvillojnë lëndët metodologjike në programin e studimit të doktoratës në shkenca juridike). Midis tyre ka edhe pedagogë të huaj që janë të angazhuar si në mësimdhënie, dhe në udhëheqjen e studentëve. Ata vijnë prej Universitetit të Astonit, UK, si dhe Universitetit të Tiranës si dhe pedagoge të universiteteve të tjera shqiptare, të mirënjohur.

Personeli akademik efektiv i Shkollës Doktrale për Programin Doktoratë të Fakultetit Juridik, përbëhet nga një personel tepër i përgatitur, i kualifikuar dhe me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, brenda dhe jashtë vendit.

Personel Administrativ (PA)

Shkolla doktrale ka angazhuar personelin administrativ të nevojshëm, duke filluar që nga:

- Drejtori Shkollës Doktrale (në kuadër të IAL);
- Zv/Drejtori i Shkollës Doktrale (në kuadër të IAL);
- Koordinator i Programit të Doktoratës - Personel administrativ (në kuadër fakulteti)
- Ndhimës-Koordinatori i Programit të Doktoratës - Personel ndihmës-mësimor shkencor (në kuadër fakulteti);
- Koordinatorja për programin mësimor- Personel ndihmës-mësimor shkencor (në kuadër të shkollës doktrale, për të tre fakultetet);
- Sekretarja e programit të doktoraturës- (Front Office) Personel administrativ (në kuadër të shkollës doktrale, për të tre fakultetet);
- Ndhimës-Sekretarja e programit të doktoratës- Personel administrativ (në kuadër të shkollës doktrale, për të tre fakultetet);
- Sekretarja mësimore e Shkollës Doktrale- Personel administrativ (në kuadër të shkollës doktrale, për të tre fakultetet).

Përbërja e Stafit të Shkollës Doktrale për Fakultetin Juridik dhe për UET.

| Emër Mbiemër | Titulli | Pozicioni (anëtar/Kryetar) |
|---------------------|----------------|--|
| Adrian Civici* | Prof.Dr | Drejtor i Shkollës Doktrale UET |
| Aleksander Dhima* | Prof. Asoc.Dr | Zv/ Drejtor i Shkollës Doktrale UET |
| Arnisa Gorezi* | Ph.D | Koordinator i Programit të Studimit për FJ |
| Blerta Aliu* | Dokt. | Ndhimës/ Koordinator i Programit të Studimit për Shkencat Juridike |
| Kreshnik Bello | Dr | Koordinator i Programit të Studimit për FETI |
| Odeta Barbullushi | Ph.D | Koordinator i Programit të Studimit për Shkencat Sociale |
| Anjeza Xhaferaj | Dokt. | Ndhimës/ Koordinator i Programit të Studimit për Shkencat Sociale |
| Saimir Suma | Dokt. | Ndhimës/Koordinator i Programit të Studimit për FETI |
| Besarta Vladi* | Dokt. | Koordinatore mësimore e Shkollës Doktrale |
| Nertila Koka* | MA | Sekretare Administrative (Front Office) |
| Amela Hoxha* | BA | Ndhimës Sekretar Administrativ |
| Vilma Hako* | MA | Sekretare Mësimore për Shkollën Doktrale |
| Gjithsej 12 | | |

*Emrat me yll janë personeli i Shkollës Doktorale për Fakultetin Juridik (gjithsej 8 individe). Njëkohësisht në PA të Shkollës Doktorale të UET bëjnë pjesë edhe Koordinatorin e Programit të studimit të Shkencave Sociale dhe Ndihmëskoordinatorin e këtij programi si edhe Koordinatorin e Programit të studimit të Shkencave Ekonomike & Teknologjisë së Informacionit dhe Ndihmëskoordinatorin e këtij programi. Pra gjithsej 12 individë që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me drejtimin e Shkollës Doktorale të UET.

Në total numri i personelit administrativ të angazhuar pranë shkollës doktorale që lidhet me mbarëvajtjen e programit të doktoraturës në shkenca juridike është 8 persona.

Koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

Koordinimi i programit të studimit realizohet përmes Koordinatorit të Programit të Studimit për Fakultetin Juridik dhe Koordinatorës mësimore të Shkollës Doktorale për koordinimin brenda UET. Nderkohë, për koordinimin jashtë UET, përveç dy hallkave të mesiperme përfshihet dhe Drejtori i Shkollës Doktorale, Drejtuesit e Fakultetit si edhe zv/Rektori për Kërkimin Shkencor.

Tregues të matshëm:

- Organigrama e organizimit të Shkollës së Doktoratës (bashkangjitur)
- Numri i personelit akademik, i përfshirë në programin e doktoratës: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (shih Tabelën 1)

Tabela 1:

| Shkolla e Doktoratës | Numri i PAE | | Numri i PAK | | Numri i PA | | Në Total | |
|----------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|------------|-------------|----------|-------------|
| | Gj | Tituj/Grada | Gj | Tituj/Grada | Gj | Tituj/Grada | Gj | Tituj/Grada |
| | 45 | 19/26 | 45 | 33/12 | 33 | 0 | 123 | 52/38 |

- Këshilli i Profesorëve dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit në shkenca juridike (shih Tabelën 2)

Tabela 2

| Emër Mbiemër | Titulli | Pozicioni (anëtar/Kryetar) |
|---------------------|-----------|----------------------------|
| 1. Romeo Gurakuqi | Prof. Dr. | Kryetar |
| 2. Adrian Civici | Prof. Dr. | Anëtar |
| 3. Luljeta Minxhozi | Prof. Dr. | Anëtar |
| 4. Ksenofon Krisafi | Prof. Dr. | Anëtar |
| 5. Ferit Duka | Prof. Dr. | Anëtar |
| 6. Perparim | Prof. Dr. | Anëtar |

| | | |
|------------------|-----------|--|
| Fuga | | |
| 7. Engjëll Pere | Prof. Dr. | Anëtar |
| 8. Kosta Barjaba | Prof. Dr. | Anëtar |
| Arnisa Gorezi | PhD | Koordinator i Programit Shkenca Juridike |

Dokumentacioni përkatës:

Vendimet e akreditimeve të mëparshme

Organigrama e Shkollës Doktorale (UET) dhe strukturat e godinave (njësive ndihmëse dhe mbështetëse)

Statuti dhe rregullorja e UET

Rregullorja e programit të studimit

Vendimi i emërimit të koordinatorit dhe stafit të shkollës doktorale

Vendimi për ngritjen e KP

Rregullorja e brendshme e KP

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | | Vlerësimi sipas standardit/ kriterit |
|--|--|--|
| Standardi III.1 - Administrimi dhe mjetet për financimin e programit të studimeve të doktoratës | | |
| Kriteri 1 | Njësia që organizon programin e studimeve të doktoratës i ka të akredituara dy ciklet e para të studimeve në fushën, në të cilën e ofron programin e studimit të doktoratës; | Kriteri 1 UET-i është akredituar institucionalisht me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 246, datë 24.07.2009, dhe po ky urdhër ka akredituar edhe programet e ciklit “Bachelor” dhe me urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011, UET-i është akredituar për programet “Master i shkencave” dhe “ Master profesional”, per Fakultetin Juridik. |
| Kriteri 2 | Njësia që organizon programin e studimeve të doktoratës ka në dispozicion mjedise administrative të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e tij; | Kriteri 2 Shkolla doktorale ka në dispozicion mjedise administrative të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e saj; Infrastruktura specifike, operative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit të doktoratës në shkenca juridike është e plotë duke përfshirë këtu edhe departamentet e Fakultetit Juridik si dhe: <ul style="list-style-type: none"> o Bibliotekën e UET o Laboratorin e Informatikës; o Librarinë Baza laboratorike dhe mjediset e tjera pedagogjike e te shërbimeve të përfshira në këtë program studimi jane mëse të mjaftueshme. Ajo garanton një mbarëvajtje cilësore të këtij programi |

| | | |
|-------------------------|--|--|
| <p>Kriteri 3</p> | <p>Për realizimin e programit të studimeve të doktoratës njësia që propozon hapjen e tij angazhon personelin e nevojshëm, duke filluar që nga sekretaria mësimore që ndjek mbarëvajtjen e programit mësimor të studimeve të ciklit të tretë;</p> | <p>doktorature.</p> <p>Shkolla Doktorale i ka mjediset e saj në katin e dytë të godines A të UET. Zyra e Sekretarisë Administrative, ku njëkohësisht gjendet dhe Zv/Drejtori Shkolles Doktorale, shërben si Front Office për personat e interesuar që duan të regjistrohen në programin e doktoraturës dhe për studentët. Kjo zyrë ofron gjithë asistencën e nevojshme, përsa i përket të gjitha çështjeve të shkollës doktorale.</p> <p>Po ashtu Zyra e koordinatorëve të programit mësimor, në të cilën ndodhen Koordinatorët e programeve të studimit, shërben edhe si ambjent diskutimesh me studentët përsa i përket aspektit metodologjik dhe shkencor.</p> <p>Ekziston edhe Zyra e koordinatorit të procesit mësimor, së bashku me ndihmes-koordinatorët, e cila ndihmon mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Auditori “At Zef Pllumbi”, është një ambient i cili shërben për takime, konferenca dhe leksione të hapura me studentet.</p> <p>Meqenëse infrastruktura dhe mjediset administrative të Fakultetit Juridik janë njëkohësisht edhe ato të Universitetit European të Tiranës, ato janë të shprehura më qartë në Pikën 3 “Personeli Akademik dhe Mbështetës, Kriteri 3, të raportit.</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Për realizimin e programit të studimeve të doktoratës Fakulteti Juridik ka angazhuar personelin e nevojshëm akademik. Po ashtu janë angazhuar për këtë program:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Koordinatori i Programit të Doktoratës- Personel administrativ (në kuadër fakulteti) o Ndihmës- Koordinatori i Programit të Doktoratës- Personel ndihmës-mësimor shkencor (në kuadër fakulteti) o Koordinatorja për programin mësimor -Personel ndihmës-mësimor shkencor (në kuadër të shkollës doktorale, për të tre fakultetet) o Sekretarja e programit të doktoraturës - (Front Office) Personel administrativ (në kuadër të shkollës doktorale, për të tre fakultetet) o Ndihmës-Sekretarja e programit të doktoraturës- Personel administrativ (në kuadër të shkollës doktorale, për |
|-------------------------|--|--|

| | | |
|-------------------------|---|--|
| <p>Kriteri 4</p> | <p>Në rregulloren e programit të studimeve të doktoratës përcaktohen organet përgjegjëse për drejtimin e tij;</p> | <p>të tre fakultetet)</p> <ul style="list-style-type: none"> o Sekretarja e përgjithshme e Shkollës Doktorale- Personel administrativ (në kuadër të shkollës doktorale, për të tre fakultetet) <p>Përvec këtij stafi, në UET vepron edhe Drejtori dhe Zv/Drejtori i Shkollës Doktorale, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen në tërësi të Shkollës Doktorale të UET.</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimeve të doktoratës janë përcaktuar organet përgjegjëse për drejtimin e tij, sipas strukturës organizative të miratuar për këtë qëllim në UET.</p> <p>Organet përgjegjëse për programet në UET janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Këshilli i Profesorëve, për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktorates, o Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale për administrimin e tyre, dhe o Koordinator i Programit të Doktoratës. <p>Këshilli i Profesorëve</p> <p>Këshilli është i ngritur në nivel institucioni dhe ka këto funksione kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> -I propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale caktimin e kritereve të pranimit të kandidatëve; -Miraton listën e kandidatëve fitues në programet e doktorates; -Ngre komisionet <i>ad hoc</i> që bëjnë vlerësimin e dosjeve të aplikantëve; -Shqyrton ankimmimet e aplikantëve jo fitues dhe shprehet me vendim, i cili është përfundimtar; -Ngre komisionet e drejtuara nga koordinatori i programit të doktoratës për njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga kandidatët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë një program studimi të ciklit të tretë; -Miraton literaturën mbi bazën e të cilës do të zhvillohet provimi për gjendjen teorike të disiplinës; -Miraton temat e disertacionit dhe udhëheqësit për çdo kandidat; -Përcakton numrin e studentëve që mund të udhëheqë njëkohësisht një udhëheqës shkencor; -Shqyrton dosjen e plotë të kandidatëve, dhe i përcjell Drejtorit të Shkollës Doktorale vendimin për vazhdimin ose jo |
|-------------------------|---|--|

të procedurës së mbrojtjes së doktoratës;
- I propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale jurinë për mbrojtjen e doktoratës;
-Shqyrton dhe miraton hapjen, mbylljen ose riorganizimin programeve të studimit të doktoratës, përpara përcjelljes për miratim në Senatin Akademik;
-Shqyrton raportin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit të doktoratës.

Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale

Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale përbëhet nga Drejtori i Shkollës, Koordinatorët e Programeve të Doktoratës, si dhe nga përfaqesues të universiteteve bashkëpunuese. Këshilli kryen këto funksione kryesore:

-I parapërgatit Këshillit të Profesorëve të gjithë dokumentacionin për veprimtarinë e programeve të doktoratës, nga pranimi i studentëve deri tek diplomimi i tyre, dhe garanton përputhshmërinë e kësaj veprimtarie me legjislacionin në fuqi e aktet rregullatore të UET-it;

-Organizon procesin e pranimit dhe regjistrimit të kandidateve në çdo program studimi;

-Përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit dhe rregulloren e brendshme të programeve të doktoratës,

-Bën propozime për rishikimin e programeve të studimit të ciklit të tretë, të planit mësimor, strukturës së studimeve;

-Bën propozime për lidhjen e marrëveshjeve me shkollat analoge vendase dhe të huaja, anëtarësimin në shoqata kombëtare e ndërkombëtare që kanë si objekt çështje të arsimit të lartë dhe të integritimit evropian.

-Shqyrton programet e lëndëve të programeve të doktoratës, të cilat siglohen nga Drejtori i Shkollës pas miratimit nga përgjegjësi i departamentit dhe koordinatori i programit të doktoratës.

-I propozon Këshillit të Profesorëve literaturën mbi bazën e të cilës do të zhvillohet provimi për gjendjen teorike të disiplinës për programet e doktoratës;

-Përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e programeve të doktoratës.

Koordinatori i Programit të Doktoratës

Në “Rregulloren për organizimin e programeve të studimit të doktoraturës” pika 5.3 janë specifikuar plotësisht detyrat e Koordinatorit të Programit të Doktoratës.

Ai zgjidhet me propozim të Dekanit dhe

| | | |
|------------------|---|---|
| | | <p>miratim të Rektorit dhe kryen këto detyra kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Harton cdo vit një liste më literaturën mbi bazën e të ciles do të zhvillohet provimi për gjendjen teorike të disiplinës për programin përkatës të doktoratës; -Kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqësin shkencor të temës së doktoratës, duke respektuar rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës duke i dërguar propozimet përkatëse Këshillit të Profesorëve. -Siguron që udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij. -Interesohet për t'iu siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme në përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit. -Garanton zbatimin e standardeve të kërkimeve shkencore në zhvillimin e programit të doktoratës; -Shqyrton raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe sigurohet që udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, i propozon Këshillit të Profesorëve masat e nevojshme; -Informon studentët për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhezime, rregullore etj. që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore. |
| Kriteri 5 | <p>Këshilli i Profesorëve, që është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të doktoratës ka një numër të mjaftueshëm anëtarësh që mbulojnë gjithë problematikën e tij. Numri minimal i profesorëve të KP-së duhet të jetë 7 (shtatë) veta. Këshilli i Profesorëve mund të ngrihet edhe në nivel të institucionit të arsimit të lartë, kur njësitë kryesore të tij nuk përmbushin numrin e nevojshëm të profesorëve me kohë të plotë;</p> | <p>Kriteri 5</p> <p>Këshilli i Profesorëve është ngritur dhe funksionon në nivel Universiteti. Mbështetur në VKM Nr. 467, datë 18.07.2007, te ndryshuar, Këshilli i Profesorëve në UET përbëhet vetëm nga pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin akademik “Profesor”. KP i UET që është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të doktoratës ka një numër të mjaftueshëm anëtarësh që mbulojnë gjithë problematikën e tij, Numri i profesorëve të KP-së është 8 (tetë) veta.</p> |
| Kriteri 6 | <p>Këshilli i Profesorëve të njësisë kryesore që organizon dhe menaxhon programin e studimeve të doktoratës mbledhet periodikisht gjatë vitit;</p> | <p>Kriteri 6</p> <p>Këshilli i Profesorëve mbledhet periodikisht gjatë vitit, në mbledhjet e tij të rregullta të dokumentuara për këtë qëllim, ku që nga fillimi i programit ka realizuar 9 mbledhje të tij. Mbledhjet e KP thirren, organizohen dhe</p> |

| | | |
|---|--|--|
| | | <p>drejtohen nga kryetari. Thirrja e mbledhjes së KP mund të bëhet edhe me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të tij. Mbledhja e KP realizohet atëherë kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij dhe merr vendime me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendime të cilat miratohen nga Rektori në bashkërendim të vendimarrjes me Administratorin e UET.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Prej vlerësimit të kriterëve vërehet se Standarti III.1 është përmbushur totalisht konform legjislacionit në fuqi të Arsimit të Lartë dhe të gjitha akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, në të gjithë kriteret e tij.</p> <p>UET-i është akredituar institucionalisht me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 246, datë 24.07.2009, dhe po ky urdhër ka akredituar edhe programet e ciklit “Bachelor” dhe me urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011, UET-i është akredituar për programet “Master i shkencave” dhe “ Master profesional” ne Drejtësi.</p> <p>Shkolla doktorale ka në dispozicion mjedise administrative të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e saj; Për realizimin e programit të studimeve të doktoratës është angazhuar personeli i nevojshëm, duke filluar që nga sekretaria mësimore e shkollës doktorale që ndjek mbarëvajtjen e programit mësimor të studimeve të ciklit të tretë;</p> <p>Këshilli i Profesorëve i UET që është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të doktoratës ka një numër të mjaftueshëm anëtarësh që mbulojnë gjithë problematikën e tij, Numri i profesorëve të KP-së është 8 (tetë) veta.</p> <p>Këshilli i Profesorëve mblidhet periodikisht gjatë vitit, në mbledhjet e tij të rregullta të dokumentuara për këtë qëllim me procesverbalet përkatëse.</p> | | |

3. Personeli akademik dhe mbështetës

Pjesa përshkimore

Shkolla Doktorale është pjesë e strukturës organizative të UET. Shkolla ka në përberje të saj Drejtorin e Shkollës Doktorale, Këshillin Drejtues dhe Koordinatorët e Programeve të Studimit. Personeli akademik që angazhohet në shkollën doktorale për programin e doktoraturës në shkenca juridike është i kualifikuar dhe ai përbën një garanci për mbarëvajtjen e studimeve të doktoratës në Shkenca Juridike pranë Fakultetit Juridik.

Në shkollën doktorale në tërësi janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i personelit akademik dhe administrativ, ku 45 prej tyre janë PAE, 45 PAK dhe 33 PA.

Ndërsa në programin e doktoratës në shkenca juridike, në mësimdhënie dhe udhëheqje janë të angazhuar gjithsej 23 pedagogë, nga të cilët 12 pedagogë efektivë dhe 11 pedagogë me kontratë (Tek nr. i PAE përfshihen edhe 2 pedagogë të shkencave të tjera që zhvillojnë lëndët metodologjike në programin e studimit të doktoratës në shkenca juridike). Midis tyre ka edhe pedagogë të huaj që janë të angazhuar si në mësimdhënie, dhe në udhëheqjen e studentëve. Ata vijnë prej Universitetit të Astonit, UK, SEEU, Maqedoni, Universitetit AAB, Prishtinë, Universitetit të Tiranës, Shkollës së Magjistraturës, si dhe pedagogë të universiteteve të tjera shqiptare, të mirënjohur.

Personeli akademik efektiv i Shkollës Doktorale për Programin Doktoratë të Fakultetit Juridik, përbëhet nga një personel tepër i përgatitur, i kualifikuar dhe me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, brenda dhe jashtë vendit, cilësi këto të nevojshme për përzgjedhjen e tyre për këtë program. Personeli akademik shqiptar përbëhet nga

pedagogë të UET dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera shqiptare. Duke u nisur prej fushave të tyre të ekspertizës si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor e aktivitetin botues, garantohet realizimi me cilësi i programit të doktoratës në të katër profilet e saj, si për lëndët teorike e metodologjike të propozuara në programin e saj, ashtu edhe përsa i përket cilësisë së udhëheqjes shkencore të doktorantëve.

Shkolla doktorale ka angazhuar personelin administrativ të nevojshëm. Koordinimi i programit të studimit me hallkat e tjera realizohet përmes Koordinatorit të Programit të Studimit për Fakultetin Juridik dhe Koordinatorës mësimore të Shkollës Doktorale për koordinimin brenda UET.

Numri total i kandidatëve në programin e studimit të doktoratës në shkenca juridike të pranuar për vitin akademik 2011-2012 dhe 2012-2013 është 126, nga të cilët 18 nga 36 studentë të ciklit 2 vjeçar, vazhdojnë studimet në këtë program pasi kanë përmbushur kriteret dhe detyrimet akademike.

Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik

Ngarkesa e pedagogëve që bëjnë pjesë në Shkollën Doktorale, për Fakultetin Juridik përbëhet nga ngarkesa në mësimdhënie dhe ngarkesa për udhëheqjen e temave të diplomave. Personeli akademik efektiv dhe joefektiv i angazhuar në programet e doktoratës realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET-in. Si rregull pedagogët efektiv me grada e tituj sipas kërkesave, duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe të tretë. Një orë fizike në auditor llogaritet 1.5 orë-njësi për efekt ngarkese.

Përgjegjësi i Departamentit përketes (sipas profileve të Programit të Studimit të Shkollës Doktorale) është personi përgjegjës që përcakton ngarkesën mësimore të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie pranë Shkollës Doktorale për Fakultetin Juridik. Ndërsa përsa i përket udhëheqjeve, si për stafin efektiv ashtu edhe për atë joefektiv, ngarkesa realizohet sipas akteve në fuqi (nr i studentëve që mund të udhëhiqen është i përcaktuar) dhe kontratës së lidhur me UET-in. Koordinator i programit të studimit është personi përgjegjës për caktimin e ngarkesës të stafit akademik të angazhuar në udhëheqje pranë Shkollës Doktorale.

Kriteret e rekrutimit të personelit akademik me kontratë

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të veçantë. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

- Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar;
- Të ketë së paku gradë shkencore PhD, si dhe tituj, Profesor i Asociuar Profesor, Akademik;
- Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve përëndimore;
- Rezultatet personale të kandidatit;
- Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencorë të UET-it;
- Aftësitë komunikuese dhe etika;
- Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;
- Përvoja e punësimit
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;

Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe UET, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e UET-it, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integritetit Akademik, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it.

Përzgjedhja e kandidateve bëhet prej një Komisioni të përbërë prej Drejtorit të Shkollës Doktorale, Dekanit/Zv/Dekanit të Fakultetit dhe Koordinatorit të Programit të Studimit, të cilët bazohen mbi kriteret e mësipërme në gjykimin e tyre.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për çdo njësi (plotëso Tabelën 3)

Tabela 3

| Institucioni/Njësia Bazë/Shkolla e Doktoratës/ Shkenca Juridike | | | | | | | |
|--|------------------|---------------------------------------|-----------------|--------------------------------|--------------------|-----------------------------|--|
| Personeli Akademik Efektiv | | Detyra në UET | Titulli/Grada | Personeli Akademik me Kontratë | | Titulli/Grada | Institucioni ku punon full time |
| (Emër Mbiemër) | | | | (Emër Mbiemër) | | | |
| 1 | Ferit Duka | Udhëheqës Doktoratash, Lektor | Prof. Dr. | 1 | Skënder Kaçupi | Prof. Dr. | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë |
| 2 | Ksenofon Krisafi | Udhëheqës Doktoratash, Lektor | Prof. Dr. | 2 | Blerim Reka | Prof. Dr. | Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni |
| 3 | Romeo Gurakuqi | Kryetar i Këshillit të Profesorëve | Prof. Dr. | 3 | Shefqet Muçi | Prof. Dr. | Shkolla e Larte Universitare "Wisdom University", Tiranë |
| 4 | Migena Leskoviku | Zv. Dekane & Përgjegjëse departamenti | Prof. Asoc. Dr. | 4 | Xhezair Zaganjori | Prof. Dr. | Gjykata Kushtetuese |
| 5 | Darjel Sina | Udhëheqës Doktoratash, Lektor | PhD | 5 | Vasilika Hysi | Prof. Dr. | Kuvendi i Shqipërisë |
| 6 | Erjona Canaj | Udhëheqës Doktoratash, Lektor | PhD | 6 | Marjana Semini | Prof. Dr. | Shkolla e Magjistraturës |
| 7 | Juelda Lamçe | Udhëheqës Doktoratash, Lektor | PhD | 7 | Kestrin Katro | Prof. Asoc. Dr. | Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë |
| 8 | Arjan Vasjari | Udhëheqës Doktoratash, Lektor | PhD | 8 | Irakli Koçollari | Dr. (Prof. Asoc. ne proces) | Universiteti Luarasi |
| 9 | Arnisa Gorezi | Koordinatorë e programit | PhD | 9 | Altin Shegani | PhD | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë |
| 10 | Çlirim Gjata | Dekan i Fakultetit Juridik | Dr. | 10 | Genta Tafa (Bungo) | Dr. | Studio përmbarimore "Debit Collection" |
| | | | | 11 | Lulzim Tafa | Dr. | Universiteti AAB, Kosovë |

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 4)

Tabela 4

| Titulli | PAE | PAK | | Raporti |
|--|-----|--------|---------|---------|
| | | Vendas | Te huaj | PAE/PAK |
| Profesorë | 9 | 22 | 3 | 9:25 |
| Profesorë të Asociuar | 10 | 8 | 0 | 10:8 |
| Doktorë (PHD mbaruar në Universitetet Europiane) | 16 | 2 | 4 | 16:6 |
| Dr. | 10 | 5 | 1 | 10:6 |
| Personeli Administrativ | 33 | | | |

Shënim: Kjo tabelë është e vlefshme për të gjithë Shkollën Doktorale. Tabela më poshtë i përket Fakultetit Juridik.

Tabela 4/a

| Titulli | PAE | PAK | | Raporti PAE/PAK |
|--|----------|--------|---------|--------------------|
| | | Vendas | Te huaj | |
| Profesorë | 3 | 5 | 1 | 3/6 |
| Profesorë të Asociuar | 1 | 1 | 0 | 1/1 |
| Doktorë (PHD mbaruar në Universitetet e huaja) | 5 | 1 | 4 | 5/5 |
| Dr. (ne proces aplikimi per Prof. Asoc) | 0 | 1 | | 0/1 |
| Dr. | 1 | 1 | 1 | 1/2 |
| Personeli Administrativ | 8 | | | 8/0 |

- Në këtë tabelë nuk përfshihen edhe 2 lektorë të këtij programi (të lëndëve metodologjike) që janë personel akademik efektiv në UET/i huaj (Aston), por jo PAE i Fakultetit Juridik.

Të dhëna sipas moshës (plotëso Tabelën 5)

Tabela 5

| Personeli sipas titujve /gradave | Numri sipas moshës | | | | | | | |
|--|--------------------|-----|---------|-----|---------|-----|---------|-----|
| | (36-45) | | (46-55) | | (56-65) | | (66-68) | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Profesorë | 0 | 0 | 4 | 9 | 3 | 13 | 2 | 3 |
| Prof të asociuar (Prof. Asoc.) | 2 | 2 | 3 | 1 | 5 | 4 | 0 | 1 |
| Doktorë (PHD mbaruar në Universitetet Europiane) | 11 | 5 | 4 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Dr. | 5 | 4 | 3 | 1 | 2 | 1 | 0 | 0 |
| Personeli Administrativ * | 25 | 0 | 5 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 |

*Personeli administrativ është dhënë në nivel institucional pasi nuk është i ndarë sipas njësive kryesore.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
- Ndodhen ne dokumentat që shoqërojnë këtë raport

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | | Vlerësimi për Kriteret dhe standardet |
|---|--|--|
| Standardi I.1 - Kuadri i përgjithshëm | | |
| Kriteri 6 | Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këtë program përbën një garanci për realizimin e programit (60% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, i angazhuar në kërkim dhe me tituj akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të njohura në botë për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse; | Kriteri 6 Numri dhe niveli i stafit të angazhuar në këtë doktoratës përbën një garanci për realizimin e programit. Në programin e doktoratës në shkencë juridike, në mësimdhënie dhe udhëheqje janë të angazhuar gjithsej 23 pedagogë, nga të cilët 12 pedagogë efektivë dhe 11 pedagogë me kontratë (këtu futen të gjithë PAE në UET që aktivizohen në këtë program studimi). Midis tyre ka edhe pedagoge të huaj që janë të angazhuar si në mësimdhënie, dhe në udhëheqjen e studentëve. 12 prej tyre janë personel akademik efektiv, me tituj akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të njohura. Kjo shifër përbën 109% te personelit akademik dhe 52.2 % të gjithë stafit të angazhuar në këtë program. Duke u nisur prej fushave të tyre të ekspertizës si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor e aktivitetin botues (sikurse tregohet edhe prej CV-ve të tyre), garantohet realizimi me cilësi i programit të kësaj doktorature në të katër profilet e saj, si për lëndët teorike e metodologjike të propozuara në programin e saj, ashtu edhe përsa i përket cilësisë së udhëheqjes shkencore të doktorantëve. |
| Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor | | |
| Kriteri 2 | Institucioni që ofron programe studimi të ciklit të tretë (doktoratë), ka personel të mjaftueshëm, akademik me tituj e grada shkencore; | Kriteri 2 Në “Rregulloren për organizimin e programeve të studimit të doktoraturës” pikat 4.2, 4.2.1 dhe 4.2.2 specifikojnë që: Hapja e programeve të doktoratës bëhet e mundur nëse institucioni plotëson kushtet e mëposhtme: 1. ka personel akademik me titull "Profesor", "Profesor i Asociuar" |

| | | |
|-------------------------|---|---|
| <p>Kriteri 3</p> | <p>Institucioni ka struktura administrative dhe kërkimore, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit për kryerjen e kërkimeve. Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një a më shumë institucione të tjera, në bazë marrëveshjesh midis tyre;</p> | <p>ose me gradën shkencore "doktor" të fituar në universitete perëndimore dhe që ka, së paku, dy vjet përvojë mësimore kërkimore pas doktoraturës;</p> <p>2. ka numrin e nevojshem të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit dhe në kryerjen e detyrave përkatëse didaktike;</p> <p>Aktualisht raporti PAE/PAK është 109%, dhe raporti PAE/PAE+PAK është 52.2%.</p> <p>Fakulteti Juridik është duke punuar për të rritur raportin (PAE/PAE+PAK) në masën mbi 60 %, duke rekrutuar staf të ri me tituj dhe grada.</p> <p>Pra, sic shihet, nisur nga numri pedagoqeve të brendshme që aktualisht janë të angazhuar në programin e studimit si edhe nga numri i studenteve që aktualisht kanë fituar të drejtën për të vazhduar në vitin e dytë të programit të studimit, Fakulteti Juridik ka personel të mjaftueshëm akademik, me tituj të grada shkencore, për të mbuluar këtë program studimi të ciklit të tretë.</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Institucioni ka struktura administrative dhe kërkimore, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit për kryerjen e kërkimeve. Aktualisht ka marrëveshje me Universitetin e Aston, UK dhe Universitetin Politeknik të Tiranës për organizimin e programeve të përbashkëta të studimit të doktoratës (Rregullorja për organizimin e programeve të studimit të doktoraturës” pika 4.2.5).</p> <p>Në Fakultetin Juridik veprojnë Njësitë Bazë siç janë departamentet, të cilët nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtarinë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore.</p> <p>Gjithashtu në UET, veprojnë Njësitë Ndihmëse Mësimore, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Laboratorët o Biblioteka o Libraria <p>dhe njësi të tjera që shërbejnë për të realizuar studime dhe shërbime në kuadër të zhvillimit të procesit</p> |
|-------------------------|---|---|

| | |
|--|---|
| | <p>akademik dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>UET-i përbëhet nga këto Njësi te Tjera: -Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë -UET Press.</p> <p>Gjithashtu funksionon Zyra e Projekteve për Kërkim e Zhvillim/dhe Qendra UET/Fondacioni per Liri Ekonomike, e cila mbështet dhe koordinon në shkallë institucioni aktivitetet e lidhura me projektet e kërkimit shkencor; iu ofron njësive të tjera të Universitetit informacionin dhe asistencën e nevojshme për hartimin, për ndjekjen dhe për realizimin e projekteve në funksion të procesit mësimor e të kërkimit shkencor, si dhe mban kontaktet e nevojshme me donatorët brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Përvec sa më sipër në UET, veprojnë Njësitë Administrative si: Zyra e Burimeve Njerëzore Sekretaria Mësimore Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave Zyra e Pranimet dhe Kujdesit ndaj Studentit Zyra e Karrierës dhe e Praktikave Zyra e Marrëdhënieve Publike dhe e Marketingut Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë Zyra e Financës Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikës Zyra e Koordinimit të Shkollës Doktorale Zyra e Projekteve për Kërkim e Zhvillim Qendra e Teknologjisë së Informacionit (Zyra e IT-së)</p> <p>Në rregullore parashikohet që mbrojtja e doktorates të bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 anëtarë, 3 janë anëtarë të stafit akademik të njësisë kryesore përkatëse dhe 2 anëtarë të jashtëm, nga të cilët një anëtar i personelit akademik nga universiteti ose institucioni jashtë vendit që ka qenë përgjegjës për ndjekjen e punës studimore të kandidatit gjatë periudhës së formimit dhe kërkimit, si dhe nga një anëtar nga universitetet bashkëpunuese Aston University, Birmingham, UK dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.</p> <p>Studentët e doktoratës kanë të drejtën dhe detyrimin të shpenzojnë të paktën 3 muaj nga periudha e tyre kërkimore në institucione të tjera kërkimore, me</p> |
|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| | | <p>të cilat UET-i ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Gjithashtu programi i studimeve të doktoraturës parashikon zhvillimin e disa moduleve të organizuara teorike e metodologjike (7 lëndë, nga të cilat 4 të përbashkëta dhe 3 sipas drejtimit të specializimit të zgjedhur, si edhe provimi për gjendjen teorike të disiplinës) në vlerën e 60 ECTS, një pjesë prej të cilave, në anglisht me profesorë nga Aston University të Birminghamit, UK.</p> <p>Kjo bëhet e mundur pasi 1 nga kërkesat e pranimit në këtë program doktoraturë është zotërimi nga kandidatët i gjuhës angleze në nivelin C1 përmes testeve ndërkombëtare. Te gjithë studentët janë pranuar me dëshmi të gjuhës së huaj, por për ata që nuk e kanë atë konform ligjit ju është kërkuar ta plotësojnë këtë kërkesë, sipas parashikimeve ligjore.</p> <p>Aktualisht në udheheqjen e studentëve janë të përfshirë pedagogë të huaj nga Universiteti i Europës Juglindore, Maqedoni dhe Universiteti AAB, Prishtinë (me marreveshje individuale).</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Kriteri 6 i standartit I.1 plotësohet në një masë të madhe. UET duhet të rrisë përqindjen e PAE në nivelin e kërkuar në raport me pjesën tjetër të stafit (mbi 60%).</p> <p>Kriteri 2 i standartit II.1 plotësohet. Aktualisht raporti PAE/PAK është 109%, por gjithsesi Fakulteti Juridik synon të rrisë numrin e PAE, duke rekrutuar staf të ri me tituj dhe grada.</p> <p>Kriteri 3 i standartit II.1 plotësohet.</p> | | |

4. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të Doktoratës

Pjesa përshkrimore

Mjediset dhe Infrastruktura

Universiteti European i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10,000 m². Përreth godinave, ndodhet një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina. Objekti është i pajisur me dy palë shkallë, nga të cilat, në rast emergjence në njërin krah të godinës, mundet të përdoret shkalla tjetër. Gjithshtu, godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si vijon: një shuarse zjarri në çdo kat, dhe nga një shuarse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 12 copë, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatesisht rrufepritëse.

Institucioni ka të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike që përbëhet nga motogenerator, si edhe ka të garantuar rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, të cilat realizohen nga rrjeri publik i ujit të pijshem si dhe pus uji rezervë dhe

system pompimi përkatës. Mjediset janë të kompletuara me sistemin e ngrohjes të tipit Fancoil, me komandim qëndror. Ky sistem funksionon pa ndërprerje dhe janë certifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese.

Teknologjitë e informacionit (IT)

UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë Informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC, video projektor. Lab 206 B me 35 PC, video projektor. Lab 207 B me 35 PC, video projektor. Lab 208 B me 80 pc (Laboratori i internetit); janë 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit.

Biblioteka njëkohësisht është e paisur me pc në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET.

Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin.

Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen PC-te Projektorët dhe Sistemi i fonisë. Paisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.

Laboratorët e informatikë/satistikës janë pajisur me software-ët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor.

Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, paketa Microsoft Office 2010 është instaluar e plotë me të gjithë softëtarët e saj.

- Access
- Communicator
- Excel
- InfoPath
- OneNote
- Outlook
- PowerPoint
- Publisher
- SharePoint Workspace
- Word

Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor.

Mirëmbajtja dhe azhurnimi i paisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.

Në të njëjtën kohë programet kompjuterike u janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore.

Biblioteka

Një nga synimet dhe detyrat kryesore të Bibliotekës është pasurimi i fondit të saj. Pasurimi i fondit të bibliotekës është bërë dhe vazhdon të bëhet përmes këtyre rrugëve:

(a) Blerja në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkollore si tekset bazë ose si literaturë e rekomanduar;

(b) Blerja në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor në të trija fakultetet e UET-it;

(c) Përktimi dhe botimi nga UET Press-it i shumë teksteve (përfshirë universitare dhe monografive shkencore që kanë për autorë pedagogë të UET-it, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasike dhe bashkëkohore. Këtu bëjnë pjesë edhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga ky universitet, posacërisht përmendim *Jus & Justicia*, por edhe revista të tjera si: *Polis*, *Economicus*, dhe *Sociological Analysis* dhe *Educatio*.

(d) Porosive dhe blerja online në Amazon.com. e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet më së miri ekspertiza e UET-it.

(Vetëm për 3 mujorin e parë të vitit 2013 janë shpenzuar 1,300 \$)

(e) Të dhuruara nga organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja e individë të ndryshëm.

Një vend të veçantë në fondin e Bibliotekës së UET-it zënë titujt e shumtë akademikë (kryesisht tekste bazë dhe monografi) të botuara nga UET-Press, të cilat kanë autorë shqiptare ose janë përkthime të disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit të botuara në shqip nga UET Press. Një listë e tyre mund të konsultohet në Bibliotekë.

Biblioteka ka një staf të kualifikuar që është gjithmonë i gatshëm në ndihmë të studentëve dhe për t'i orientuar ata dhe për të gjetur literaturën që u nevojitet, si edhe për shërbime të tjera bibliotekare. Biblioteka u shërben studentëve të të gjitha niveleve edhe si një sallë leximi, duke u ofruar atyre komoditetin dhe fasilitetet e nevojshme.

Tregues të matshëm:

Mjediset e fakultetit (plotëso Tabelën 6)

Tabela 6

| Mjediset dhe fasilitete për programin e Doktoratës | Sasia | Sipërfaqja |
|---|--------------|-----------------------------------|
| Salla për leksione | 9 | 1160 m ² (1,215 vende) |
| Klasa për seminare | 24 | 1200 m ² (840 vende) |
| Salla për aktivitete promovuese | 2 | 180 m ² (150 vende) |
| Laboratorë informatike | 3 | 140 m ² (110 vende) |
| Salla interneti | 1 | 160 m ² (80 vende) |
| Salla për bibliotekë | 1 | 300 m ² |
| Mjedis për fotokopjime, librari etj | 1 | 150 m ² |
| Biblioteka online | 2 | |
| Zyrë informacioni për studentët | 1 | |
| Numër botimesh, titujsh | | |
| Korridore/holle | 8+2 | |
| Mjedise sportive | - | |
| Mjedise shërbimi për të tretë | - | |
| Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | 1 | 500 m ² |
| Nyje hidrosanitare për studentët | 40 | 250 m ² |
| Etj.... | | |
| Norma m²/për student | | 4.6 m ² /student |

| Mjediset për stafin: | Sasia | Sipërfaqja |
|---|--------------|-----------------------------|
| Zyra për Drejtorin/ zv Drejtorin/ Koordinatorët | 4 | 240 m ² |
| Zyra për sekretarinë mësimore | 1 | 30 m ² |
| Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore | 9 | 360 m ² |
| Zyra për personelin akademik | 25 | 400 m ² |
| Zyrë për financën | 2 | 60 m ² |
| Zyrë për Njësinë e SBC | 1 | 30 m ² |
| Salla për mbledhje | 3 | 180 m ² |
| Mjedis për stafin e shërbimit | 4 | 150 m ² |
| Nyje hidrosanitare për personelin akademik | 8 | 55 m ² |
| Norma m²/për person | | 18.8 m ² /person |

- Dokumentacioni përkatës (planimetritë, të dhëna për teknologjinë e pajisjeve kërkimore) në Aneksin bashkangjitur ketij raporti.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi për Kriteret dhe standardet |
|---|---|
| Standardi II.2 - Baza didaktike dhe mbështetja teknike | |
| <p>Kriteri 1</p> <p>Studentët e pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë kanë kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e kërkimor;</p> | <p>Kriteri 1</p> <p>Fakulteti Juridik mbështetet prej një numri njësisish, procesesh dhe procedurash ndihmëse që janë funksionale në universitet si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Biblioteka e cila bën ruajtjen, përdorimin, pasurimin, shpërndarjen dhe huazimin e pasurisë bibliografike të UET-it. Aty gjenden edhe një numër i madh burimesh on-line. 2. Libraria Universitare e UET-it e cila ofron pasurinë bibliografike akademike dhe atë të mësimdhënies, e vënë në qarkullim për shitje në përputhje me legjislacionin në fuqi. 3. Laboratori i Informatikës i cili ofron shërbimin e internetit në kuadër të kërkimit dhe të shfrytëzimit të artikujve dhe të botimeve të tjera <i>on-line</i>. Kompjuterët në dispozicion mund të shfrytëzohen nga studentët për të punuar esetë dhe detyrat e tjera për lëndët që ndjekin. Laboratori ofron edhe shërbimin e printimit. 4. Auditoret e Universitetit të pajisur me paisjet video dhe audio. 5. Revistat për botime shkencore të cilat botohen prej të tre Fakulteteve të UET, dhe Jus&Justicia në veçanti si Revistë Shkencore e Fakultetit Juridik. 6. Sekretaria mësimore dhe administrative e Shkollës Doktorale që ndihmon studentët me të gjitha çështjet administrative. Koordinimi (i Shkollës Doktorale prej Koordinatorit të Programit të studimit) me të gjitha funksionet e veta të parashikuara në “Rregulloren për organizimin e programeve të studimit të doktoraturës” 7. Tekste dhe leksione të shkruara që u ofrohen doktorantëve prej pedagogëve mësimdhënës dhe udhëheqës së tyre. 8. Shërbimi i fotokopjes, i cili ka si funksion fotokopimin dhe printimin e leksioneve, tezave dhe materialeve të tjera mësimore. 9. UET Press-i i cili është përgjegjës për botimet e teksteve të aprovuar sipas procedurave përkatëse, si dhe angazhohet për publikimin e revistave shkencore të UET-it në bashkëpunim me njësitë e tjera të UET-it, që ngarkohen me përgjegjësi për botimin e tyre. 10. Zyra e Projekteve për Kërkim e |

| | | |
|-------------------------|---|---|
| <p>Kriteri 2</p> | <p>Programi i studimeve të doktoratës siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën kërkimore-shkencore, projekteve</p> | <p>Zhvillim/dhe Qendra UET/Fondacioni per Liri Ekonomike, e cila mbështet dhe koordinon në shkallë institucioni aktivitetet e lidhura me projektet e kërkimit shkencor; iu ofron njësive të tjera të Universitetit informacionin dhe asistencën e nevojshme për hartimin, për ndjekjen dhe për realizimin e projekteve në funksion të procesit mësimor e të kërkimit shkencor, si dhe mban kontaktet e nevojshme me donatorët brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>11. Qendra e Teknologjisë së Informacionit (Zyra e IT-së) e cila është përgjegjëse për funksionimin dhe përditësimin e UMIS-it; për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e sistemeve IT në procesin mësimor, kërkimin shkencor dhe për administrimin e UET-it. Gjithashtu mbështet kualifikimin e personelit akademik dhe administrativ në fushën e përdorimit të teknologjive të informacionit. Mbështet përditësimin e faqes WEB dhe të prodhimit të materialeve grafike për mbështetjen e aktiviteteve të UET-it.</p> <p>12. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cili (KSBC) është njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të Universitetit. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të UET-it.</p> <p>Për ushtrimin e funksioneve të tij, KSBC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Komisioni përbëhet nga Kryetari si edhe nga anëtarë që përfaqësojnë çdo fakultet, personelin ndihmës – akademik ose administrativ, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Kryetari propozohet nga Rektori dhe emërohet nga Presidenti, anëtarët propozohen nga dekanët e fakulteteve përkatës dhe miratohen nga Presidenti. Mënyra e funksionimit të KSBC-së rregullohet me rregullore të veçantë.</p> <p>Gjithashtu përfshihen edhe Njësitë Administrative të UET, të specifikuara në Statutin dhe Rregulloren e UET.</p> <p>Sa më sipër, tregon që studentët e pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë kanë të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e kërkimor në Fakultetin Juridik.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimit të doktoratës të Fakultetit Juridik, organizohet brenda një projekti të madh kërkimor, didaktik,</p> |
|-------------------------|---|---|

kërkimore të miratuara dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë akademike dhe punësim;

kulturor, kërkimi të pavarur dhe realizohet në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarive të kërkimit të çdo fakulteti apo të universitetit në tërësi. Objektivat formuese të programit të studimit të doktoratës janë të gjera, të motivuara dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushën e zgjedhur.

Programi përmban veprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thelluar teorik, të përvetësimit të metodologjive të kërkimit dhe të teknikave operative të posaçme, të realizuara nëpërmjet moduleve mësimore, seminareve me kualifikim të lartë, periudhave të kërkimit pranë strukturave të kualifikuara etj. Programet përfshijnë kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur si bazë për punimin e tezës së doktoratës dhe mbrojtjen e suksesshme që çojnë në marrjen e gradës "Doktor".

Programi i studimit të doktoratës në Shkenca Juridike, është një shkallë e avancuar e studimit dhe kërkimit universitar i cili kërkon që të ofrojë në përputhje me filozofinë e Universitetit Evropian të Tiranës, trajtim dhe zgjidhje për problemet me të cilat përballet shoqëria bashkëkohore shqiptare nëpërmjet krijimit të shkencëtarëve të cilët kanë një formim akademik që u lejon të ofrojnë një mendim të thelluar shkencor, një mendim analitik të plotë. Gjithashtu Universiteti Evropian i Tiranës vë në dispozicion të kandidatëve për doktorë infrastrukturën, metodologjinë, dhe informacionet shkencore më të plota dhe të gjera në fushën e shkencave juridike.

Kandidatët për gradën shkencore doktor, do të kryejnë një studim të thelluar në një fushë të përcaktuar qartë, në të cilën do të dëshmojnë një qasje sa më të plotë dhe një aftësi analizuese e aplikuese në përputhje me problemet e shoqërisë sonë. Kjo vazhdimisht arrihet duke zhvilluar marrëdhënie të ngushta pune e bashkëpunimi me një ose më shumë pedagogë dhe duke shkruar si bashkëautorë me ta studime, kumtesa apo artikuj.

Gjithashtu doktoranteve tanë gjatë kryerjes së studimeve të tyre u jepet asistencë e nevojshme administrative prej strukturave të Shkollës Doktorale dhe Koordinatorit të Programit të Studimit, si edhe një asistencë udhërrëfyese e kualifikuar dhe cilësore prej Udhëheqësve Shkencorë të tyre.

Duke parë CV dhe fushat e ekspertizës së mësimdhënësve dhe udhëheqësve shkencorë, si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor e aktivitetin botues, garantohet realizimi me cilësi i programit të kësaj doktorature në të katër profilet e tij dhe për të gjitha lëndët teorike e metodologjike të propozuara në programin e saj.

Një element i rëndësishëm i studimeve doktorale është fakti që pedagogët udhëheqës së bashku me doktorantët e tyre janë të ndarë sipas profileve të Programit të Studimit, më tej sipas Drejtimeve të Mëdha Kërkimore brenda Profileve, duke pasur në konsideratë Akset Kërkimore të çdo pedagogu. Kjo gjë bën që studentët gjatë udhëheqjeve të tyre të punojnë në grupe të vogla pune në formën e “klasave doktorale” duke shkëmbyer eksperiencën e tyre me njëri-tjetrin.

Gjithashtu garantimi i zbatimit të standardeve të kërkimeve shkencore në zhvillimin e programit të doktoratës vjen si rezultat edhe i verifikimit dhe pranimit të propozimit doktoral, (si një prej elementëve më thelbësorë, që mundëson ndërgjegjësimin e studentëve për temën që ata dëshirojnë të kërkojnë, si edhe mundësimin e përshtatjes më të mirë midis udhëheqësve shkencorë dhe doktorantëve) që doktorantët dorëzojnë që në momentet e para të rregjistrimit të tyre, organizimit të ditëve doktorale, komisioneve të ditëve doktorale, dhe më tej të verifikimit të dosjeve të tyre prej Këshillit të Profesorëve, gjë që mundëson që programi i studimeve të doktoratës të siguroj harmonizim të synimeve të studentit në fushën kërkimore-shkencore, projekteve kërkimore të miratuara.

Si detyrime të tjera akademike gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e përcaktuara në VKM nr. 467, datë 18.07.2007, e ndryshuar.

Të paktën një herë në vit, studenti raporton përpara një komisioni të përbërë nga Drejtori i Shkollës Doktorale, Koordinatori i programit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe udhëheqësi shkencor i temës, komision i cili vendos për vazhdimin normal të programit nga kandidati ose për plotësimet e nevojshme. Nëse nga këto analiza arrihet në përfundimin se studenti nuk është i aftë për vazhdimin e mëtejshëm

| | | |
|-------------------------|---|---|
| <p>Kriteri 3</p> | <p>Programi i studimit të ciklit tretë ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së;</p> | <p>të programit, komisioni mund t'i propozojë Këshillit të Profesorëve ç'regjistrimin e tij nga programi.</p> <p>Një element i rëndësishëm që ndihmon në përgatitjen e studentëve dhe mbajtjen e tyre në kontakt të vazhdueshëm me kërkimin e tyre, janë edhe ditet doktorale që zhvillohen në UET. Në këto ditë doktorantët raportojnë ecurinë e tyre përpara Komisioneve Shkencore që ngrihen me pedagogë udhëheqës të fushave të ngjashme. Vërejtjet dhe sugjerimet që marrin studentët i reflektojnë në punën e tyre.</p> <p>Programet e studimit të doktoraturës janë konceptuar në përputhje me zhvillimet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe në qasje me kërkesat dhe specifikat e tregut të punës vendas dhe atë rajonal e më gjere.</p> <p>Studentët në programet e doktoratës duhet të fitojnë, brenda mundësive eksperiencë në mësimdhënie dhe forma të tjera të shpërndarjes së njohurive mbi projektet e studentëve të doktoratës. Përfshirja dhe kohëzgjatja e angazhimit në aktivitetin e mësimdhënies përcaktohet në marrëveshje me profesorët udhëheqës, brenda mundësive dhe nevojave të njësisë bazë përgjegjëse për programin e doktoratës.</p> <p>Aktualisht në UET, pranë Fakultetit Juridik janë angazhuar në mesimdhënie disa doktorantë.</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Biblioteka e UET-it është një bibliotekë relativisht e pasur dhe me një sistem shumë efektiv për të ndihmuar studentët e këtij universiteti në të trija ciklet e studimeve të tij: Bachelor, Master dhe Doktorat. Kjo bibliotekë disponon disa mijra tituj librash dhe disa revista periodike në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaja. Po kështu, ajo vë në dispozicion të studentëve burime elektronike nga biblioteka të njohura online, duke krijuar mundësi që studentët e UET-it të shfrytëzojnë disa qindramijera libra e revista shkencore nga më prestigjiozet.</p> <p>Ndërsa fondi fizik i bibliotekës së UET-it është me shumë në përdorim të studentëve të niveleve Bachelor dhe Master, bibliotekat online, të cilat UET i ka bërë të aksesueshme për këdo që studion në auditorët e tij, u vijnë më shumë në ndihmë studentëve doktorantë.</p> <p>Ndër to, kryesorët janë <i>Questia</i>, <i>Jstore</i>, <i>Emerald Management eJournal Collection</i>, <i>Cambridge Journals Online</i>, <i>OECD-iLibrary</i>,</p> |
|-------------------------|---|---|

Taylor&Francis Library, Oxford English Dictionary Online, EBSCO Academic Search Priemer, Thomson Reuters dhe Euromonitor International.

Një nga synimet dhe detyrat kryesore të Bibliotekës është pasurimi i fondit të saj. Pasurimi i fondit të bibliotekës është bërë dhe vazhdon të bëhet përmes këtyre rrugëve:

(a) Blerja në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkollore si tekset bazë ose si literaturë e rekomanduar;

(b) Blerja në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor në të trija fakultetet e UET-it;

(c) Përkthimi dhe botimi nga UET Press-it i shumë teksteve (përfshirë universitare dhe monografive shkencore që kanë për autorë pedagoge të UET-it, studiues të tjerë shqiptare dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohore. Këtu bëjnë pjesë edhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga ky universitet, si *Jus & Justicia, Polis, Economicus*, dhe *Sociological Analysis* dhe

(d) Porosive dhe blerja online në Amazon.com. e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet më së miri ekspertiza e UET-it.

I gjithë fondi i librave dhe i periodikëve të bibliotekës është i organizuar dhe i sistemuar në rafta të ndara sipas disiplinave, ose subjekteve, ç'ka u mundëson studentëve që të orientohen shpejt dhe pa vështirësi në gjetjen e literaturës së kërkuar. Fondi është i ndarë sipas fakulteteve të UET-it.

Një vend të veçantë në fondin e Bibliotekës së UET-it zënë titujt e shumë akademike (kryesisht tekste bazë dhe monografi) të botuara nga UET-Press, të cilat kanë autorë shqiptarë ose janë përkthime të disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit të botuara në shqip nga UET Press. Një listë e tyre mund të konsultohet në Bibliotekë.

Qëllimi dhe obligimi i UET-it është që t'i ofrojmë studentëve, sidomos atyre të nivelit doktoral literaturën e nevojshme (librat dhe artikuj revistash) që disponon biblioteka e tij në "hard copy" ose në formë elektronike përmes burimeve online.

Biblioteka ka një staf të kualifikuar që

| | | |
|-------------------------|---|---|
| <p>Kriteri 4</p> | <p>Studentët kanë mbështetjen teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor;</p> | <p>është gjithmonë i gatshëm në ndihmë të studentëve dhe për t'i orientuar ata dhe për të gjetur literaturën që u nevojitet, si edhe për shërbime të tjera bibliotekare. Biblioteka u shërben studentëve edhe si një sallë leximi, duke u ofruar atyre komoditetin dhe fasilitetet e nevojshme.</p> <p>Kriteri 4 Mjediset mësimore janë pajisur me pajisje audiovizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Këtu përfshihen PC-te Projektorët dhe Sistemi i fonisë, etj. Paisjet dhe programet e instaluar në fushën e teknologjisë së informacionit janë të kohës së fudit.</p> <p>Laboratorët e informatikës janë paisur me softëtarët përkatës, në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor. Konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, paketa Microsoft Office 2010 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj.</p> |
| <p>Kriteri 5</p> | <p>Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p> | <p>Kriteri 5 Të gjithë laboratorët janë të paisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore.</p> <p>Praktikisht, në UET funksionojnë Laboratori i Informatikës i cili ofron shërbimin e internetit në kuadër të kërkimit dhe të shfrytëzimit të artikujve dhe të botimeve të tjera <i>on-line</i>. Kompjuterët në dispozicion mund të shfrytëzohen nga studentët për të punuar esetë dhe detyrat e tjera për lëndët që ndjekin. Laboratori ofron edhe shërbimin e printimit. Funksionimi i Laboratorit disiplinohet me rregullore të veçantë.</p> <p>Qendra e Teknologjisë së Informacionit (Zyra e IT-së) e cila është përgjegjëse për funksionimin dhe përditësimin e UMIS-it; për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e sistemeve IT në procesin mësimor, kërkimin shkencor dhe për administrimin e UET-it. Gjithashtu mbështet kualifikimin e personelit akademik dhe administrativ në fushën e përdorimit të teknologjive të informacionit.</p> |

| | | |
|--|--|--|
| | | <p>Mbështet përditësimin e faqes WEB dhe të prodhimit të materialeve grafike për mbështetjen e aktiviteteve të UET-it.</p> <p>Gjithashtu në dispozicion të doktorantëve janë edhe laboratorët e institucioneve bashkëpunuese të UET.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Kriteret e standardit II.2 përmbushen plotësisht. Studentët e pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë në shkencë juridike kanë kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e kërkimor; u mundësohet një bibliotekë shkencore e pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së; Studentët kanë mbështetjen teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor në UET; Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p> | | |

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Studimet e programit të doktoraturës fillimisht janë planifikuar dhe aktualisht mbulohen nga të ardhurat që UET siguron prej tarifave të shkollimit në këtë program, UET po punon aktualisht për përfitimin e financimeve nga angazhimi i stafit pedagogjik dhe kandidatëve të studimeve doktorale në projekte të ndryshme, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Tarifa e shkollimit për ndjekjen e programit doktorale është e përcaktuar me vendim të posaçëm të UET dhe madhësia e saj përmbledh disa vlera dhe parametra:

1. vlerën për pjesën e studimeve të organizuara, që ndahet për çdo modul (lëndë) sipas krediteve përkatëse;
2. vlerën për pjesën e studimeve, që lidhen me periudhën që përmbledh kërkimin shkencor dhe përgatitjen e temës së disertacionit, deri në marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor".

Sipas rregullores së programit të studimit, tarifa e shkollimit mund të paguhet nga studenti plotësisht ose me këste. Nëse ajo paguhet me këste, atëherë kësti i parë paguhet menjëherë me regjistrimin e kandidatit për doktor, ndërkohë që kandidatët që kanë transferuar kredite nga programe të tjera të ciklit të tretë paguajnë vlerën e moduleve (lëndëve) dhe krediteve që ata duhet të fitojnë në programin përkatës të doktoratës në UET.

Aktualisht burimet e financimit përbëhen 100 % nga tarifat e shkollimit në doktoraturë. Shpenzimet mbulohen nga këto burime financiare. Kosto për student është 145.950 lekë të reja. Universiteti Europian i Tiranës (UET) kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpesh përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (plotëso tabelën 7)

Tabela 7

| Të ardhurat nga: | Për vitet e zhvillimit të doktoratës |
|---|---|
| Pushteti qendror | |
| Pushteti vendor | |
| Fonde jopublike: | |
| Grantet për kërkim dhe kontratat | |
| Konsulentat, shërbimet | |
| Tarifat për dhe gjatë shkollimit | 100 % |
| Sponsorizimet | |
| Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) | |
| Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj | |

- Shpenzimet për studentët dhe kosto për mobilitetin e tyre
Studentë të regjistruar në programin e shkollës doktoale në 2 vite janë 387 studente nga të cilët 126 janë pranë Fakultetit Juridik. Kosto për studentë është 145.950 lekë të reja.

- Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet.

Universiti European i Tiranës (UET) kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpk përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Audituesi i pavarur është Znj. Enkelejda Stefani, me liçensë numër 208, datë 04.10.2010, Nipt K 72228006 I.

Rezultati: Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjendjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit 2011 dhe 2012, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Kapacitetet menaxhuese financiare

Projekti financiar hartohet në muajin korrik të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm z. Henri Çili. Për zbatim të këtij projekti, ngarkohet Kancelari i UET dhe Zyra e Financës. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajis me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Menaxheri. Projektbuxheti vjetor hartohet sipas një skenari konservator, të tillë që gjithmonë të ketë një rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

- Dokumentacioni përkatës
- Bilancet vjetore
- Raportet e auditit të pavarur.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi për Kriteret dhe standardet |
|---|--|
| Standardi I.1 - Kuadri i përgjithshëm | |
| Kriteri 5 | <p>Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për kërkim;</p> |
| Kriteri 5 | <p>Ky program mbështetet ne:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pagesat për pedagogët e kontraktuar për udhëheqje shkencore (PAK), sipas kontratave përkatëse, - pagesat e UET për pasurimin e bibliotekës, gjatë periudhës që nga hapja e programit të studimit të doktoraturës, (shihni kapitullin 4. për më shumë detaje), si dhe - pagesën e ardhshme për pajtimin periodik në bazën e të dhënave REUTERS/THOMSON, si një nga bazat më të fuqishme të të dhënave, kryesisht për projektet kërkimore në fushën e financave. Pajtimi në këtë bazë të dhënash kushton rreth 50,000 euro në vit. Lidhur me këtë program, UET është në fazën përfundimtare të pajtimit periodik në bazën e të dhënave REUTERS/THOMSON, si një nga bazat më të fuqishme të të dhënave. Më tej, kjo bazë të dhënash do të shërbejë dhe për programet e tjera studimore si dhe për vetë projektet individuale dhe institucionale kërkimore të stafit pedagogjik të UET. <p>Gjithashtu, në koston për student përlllogaritët detyrimisht dhe kostot që lidhen me realizimin e kërkimit të mjaftueshëm shkencor të doktorantëve</p> <ul style="list-style-type: none"> - edhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit dypalësh me universitetet apo institucionet e tjera, sipas pikës 4.2 të rregullores “Për organizimin e programeve të studimit të doktorates”, - nga shpenzimet që kryen UET për mbështetjen logjistike të të gjithë programeve të studimit. |
| Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor | |
| Kriteri 8 | <p>Financimet e jashtme të përfituara për kërkim shkencor janë tregues të veprimitarisë kërkimore me nivel të lartë dhe administrohen për mbarëvajtjen e programit përkatës të studimeve.</p> |
| Kriteri 8 - NA. | <p>Shkolla doktorale nuk merr aktualisht financime nga jashtë institucionit, lidhur me kërkimin shkencor dhe momentalisht cdo lloj financimi kryhet me fonde të brendshme.</p> |

| Standardi III.1 - Administrimi dhe mjetet për financimin e programit të studimeve të doktoratës | | |
|---|--|--|
| Kriteri 7 | Buxheti financiar i programit të studimeve të doktoratës është i mjaftueshëm për të arritur objektivat kërkimore për çdo doktorant; | Kriteri 7 UET në përcaktimin e tarifave përkatëse të ndjekjes së studimeve për programin e doktoraturës ka përlogaritur dhe marrë parasysh mbulimin optimal të të gjithë elementëve përbërëse të kostove që burojnë nga detyrimi për t'i siguruar doktorantëve përmbushjen sa më të mirë të objektivave të tyre kërkimore. |
| Kriteri 8 | Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të doktoratës përputhet me politikën dhe nevojat e kërkimit shkencor. | Kriteri 8 Sipas nenit 22 të rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të doktorates", në përcaktimin e tarifës së shkollimit dhe ndjekjes së programit të studimeve doktrale merret në konsideratë sigurimi i një harmonizimi optimal midis vlerës së: - studimeve sipas çdo moduli (lënde), në përputhje me kreditet përkatëse, dhe - studimeve për periudhen që lidhet me kërkimin shkencor dhe përgatitjen e temës së diplomës për gradën shkencore "Doktor". Në këtë kuadër, UET planifikon që rreth 10% e tarifës së paguar të shkojë në mbështetje të kërkimit shkencor të doktorantit. |
| Standardi III.3 - Financimi i programit të studimeve të doktoratës | | |
| Kriteri 1 | Numri i punimeve kërkimore të mbështetur financiarisht nga ministria; | Kriteri 1 Aktualisht nuk ka punime shkencore që të jenë mbështetur me mjete financiare nga Ministria. |
| Kriteri 2 | Shpërndarje e fondeve për grupet pritëse dhe drejtuese të punimeve kërkimore është bërë në mënyrë të ekuilibruar; | Kriteri 2 N/A. |
| Kriteri 3 | Numri i punimeve kërkimore të financuara në kuadrin e projekteve kërkimore kombëtare, të përfituara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh; | Kriteri 3 N/A |
| Kriteri 4 | Numri i punimeve kërkimore të financuara në kuadrin e projekteve kërkimore ndërkombëtare të përfituara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh. | Kriteri 4 N/A |
| Konkluzionet e vlerësimit: | | |
| Kriteret e këtij standardi aktualisht plotësohen. Ndërkohë, UET duhet të planifikojë një zë të veçantë për kërkimin si dhe të sigurojë një bazë më të diversifikuar të financimit të kërkimit shkencor, drejt përdorimit dhe të burimeve të jashtme. Shkolla doktrale nuk merr aktualisht financime nga jashtë institucionit, lidhur me kërkimin shkencor dhe momentalisht çdo lloj financimi kryhet me fonde të brendshme. | | |

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

1. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Cilësisë së proceseve akademike në Universitetin Europian të Tiranës (UET) i kushtohet kujdes i vecantë; sigurimi i saj ka karakter gjithëpërfshirës, shoqërohet me kërkesa gjithnjë në rritje për realizimin e të cilave nga secili punonjës kërkohet maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike kujdesen strukturat organizative drejtuese të UET-it, të cilat janë ngritur e veprojnë konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, Dt. 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila në UET njihet edhe si Komisioni i Sigurisë së Brendshme të Cilësisë (KSBC). Kjo njësi e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve të ngritura *ad hoc* dhe që nga Janari i vitit 2011 e në vazhdim në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë të tre fakultetet e UET, nga një përfaqësues nga sektorët ndihmës dhe studentët.

Aktivitetin e saj NJSBC e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar të përvitshëm në të cilin programohen kontrollet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET, rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohet përmes paraqitjes në intranet (Dokumenta UET) të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, etj, legjislacionin përkatës, urdhërat e vendimet e rektoratit të UET, etj. Në këtë kuadër, për secilin program lënde që është pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit në departament. Impakt të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga “fokus grupet” si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Të dhënat e fituara nga këta pyetësore, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të “follow up”, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik.

Në nivelin e doktoraturës, përveç këtyre kontrolleve zhvillohet edhe kontrolli i provimeve “Comprehensive Exam” për studentët e nivelit 2 vjeçar.

Si rezultat i një veprimtarie intensive për sigurimin e brendshëm të cilësisë është fituar një përvojë e gjerë, e cila ka diktuar marrjen e një sërë masash me karakter organizativ dhe metodik. Kështu, theksi është vënë në forcimin e rolit dhe përgjegjësisë së departamentit në proceset akademike, janë gjetur forma të reja për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve, kontrollin e njohurive të fituara nga studentët përmes zhvillimit të detyrave/puneve individuale/eseve, marrjen e masave për të mënjanuar plagjarizmin në diploma, ese, provime, etj.

Në nivel departamenti punohet që të ketë kontakt të vazhdueshëm me studentët, për problemet e tyre dhe për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, në këtë program studimi studentët, në ditët doktorale plotësojnë pyetësorët që lidhen me mbështetjen teknike që japin udhëheqësit doktoralë.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për anëtarët e NJBSC (plotëso tabelën 9)

Tabela 9

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

| | Anëtarët e NJBSC | Detyra që ka në NJBSC | Sa kohë ka në këtë detyrë |
|---|------------------|-----------------------|---------------------------|
| 1 | Përparim Fuga | Kryetar | janar 2011 |
| 2 | Elda Papa | Anëtar | dhjetor 2008 |
| 3 | Evis Gjebrea | Anëtar | mars 2010 |
| 4 | Gilman Bakalli | Anëtar | mars 2010 |
| 5 | Merita Kotorri | Anëtar | janar 2011 |
| 6 | Erjona Canaj | Anëtar | tetor 2012 |
| 7 | Arbi Agalliu | Anëtar | tetor 2012 |
| 8 | Marinela Seitaj | Anëtar | prill 2012 |

- Në NJBSC Fakulteti Juridik perfaqësohet me një anëtar.

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët, pedagogët, udhëheqësit e tezës?
Deri tani është kryer 3 anketime për secilën lëndë sipas 4 profileve
- Sa studentë janë anketuar?
Një numër i konsiderueshëm studentësh, pasi procesi është në vazhdim
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?
Të gjitha përgjigjet e studentëve janë përpunuar. Nuk evidentohet ndonjë problematikë e veçantë në drejtim të mësimdhënies apo të cilësisë së pedagogëve, por raporti ka evidentuar dhe ndonjë çështje që duhet adresuar.
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
Në vijim të punës së NJBC, do ndiqet çdo problem që do të adresohet.

Tabela 9/1

| Rubrikat | Jam plotësisht dakort | Nuk e Di | Nuk jam Dakort |
|---|-----------------------|----------|----------------|
| Literatura e Rekomanduar | 22 | 5 | 3 |
| Etika në komunikim | 30 | | |
| Vlerësimi I provimeve | 27 | | 3 |
| Nr Total I Studenteve të përgjigjur (30) | | | |

- Te dhenat i referohen pyetsorit të bërë për doktorantët e Fakultetit Juridik, për periudhën janar-shkurt 2013. Te dhenat e tjera janë në përpunim e sipër.

- Vlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre. Politikat e ndjekura

- Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET është pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve janë përpunuar tërësisht nga ana e personave përgjegjës për statistikat në UET, ndërsa rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Gjithashtu, në nivel departamenti kontrolli i cilësisë është po ashtu i rëndësishëm, jo vetëm në çertifikimin e syllabuseve të lëndëve, por edhe për efekt të koordinimit, ndjekjes dhe monitorimit të zhvillimit të procesit mësimor-akademik si dhe atij kërkimor e

shkencor. Po ashtu, përgjegjësi i departamentit ka rol të rëndësishëm në monitorimin e performancës së pedagogut gjatë zhvillimit të orës së mësimit, shoqëruar kjo me vlerësimin përkatës, sipas formatit standart të UET për këtë qëllim.

- Të gjitha keto vlerësime, kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit.
- Raportet e Vet-Vlerësimit plotësohen nga secili pedagog dhe diskutohen në mbledhjen e Follow Up që zhvillohet njëherë në vit në muajin Korrik me drejtuesit me të lartë të UET. Në Korrik 2012 vet-vlerësimi i përgatitur nga secili pedagog përfshiu periudhën e fundit 5-vjeçare dhe rezultatet u diskutuan me drejtuesit më të lartë të UET. Në rastet kur drejtuesit konstatuan mospërbushje detyrimesh, UET kërkoi përbushjen e tyre duke përcaktuar afate.

- Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

N/A

- Dokumentacioni përkatës

Bashkangjitur gjenden:

1. Kopje e formularit të anketimit
2. Raporti i auditimit të brendshëm KSBC për silabuset e lëndëve në doktoraturë për të treja fakultetet, si dhe provimet e nivelit dy vjeçar duke qënë se këta studentë zënë peshën më të madhe ndaj numrit total të doktorantëve.
3. Plani kalendar.
4. Formati i syllabusit të lëndëve në doktoraturë.
5. Pyetësori i vlerësimit të pedagogut/udhëheqësit nga studenti

PROGRAMI I STUDIMEVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Misioni i programit të doktoraturës është t'u japë studentëve një edukim cilësor, duke përfshirë brenda tij edhe rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm që t'i shërbejë dijës së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve ndërkombëtare dhe atyre me tregun e punës.

Programi i studimit të doktoratës në Fakultetin Juridik është organizuar brenda një projekti të madh kërkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur dhe është duke u realizuar në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarive të kërkimit të Universitetit Europian të Tiranës. Objektivat formuese të programit të studimit të doktoratës janë të gjera, të motivuara dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushën e zgjedhur.

Formimi i Doktorit të Shkencave kërkon që një pjesë e studimeve të thelluara teorike, një pjesë e krediteve, të zhvillohet nën drejtimin e profesorëve të huaj, në UET ose në Universitetin e Astonit, në Birmingham, si dhe kryerjen e punës kërkimore në universitete ose institute kërkimore jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (tre) muajore dhe jo më të gjatë sesa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës. Fakulteti Juridik në Universitetin Europian të Tiranës, i ofron programet e doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Astonit, Birmingham, Universitetin Politeknik të Tiranës, dhe në të janë

angazhuar edhe pedagogë të huaj (me të cilët ka marrëveshje individuale), si; nga SEEU, Maqedoni, Universiteti AAB, Kosovë, Universiteti i Tiranës, Shkolla e Magjistraturës, etj.

Universiteti i jep studentit që përfundon me sukses doktoraturën titullin “Doktor” ose ekuivalentin me të në varësi të marrëveshjeve aktuale ose të ardhshme që UET ka ose do të krijojë me universitete dhe partnerë të ndryshëm (në anglisht: *Doctoral Degree in Law*).

Organizmi i vitit mësimor zhvillohet konform akteve dhe rregullave në fuqi, që përcaktojnë ngarkesën në auditorë dhe jashtë tyre, sipas krediteve përkatëse të çdo lënde. Mësimdhënia bazohet kryesisht në kombinimin e leksioneve dhe seminareve dhe studimin individual nga ana e studentëve si dhe përdorimin e mjeteve teknologjike. Vlerësimi i njohurive të marra në 7 lëndët teorike finalizohet me nje provim përfundimtar.

Në programin doktoral, sipas planit të miratuar të mësimdhënies së vitit të parë, studenti duhet të grumbullojë 50 kredite, nga të cilat nje pjese te krediteve, i merr permes kurseve të zhvilluara nën drejtimin e personelit akademik të huaj, në UET ose në Aston University. Konkretisht, studenti duhet të ndjekë 7 lëndë, të cilat janë të ndara në dy grupe: (1) lëndë të formimit bazë, që grumbullojnë 35 kredite (Tabela 8) dhe 3 lëndë të profilit me nga 5 kredite secila.

Sipas silabuseve të lëndëve literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse janë përzgjedhur me kujdes të veçantë duke përfshirë tekstet dhe artikujt më të rëndësishëm bashkohorë që përbëjnë bazën e fortë dhe të domosdoshme për përparimin e studentëve drejt qëllimit final.

Tregues të matshëm:

- Elementë të përgjithshëm të Programit të Studimit:
 - Kohëzgjatja; të paktën 3 vite
 - Formim i thelluar teorik (1 vit ose 60 ECTS)
 - Kërkim/krijim: të paktën 2
 - Mbrojtja e Tezës (brenda 4 viteve nga regjistrimi)

Plani mësimor për vitin e parë (sipas modelit të tabelës 8)

Tabela 8

| Lëndë/Module | Semestri | ECTS | Orë mësimore | | | | | | | | | | | | | | | | | Provine |
|--------------|--|------|--------------|------------|--------------|----------|------------|--------------|--|------------|--------------|-----------------|------------|----------------|----------------|----------------|----------|-----|-----|---------|
| | | | Leksione | | | Seminare | | | Leksione te Hapura/ te ftuar special/ vizita studimore | | | Detyra Praktike | | | Orë në auditor | Punë e Pavarur | Gjithsej | | | |
| | | | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | Punë e Pavarur | | | | | | |
| 1 | Metoda Kerkimi 1 | I | 10 | 8 | 4 | 45 | 55 | 3.5 | 27.5 | 60 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 25 | 90 | 160 | 250 | 1 |
| 2 | Metoda kërkimi në Shkencat Juridike | I | 10 | 8 | 4 | 45 | 55 | 3.5 | 27.5 | 60 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 25 | 90 | 160 | 250 | 1 |
| 3 | Studime te avancuara ne te drejten publike | I | 10 | 8 | 4 | 45 | 55 | 3.5 | 27.5 | 60 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 25 | 90 | 160 | 250 | 1 |
| 4 | Studime te avancuara ne te drejten private | I | 5 | 7 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|-----|---|----|----|----|-----|-----|-----|------|-----|----|----|-----|-----|------|------|-----|-----|------|-----|---|
| 5.a | Çështje të historisë së shtetit dhe së drejtës në Shqipëri | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 6.a | E drejtë kushtetuese e avancuar | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 7.a | E drejtë administrative e avancuar | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 5.b | Çështje të historisë së shtetit dhe së drejtës në Shqipëri | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 6.b | E drejtë Ndërkombëtare Penale | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 7.b | Studime të avancuara në të drejtën penale | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 5.c | Zhvillime aktuale në të drejtën ndërkombëtare | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 6.c | E drejtë evropiane e avancuar | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 7.c | E drejtë ndërkombëtare e të drejtave të njeriut | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 5.d | E drejta familjare e avancuar | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 6.d | Studime të avancuara në të drejtën e detyrimeve | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 7.d | E drejta familjare e avancuar | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 5.e | E drejtë ndërkombëtare tregtare | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 6.e | Studime të avancuara në të drejtën e pronësisë intelektuale dhe industriale | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| 7.e | Studime të avancuara në të drejtën e korporatave | II | 5 | 4 | 2 | 35 | 15 | 1 | 5 | 20 | 1 | 5 | 20 | 1.5 | 12.5 | 20 | 50 | 75 | 125 | 1 |
| | Provimi per gjendjen teorike te disiplines | | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Totali | | 60 | 20 | 275 | 225 | 145 | 1025 | 260 | 7 | 35 | 140 | 8.5 | 57.5 | 155 | 470 | 780 | 1250 | 7 | |

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit

Nje kredit ne UET ka vleren prej 25 oresh mesimore (brenda dhe jashte auditorit)

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (plotëso Tabelën 9)

Tabela 9

| Lënda /Moduli | | Pedagogu/Pedagogët përgjegjës | Titulli/grada kualifikimi | Departamenti | Statusi PAE apo PAK |
|---------------|--|---------------------------------|---------------------------|------------------|---------------------|
| 1. | Metoda Kërkimi 1 | Nicola Corkin, Holger Kachelein | PhD | Ekonomiks, ShP | PAK |
| 2. | Metoda kërkimi në Shkencat Juridike | Darjel Sina | PhD | E Drejte Publike | PAE |
| 3. | Studime te avancuara ne te drejten publike | Arjan Vasjari | | E Drejte Publike | PAE |
| 4. | Studime te avancuara në të drejtën private | Clirim Gjata | Dr. | E Drejte Private | PAE |
| 5.a | Çështje të historisë së shtetit dhe së drejtës në Shqipëri | Ferit Duka | Prof.Dr | E Drejte Publike | PAE |
| 6.a | E drejtë kushtetuese e avancuar | Migena Leskoviku | Prof.Asoc.Dr | E Drejte Publike | PAE |
| 7.a | E drejtë administrative e avancuar | Migena Leskoviku | Prof. Asoc.Dr | E Drejte Publike | PAE |
| 5.b | Çështje të historisë së shtetit dhe së drejtës në Shqipëri | Ferit Duka | Prof. Dr. | E Drejte Publike | PAE |
| 6.b | E drejtë Ndërkombëtare Penale | Ksenofon Krisafi | Prof.Dr | E Drejte Publike | PAE |
| 7.b | Studime të avancuara në të drejtën penale | Altin Shegani | PhD | E Drejte Publike | PAK |
| 5.c | Zhvillime aktuale në të drejtën ndërkombëtare | Ksenofon Krisafi | Prof.Dr | E Drejte Publike | PAE |
| 6.c | E drejtë evropiane e avancuar | Xhezair Zaganjori/ Erjona Canaj | Prof.Dr/ PhD | E Drejte Publike | PAK/PAE |
| 7.c | E drejtë ndërkombëtare e të drejtave të njeriut | Xhezair Zaganjori | Prof.Dr | E Drejte Publike | PAK |
| 5.d | E drejta e pronësisë në Shqipëri, në vështrim historik | Ferit Duka | Prof.Dr | E Drejte Publike | PAE |
| 6.d | Studime të avancuara në të drejtën e detyrimeve | Clirim Gjata | Dr. | E drejte Private | PAE |
| 7.d | E drejta familjare e avancuar | Juelda Lamce | PhD | E drejte Private | PAE |
| 5.e | E drejtë ndërkombëtare tregtare | Arnisa Gorezi | PhD | E drejte Private | PAE |

| | | | | | |
|-----|---|---------------|-----|------------------|-----|
| 6.e | Studime të avancuara në të drejtën e pronësisë intelektuale dhe industriale | Juelda Lamce | PhD | E drejte Private | PAE |
| 7.e | Studime të avancuara në të drejtën e korporatave | Arnisa Gorezi | PhD | E drejte Private | PAE |

Syllabus-et për çdo lëndë, ku pasqyrohen këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
 - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
 - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
 - Format e vlerësimit të studentëve
 - Detyrimet e studentit për lëndën
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse
- Syllabuset aktuale, i permbahen ketyre elementeve. Bashkangjitur, raportit, modeli i syllabust ne doktorate.

Procedurat që ndiqen për aprovimin e projektit kërkimor të propozuar nga kandidatët

Aplikantët e shkollës doktorale të Fakultetit Juridik UET, që kanë parashtruar kërkesën për t'u pranuar në programin doktoral përzgjedhin fillimisht drejtimin përkatës të studimit, sipas drejtimeve të ofruara nga institucioni. Më tej, ata plotësojnë formularin e Projekt-propozimit doktoral, sipas rubrikave përkatëse, pasi kalojnë dy konsultime të nevojshme. Së pari nevojitet konsultimi me Koordinatorin e Fakultetit Juridik për Shkollën Doktorale në lidhje me temën e përzgjedhur nga doktoranti. Së dyti, doktoranti zhvillon një seancë konsultuese me koordinatoren për çështjet metodologjike të projekt-propozimit.

Të dhëna për vitin e dytë (Kërkim/Krijim). Të dhëna për Institucionet brënda ose jashtë vendit, ku studentët kanë kryer kërkimet e tyre shkencore:

- Universitet/Qëndër kërkimi dhe zhvillimi të Universitetit
- Institut/Enti i kërkimit joakademik
- Fondacion/Subjekt publik/subjekt privat
- Strukturë spitalore
- Tjetër

Në vitin e dytë të studimeve doktorale kandidati zgjedh temën e disertacionit të doktoraturës, e cila miratohet nga Këshilli i Profesorëve i universitetit. Bashkë me miratimin e temës dhe udhëheqësit, ky i fundit miraton planin individual të punës studimore-kërkimore të kandidatit. Menjëherë pas kësaj, kandidati nis punën kërkimore duke mbledhur të dhënat e nevojshme në terren (në rast se studimi ka karakter empirik), apo në burime të tjera informacioni sipas rastit. Në fund të vitit të dytë, kandidati duhet t'i paraqesë për miratim udhëheqësit shkencor propozimin për dizertacionin e doktoraturës. Rekomandohet që brenda vitit të dytë të studimeve doktorale, studenti të mund të paraqesë një punim nga tema e disertacionit të tij në një konferencë apo seminar shkencor dhe, mundësisht, të ketë botuar një artikull (si autor i vetëm apo si bashkautor) në një revistë shkencore, apo të ketë marrë zyrtarisht konfirmim për botimin e tij nga redaksia e një reviste shkencore. Doktorantët kalojnë në vitin e tretë pasi të kenë dëshmuar njohjen e gjuhës angleze, përmes testeve të njohura ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi.

Formimi i Doktorit të Shkencave kërkon që një pjesë e studimeve të thelluara teorike, një pjesë e krediteve, të zhvillohet nën drejtimin e profesorëve të huaj, në UET ose në

Universitetin e Astonit, në Birmingham, si dhe kryerjen e punës kërkimore në universitete ose institute kërkimore jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (tre) muajore dhe jo më të gjatë sesa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës. Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik i ofron programet e doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Astonit, Birmingham, Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në të janë angazhuar edhe pedagogë të huaj (me të cilët ka marrëveshje individuale) nga Universiteti i Europës Juglindore, Maqedoni, Universiteti AAB, Kosovë si edhe pedagogë të tjerë të mirënjohur nga Universiteti i Tiranës, Shkolla e Magjistratures, etj.
Për këtë kriter janë krijuar kushtet për përmbushjen e tij në vijim.

- Të dhëna për vitin e tretë: Kërkim/Krijim + Përpunim të dhënash + Botim artikujsh + Referime
 - Të dhëna për botimet/referimet e studentëve ;
 - Të dhënat për Revistat, entet botuese ku janë botuar këto artikuj

Gjatë vitit të tretë, kandidati vazhdon të thellohet në punën e tij studimore. Ai analizon teorikisht dhe përpunon të dhënat e mbledhura dhe fillon të shkruajë disertacionin. Në proces e sipër, studenti punon për të paraqitur një kumtesë tjetër nga tema e disertacionit në një konferencë apo seminar shkencor dhe të botojë artikuj (si autor i vetëm ose në bashkautorësi) në revista shkencore. Doktoranti harton tezën e doktoraturës dhe e mbron atë sipas procedurës së përcaktuar nga ligji dhe rregullorja e programit të studimit.

Lidhur me të dhënat e botimeve, referimeve të studentëve dhe revistave përkatëse shihni Kapitullin 10 dhe Tabelën 13.

- Të dhëna për hartimin e tezës së doktoratës dhe mbrojtjen e saj

Punimi duhet te respektoje kërkesat e formatit të miratuar. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotesohen të gjitha kërkesat e formatit. Në rast të mospranimi, studenti lajmërohet me shkrim nga Drejtori i Shkollës Doktorale mbi vendimin e marrë. Në rast pranimi procedura vazhdon më tej. Tre kopje të punimit shkencor duhet të jene origjinale dhe dorezohen në shqip. Në kopertinë vendoset emri i UET-it, fakultetit, programit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes.

Pjesa e pasme e kopertinës duhet të përmbajë:

- Abstraktin në shqip dhe në anglisht. Secili variant duhet të përmbajë 200 fjalë dhe shkruhet me shkronja të masës 10-she. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marre ne studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare, madje mund të parashikohet që i gjithë punimi të dorëzohet në gjuhën angleze.
- Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe, në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disipinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

Punimi origjinal shoqërohet edhe me një përmbledhje (rreth 20 mijë fjalë), në shqip dhe anglisht, në 3 (tri) kopje secila. Autoreferati përgatitet në 10 kopje, në shqip dhe anglisht, nga të cilat anëtarët e jurisë marrin secili nga një kopje. Rregullat specifike të paraqitjes së punimit, formatimit, etj. përcaktohen me udhëzim të veçantë. Aktualisht në UET nuk ka filluar procesi i mbrojtjes së disertacioneve.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi për Kriteret/ standardet |
|--------------------|------------------------------------|
|--------------------|------------------------------------|

| Standardi I.4 - Hartimi dhe realizimi i kursit teorik të ciklit tretë të studimeve (doktoratë) | | |
|---|---|--|
| Kriteri 1 | Programet e studimeve të ciklit të tretë përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike; | Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të tretë përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike (shih <i>Tabela 8</i>). |
| Kriteri 2 | Në studimet e organizuara teorike janë parashikuar, të ekuilibruara, raportet e orëve për formim akademik dhe shkencor të përgjithshëm me atë specifik; | Kriteri 2 Doktorantët marrin 35 kredite në lëndët formuese, 15 kredite për lëndët specifike dhe 10 kredite në provimin për gjendjen teorike të disiplinës (shihni <i>Tabela 8</i>). |
| Kriteri 3 | Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve nënligjore në fuqi; | Kriteri 3 Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve nënligjore në fuqi nga Drejtori i Shkolles Doktorale dhe Kryetari i Këshillit të Profesorëve (në përputhje me <i>ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007</i> i ndryshuar me <i>ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007</i> dhe <i>Nr. 10307, datë 22.07.2010, Neni 26, pika 1.3, Neni 27, pika 2. Rregullore për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoraturës</i>). |
| Kriteri 4 | Kursi teorik i doktoratës vlerësohet me një provim të përgjithshëm teorik, në fushën përkatëse të studimeve, të organizuar nga dekanati dhe Këshilli i Profesorëve me një komision të përbërë nga 5 (pesë) Profesorë të fushës kërkimore përkatëse ose të përafërt me të. Kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e doktoratës. | Kriteri 4 Në shkurt të vitit 2013 u zhvillua provimi për gjendjen teorike të disiplinës (shihni <i>Tabelen 8</i>). Provimi u organizua nga dekanati dhe Këshilli i Profesorëve, me një komision të përbërë nga pesë Profesorë të fushës përkatëse. Në <i>Rregulloren për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoraturës, (pika 11)</i> përcaktohet se kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e doktoratës. |

| Standardi II.3 - Hartimi dhe miratimi i projektit kërkimor të propozuar | | |
|--|--|--|
| Kriteri 1 | Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve të doktoratës ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë kërkimi dhe kjo është diskutuar me të gjatë intervistës; | Kriteri 1. Aplikantët e shkollës doktorale të Fakultetit Juridik UET, që kanë parashtruar kërkesën për t'u pranuar në programin doctoral përzgjedhin fillimisht drejtimin përkatës të studimit, sipas drejtimeve të ofruara nga institucioni. Më tej, ata plotësojnë formularin e Projekt-propozimit doctoral, sipas rubrikave përkatëse, pasi kalojnë dy konsultime të nevojshme. Së pari, nevojitet konsultimi me Koordinatorin e Fakultetit Juridik për Shkollën Doktorale në lidhje me temën e përzgjedhur nga doktoranti. Së dyti, doktoranti zhvillon një seancë |

| | | |
|-------------------------|--|--|
| <p>Kriteri 2</p> | <p>Fusha e hulumtimit/kërkimit është përzgjedhur në mënyrë të tillë që programi i studimeve të doktoratës të mund ta mbështesë atë;</p> | <p>konsultuese me koordinatoren për çështjet metodologjike të projekt-propozimit.</p> <p>Kriteri 2. Drejtimi doktoral i përzgjedhur nga doktoranti duhet të përkojë me drejtimet e ofruara nga Fakulteti Juridik dhe ky përbën kriter për vazhdimin e doktoratës. Gjithashtu, gjaë konsultimit me koordinatorin e Fakultetit Juridik për Shkollën Doktorale, nëndrejtimi kërkimor i doktorantit pozicionohet në varësi të akteve kërkimore të profesorëve udhëheqës brenda një drejtimi doktoral. Pas plotësimit dhe kontrollit të sukseshëm të projekt-propozimit doktoral nga dy koordinatorët e sipërpërmendur, propozimi kalon për miratim në Këshillin e Profesorëve të UET.</p> |
| <p>Kriteri 3</p> | <p>Propozimi miratohet nga Këshilli i Profesorëve, në rast se plotësohen kriteret e parashikuara dhe të shpallura në rregulloren e studimeve të doktoratës. Gjithashtu duhet të konfirmohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kohëzgjatja e programit të studimeve; b) Modalitetet e verifikimit të veprimtarisë kërkimore apo krijuese të studentëve të doktoratës; c) Mënyra e paraqitjes përfundimtare të rezultatit të kërkimit që do arrijë doktoranti; | <p>Kriteri 3. Në varësi të krediteve të fituara në programet e ciklit të dytë të studimit, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e UET, doktoranti vazhdon studimet për sistemin dy ose tre vjecar, kohëzgjatje e cila parashikohet edhe në kontratën e doktoraturës.</p> <p>Doktoranti ka për detyrë të raportojë cdo 3 muaj duke plotësuar raport-progreset 3 mujore të doktoraturës mbi ecurinë e studimit doktoral si dhe mbi plotësimin e kriterëve të pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe realizimit të botimeve shkencore. Raport-progreset firmosen pas cdo dite doktorale nga udhëheqësi shkencor i doktorantit dhe depozitohen në sekretarinë e shkollës doktorale sipas dosjeve përkatëse. Paraqitja përfundimtare e rezultatit të kërkimit realizet nëpërmjet mbrojtjes së sukseshme para komisionit doktoral, pas miratimit zyrtar të udhëheqësit shkencor të doktorantit.</p> |
| <p>Kriteri 4</p> | <p>Një anëtar i personelit akademik me titull “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose me gradën shkencore “Doktor” apo (“PhD”) të fituar në fushën shkencore, në të cilën vazhdon studimet doktoranti, në universitete, të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, është emëruar nga Këshilli i Profesorëve për të udhëhequr dhe për të mbështetur punën kërkimore të studentit;</p> | <p>Kriteri 4. Udhëheqësi doktoral propozohet nga koordinatori i Fakultetit Juridik për Shkollën Doktorale, në varësi të korrespondimit midis temës së doktorantit dhe aksit kërkimor të udhëheqësve që mbajnë gradën Profesor, Profesor i Asociuar apo PhD të fituar në universitete të njohura në botë. Këshilli i profesorëve vendos më pas emërimin zyrtar të udhëheqësit shkencor të doktorantit.</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>Kriteri 5</p> <p>Kriteri 6</p> | <p>Studenti i doktoratës paraqet para Këshillit të Profesorëve planin e zhvillimit të kërkimit, të hartuar prej tij dhe të diskutuar me udhëheqësin e vet;</p> <p>Udhëheqësi i ka këshilluar në mënyrë të vazhdueshme studentët që udhëheq, për detyrat didaktike dhe aktivitetet kërkimore si edhe për metodologjinë e hulumtimit për të siguruar ecurinë e tij/tyre në këtë program studimesh.</p> | <p>Kriteri 5. Projekt –propozimi doktoral ku parashtrohen elementët e kerkimit shkencor paraqitet për miratim, pas miratimit paraprak nga udhëheqësi shkencor, para Këshillit të Profesorëve.</p> <p>Kriteri 6. Udhëheqësi shkencor është i detyruar të zhvillojë takime e konsultime sistematike me doktorantët e tij dhe të plotësojë raport-progreset 3 mujore të vlerësimit të veprimtarisë së doktorantit mbi ecurinë në lidhje me studimin doktoral dhe ecurinë në lidhje me plotësimin e kriterëve të pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe të realizimit të botimeve shkencore. Udhëheqësi doktoral ndjek sistematikisht punën e doktorantit nga pikëpamja metodologjike dhe përmbajtësore, duke vendosur miratimin ose jo të kapitujve përkatës. Doktoranti plotëson në raport-progresin e tij edhe pjesën mbi vlerësimin e tij në lidhje me kontributin dhe gadishmërinë për bashkëpunim nga ana e udhëheqësit doktoral.</p> |
|---|--|---|

Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor

| | | |
|-------------------------|--|--|
| <p>Kriteri 1</p> | <p>Një program studimi i ciklit tretë (doktoratë) është i integruar në veprimtarinë kërkimore të Institucioneve të Arsimit të Lartë;</p> | <p>Kriteri 1 Programet e studimit të doktoratës në UET organizohen brenda një projekti të madh kërkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur dhe realizohen në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarive të kërkimit të çdo fakulteti apo të universitetit në tërësi. Ato organizohen edhe si programe ndërdisiplinore ose të përbashkëta. Objektivat formuese të programeve të studimit të doktoratës janë të gjera, të motivuara dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushen e zgjedhur apo në fushat e zgjedhura në rastin e doktoratave të dy ose me shumë disiplinave. (Pika 3.2 e <i>Rregullores për organizimin e programeve të studimit të doktoratës</i>). Për pedagogët që udhëheqin doktorantë, politika e UET ka qënë gjithmonë që të arrihet një emërues i përbashkët midis punës shkencore të pedagogut udhëheqës dhe interesave të studentëve doktorantë duke mundësuar kështu me shumë udhëheqje. Si rezultat ka një ndërthurje të punës shkencore të pedagogut me atë të doktorantit, gjë që shprehet në referime ose botime të përbashkëta. Gjithashtu kjo shprehet edhe në ndarjen e</p> |
|-------------------------|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| | | udhëheqësve sipas drejtimeve të mëdha kërkimore, mbështetur mbi akset e tyre kërkimore. <i>Ka botime në revista të ndryshme dhe disa referime të përbashkëta pedagog-doktorant. në 2 vitet a fundit.</i> Programi i ciklit tretë (doktoratë) është i integruar në veprimtarinë kërkimore të UET; |
|--|--|--|

| Standardi II.4 - Udhëheqja e doktorantëve dhe vlerësimi në vazhdimësi i ecursisë së studimeve të doktoratës | | |
|--|---|--|
| Kriteri 1 | Udhëheqësi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit. Ai ka titullin akademik “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” apo (“PhD”) të fituar në universitetet perëndimore dhe ka veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese; | <p>Kriteri 1</p> <p>Udhëheqësi shkencor është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës së tij kërkimore, ne perputhje me rregulloren e programit të studimit. Konkretisht, për ditët doktorale të zhvilluara në UET janë plotësuar progres-raportet nga ana e udhëheqësve dhe studentëve.</p> <p>Udhëheqësit shkencorë kanë veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese si edhe kanë titullin akademik “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” apo (“PhD”) të fituar në universitetet perëndimore (sikurse vërehet edhe nga CV-te e tyre). Duhet përmendur se këtu përfshihen edhe udhëheqës që kanë gradën Dr. (PAE në UET), që janë në proces aplikimi për titullin “Profesor i Asociuar”. Këtu përfshihen edhe pedagogë të jashtëm me titullin “Profesor i Asociuar” (<i>Tabela e Udhëheqësve të Doktoraturës</i>). Lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore të udhëheqësve gjatë viteve të fundit shihni Tabelën 13.1. (UET i del detyrë të plotësojë personelin konform udhëzimit 22, dt. 14/09/2012 të MASH.)</p> |
| Kriteri 2 | Të gjithë udhëheqësit shkencorë kanë pasur ekspertizën, instruksionin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tyre në realizimin e projektit kërkimor-shkencor të studentëve të doktoratës; | <p>Kriteri 2</p> <p>Udhëheqësit shkencorë e kanë ekspertizën, instruksionin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tyre në realizimin e projektit kërkimor-shkencor të studentëve të doktoraturës (<i>Udhëzues mbi Diplomat Doktorale në Universitetin Europian të Tiranës, Udhëzuesi mbi Ditët Doktorale në UET dhe të gjitha komunikimet me drejtuesit e Shkolles Doktorale, Rregullorja e programit të studimit, etj</i>).</p> |
| Kriteri 3 | Udhëheqësit shkencorë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve; | <p>Kriteri 3</p> <p>Sipas kontratave të punës, pedagoget (PAE) janë të detyruar të realizojë të paktën dy artikuj në vit, të marrë pjesë të paktën në dy konferenca shkencore, si dhe të kenë pjesëmarrje në projekte me karakter</p> |

| | | |
|------------------|--|--|
| | | <p>aplikativ ose kërkimor shkencor, punë kjo që bën të mundur udhëheqjen e doktorantëve (<i>kontrata e punës tip</i>). Këtu përfshihen dhe interesat individuale, në lidhje me punën kërkimore-shkencore të çdo pedagogu. Lidhur me PAK-të, në këtë proces ndihmon procedura e përzgjedhjes së tyre (Kapitulli 3).</p> <p>Kriteri 4 Udhëheqësit shkencorë kanë veprimtari të bollshme shkencore, brenda dhe jashtë vendit, e mbi këtë bazë janë gjykuar të aftë të drejtojnë punën kërkimore të doktorantëve (shihni Tabelën 13/1). Per PAE-t, çdo departament i Fakultetit Juridik, ka krijuar një direktori të veçantë (shihni Direktorine “DOKUMENTA UET”), në të cilën ndodhen e gjithë veprimtaria kërkimore, shkencore dhe botuese e PAE-ve.</p> <p>Kriteri 5 Udhëheqësit shkencorë veprojnë në përputhje me përcaktimet që jep pika 15 e Rregullores “Per organizimin e programeve të studimit të doktorates”. Kjo vërtetohet edhe nga progres-raportet përkatëse.</p> <p>Kriteri 6 Kjo procedurë përcaktohet në pikën 15.4 të Rregullores “Per organizimin e programeve të studimit të doktorates”. Në disa raste, për disa studentë janë ndërruar drejtuesit fillestarë të tyre.</p> <p>Kriteri 7 Eshtë respektuar në përputhje me përcaktimin në pikën 15.3 të Rregullores “Per organizimin e programeve të studimit të doktorates”. Një tregues i matshëm për këtë qëllim është organizimi i ditëve doktorale, ku në mënyrë të planifikuar dhe të detyruar takohen studentët me udhëheqësit e tyre.</p> <p>Kriteri 8 Modalitetet përkatëse përcaktohen në pikën 15.4 të Rregullores “Per organizimin e programeve të studimit të doktorates”.</p> <p>Kriteri 9 Modalitetet përkatëse përcaktohen në pikën 15.5 të Rregullores “Per organizimin e programeve të studimit të doktoratës”.</p> |
| Kriteri 4 | Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit shkencorë, të aftë për të drejtuar punën kërkimore të doktorantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit; | |
| Kriteri 5 | Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur programi i studimeve të doktoratës ofrohet nga më shumë se një universitet) siguron/jnë që studentët e doktoratës të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre për arritjen e suksesit; | |
| Kriteri 6 | Në të gjitha rastet, studenti duhet të ketë vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studenti duhet të dijë se kush do të jetë personi që do ta zëvendësojë; | |
| Kriteri 7 | Universiteti siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur studentin e doktoratës; | |
| Kriteri 8 | Në qoftë se udhëheqësi kryesor nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit, ose do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme, ai duhet të zëvendësohet nga një udhëheqës tjetër para periudhës së marrjes së diplomës për gradën shkencore “Doktor”; | |
| Kriteri 9 | Nëse marrëdhënia student-udhëheqës nuk funksionon mirë, me kërkesë të studentit ose të mbikëqyrësit të tij, ndryshohet udhëheqësi, me kusht që kjo të mos cenojë ecurinë e projektit; | |

| | | |
|--------------------------|--|---|
| <p>Kriteri 10</p> | <p>Janë përcaktuar procedura të qarta dhe transparente për verifikimin e dijeve apo vlerësimin periodik të studentit (për shembull, një rishikim vjetor nga një panel i thirrur për këtë qëllim ose nga një komision i posaçëm i ngritur nga Këshilli i Profesorëve). Studenti i doktoratës dhe udhëheqësi i tij duhet të jenë të pranishëm gjatë këtij procesi. Mënyra dhe periudhat e verifikimit të dijeve apo vlerësimit periodik të studentit të doktoratës parashikohen dhe specifikohen që në fillim të programit të studimeve të doktoratës;</p> | <p>Kriteri 10</p> <p>Deri tani janë zhvilluar 3 ditë doktorale, ku studentët kanë raportuar dhe kanë kryer prezantime të progresit të punës së tyre si dhe kanë informuar rreth konferencave të ardhshme, ato të zhvilluara si dhe publikimet e tyre. Referimet dhe publikimet konkretizojnë zhvillimin e doktorantit (<i>Udhëzuesi i organizmit të ditëve doktorale, procedura e organizmit të ditëve doktorale dhe komisionet doktorale</i>).</p> |
| <p>Kriteri 11</p> | <p>Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, për realizimin e projektit kërkimor shkencor të programit të studimeve të doktoratës, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet e doktoratës;</p> | <p>Kriteri 11</p> <p>Në pikën 11.5 të Rregullores “Per organizimin e programeve të studimit të doktoratës” përcaktohet kjo procedurë. Kjo procedurë në UET do të zbatohet pas përfundimit të provimit për gjendjen teorike të disiplinës (comprehensive exam), në muajin prill. Deri në këtë moment janë ditët doktorale që realizojnë vlerësimin e studentëve. Ky kriter plotësohet.</p> |
| <p>Kriteri 12</p> | <p>Takimet ndërmjet udhëheqësve dhe doktorantëve janë të dokumentuara, sidomos gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit.</p> | <p>Kriteri 12</p> <p>Ky kriter plotësohet, pasi udhëheqësit, në fund të ditëve doktorale, plotësojnë progres-raportet dhe u bëjnë të ditur vërejtjet dhe sugjerimet e tyre studentëve.</p> |
| <p>Kriteri 13</p> | <p>Udhëheqësi shkencor me titullin akademik "Profesor", i punësuar me kohe të plote, udhëheq njëkohësisht jo me shume se pese doktorante. Udhëheqësi shkencor me titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe udhëheqësi shkencor me gradën shkencore "Doktor" ("PhD) të fituar pranë universiteteve perëndimore, i punësuar me kohe të plote, udhëheq njëkohësisht, jo me shume se dy doktorante. Udhëheqësi me titullin akademik "Profesor", i punësuar me kohe të pjesshme, udhëheq vetem nje doktorant</p> | <p>Kriteri 13</p> <p>Në pikën 4.1 të RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS”, thuhet: Hapja e programeve të doktoratës bëhet e mundur nëse institucioni plotëson kushtet e mëposhtme: ka personel akademik me titull "Profesor", "Profesor i Asociuar" ose me gradën shkencore "doktor" të fituar në universitete perëndimore. Personeli akademik duhet të ketë, se paku, dy vjet përvojë mësimore kërkimore pas doktoraturës. Sipas Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 21 të datës 30.07.2009, i cili ishte në fuqi kur filloi shkolla doktorale në UET, thuhet se: Numri i studenteve që mund të udhëheqë njëkohësisht një udhëheqës shkencor përcaktohet nga Këshilli i Profesorëve, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më i madh se 3 deri në 5 studentë në vit, me kusht që temat të jenë të fushave të përafërta. Kriteri plotësohet për PAE me titull "Profesor</p> |

| | | |
|--|---|---|
| | | <p>i Asociuar" dhe gradë PhD si edhe PAK me titull "Profesor i Asociuar", sipas Udhëzimit nr. 21; por jo sipas Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 22, datë 14/09/2012.</p> <p>(Në kriteret dhe respektimin e tyre referenca është bërë në lidhje me udhëzimin nr. 21 të MASH).</p> |
| <p>Standardi II.5 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve në këtë cikël studimesh</p> | | |
| <p>Kriteri 1</p> | <p>Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Njohuri të thelluara në fushën përkatëse shkencore; b) Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; c) Aftësi profesionale në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet kritike që lidhen me fushën e tij të kërkimit; d) Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese; e) Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja që nxisin kërkimin shkencor; | <p>Kriteri 1</p> <p>Sipas nenit 11.5 të Rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës", kërkohet që studentit të paktën 1 herë në vit të raportojë përpara një komisioni mbi ecurinë e tij lidhur me tezën dokto­rale. Kjo procedurë në UET do të zbatohet pas përfundimit të provimit për gjendjen teorike të disiplinës (comprehensive exam), në muajin prill. Deri tani janë zhvilluar 3 ditë dokto­rale, ku studentët kanë raportuar dhe kryer prezantime të progresit të punës së tyre si dhe kanë informuar mbi konferencat e ardhshme, ato të zhvilluara dhe publikimet e tyre për këtë qëllim. Këto referime dhe publikime janë një mënyrë ku studentit tregon zhvillimin e tij profesional sipas nënpikave të këtij kriteri. Janë krijuar kushtet që ky kriter të plotësohet.</p> |
| <p>Kriteri 2</p> | <p>Studenti jep prova që me anë të kërkimit shkencor të realizuar, ai ka sjellë produkte shkencore origjinale, punime shkencore të një niveli të lartë shkencor, disa prej të cilave kanë merituar a meritajnë publikimin në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;</p> | <p>Kriteri 2</p> <p>Sipas pikës 11.3 të Rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës", gjatë periudhës së studimeve të doktoraturës para paraqitjes në mbrojtje studentit duhet të ketë përmbushur, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tre referime ose paraqitje shkencore nga të cilat 2 në vende të zhvilluara, -botime si autor i parë në së paku 3 artikuj shkencore nga të cilat 2 në vende të zhvilluara në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial. <p>Prova të kësaj janë: raportimet e studentëve para komisioneve dokto­rale, botimet e studentëve në revista shkencore (shihni Kapitulli 10.) si dhe përmbushja e detyrimit të pikës 5.1.(i) të rregullores të programit të studimit (pikë kjo e paaplikueshme, pasi ende nuk ka filluar procesi i mbrojtjes së disertacioneve). Janë krijuar kushtet që ky kriter të plotësohet.</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>Kriteri 3</p> | <p>Vlerësimi përfundimtar i studentëve të doktoratës bazohet mbi të gjitha në një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij;</p> | <p>Kriteri 3 Pika 14 e Rregullores “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës” përcakton rregullat mbi etikën e kërkimit. Konkretisht, në pikën 14.1 kur studenti dorëzon disertacionin kandidati deklaron me shkrim se studimi është punë origjinale e tij. Po kështu në pikën 15.3.(c) përcaktohet se udhëheqësi ka përgjegjësi të vetëdijesojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës. Lidhur me botimin e punimeve origjinale shkencore gjithashtu sipas pikës 15.3(h) udhëheqësi e nxit studentin që të botojë pjesë nga kërkimi i tij. Në ditët doktorale studentët raportojnë përpara një komisioni shkencor me profesorë të fushes dhe pjesëmarrësve studentë doktorantë. Janë krijuar kushtet që ky kriter të plotësohet.</p> |
| <p>Kriteri 4</p> | <p>Mbi bazën e një marrëveshjeje të arritur që në fazën e miratimit të programit të studimeve, rezultati i kërkimit të paraqitet si tezë disertacioni, ose kumulativ me 3 artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti me koeficient mbi 1;</p> | <p>Kriteri 4 NA.</p> |
| <p>Kriteri 5</p> | <p>Në rastin e provimit në doktoratë me tezë disertacioni doktoranti ka plotësuar kushtet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Ka realizuar si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare, në një vend perëndimor (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je; b) Ka botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, dy prej artikujve janë botuar ose pranuar për botim në revista të njohura perëndimore, me bord editorial; c) Ka përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e Profesorëve të fakultetit disertacionin, së bashku me një përmbledhje, të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Struktura e disertacionit dhe e përmbledhjes së tij përcaktohen në rregulloren e studimeve të doktoratës; | <p>Kriteri 5 Këto kushte përcaktohen në pikat 11.4.1 dhe 11.4.2 të rregullores, e cila i bashkangjitet si aneks kontratës që studenti fitues për ndjekjen e studimeve të doktoratës lidh me UET. Në ditët doktorale që Shkolla Doktorale organizon, studentët janë të detyruar të paraqesin planin e ecures së punës lidhur me zhvillimin e konferencave dhe botimeve. Udhëheqësi shkencor sipas pikës 15.3 (f) të rregullores ka përgjegjësinë të vlerësojë progresin e studentit duke i kërkuar të paraqesë një raport të shkruar dhe monitoron punën e tij përkundrejt standartit të kërkuar. Pika 13 e rregullores përcakton rregullat për paraqitjen e punimit dhe literaturës. Sipas pikës 13.5 rregullat specifike të paraqitjes së punimit, formatimit etj. përcaktohen me udhëzimin e miratuar nga Shkolla Doktorale “Mbi Diplomat Doktorale në Universitetin Europian të Tiranës”. Shkolla doktorale për pjesën e Fakultetit Juridik, është aktualisht në proces të përbushjes së këtij detyrimi.</p> |
| <p>Konkluzionet e vlerësimit: Standardet I.4, II.1, II.3 dhe II.4 plotësohen në pjesën më të madhe të kriterëve të tyre. Pjesërisht plotësohen kriteri 4 i standardit II.3 dhe kriteret 1 e 13 të standardit II.4. Përsa i përket standartit II.5, konstatohet se janë krijuar kushtet që kriteret e tij të plotësohen, por ende procesi i doktorimit të kandidateve vazhdon</p> | | |

- Dokumentacioni përkatës

8. Mësimdhënia (në vitin e formimit teorik)

Pjesa përshkimore

Organizmi i mësimdhënies zhvillohet konform akteve dhe rregullave në fuqi, që përcaktojnë ngarkesën në auditorë dhe jashtë tyre, sipas krediteve përkatëse të çdo lënde. Mësimdhënia bazohet kryesisht në kombinimin e leksioneve dhe seminareve dhe studimin individual nga ana e studentëve si dhe përdorimin e mjeteve teknologjike adekuate. Për sa i përket vlerësimit të njohurive të marra në 7 lëndët teorike ai kryhet nëpërmejt një provimi 100 pikësh.

Procesi i mësimdhënies shfrytëzon një infrastrukturë dhe teknologji moderne, të përshtatshme e komode, për të siguruar një proces optimal mësimdhënie dhe të përfitimit të njohurive dhe dijeve shkencore (Kapitulli 4, për më shumë informacion).

Gjithashtu, student/i/ja që ka perfunduar ose vijon studimet në një program studimi të ciklit të tretë, mund të transferoje kreditet e fituara në programin e doktoraturës, sipas procedurave të percaktuara në rregulloren përkatëse të UET për këtë qëllim.

Lidhur me kontrollin e njohurive të studentëve, studentët e çdo lloj kategorie të regjistruar në programet e doktoraturës, në fund të vitit të parë, i nënshtrohen provimit të gjendjes teorike të disiplinës (CE), që teston themelin e formimit teorik të tyre dhe mbart 10 kredite (duke plotësuar detyrimin e 60 krediteve të shkollës doktrale). Ky provim jepet i bazuar mbi një listë librash (deri në 25 libra), listë kjo që hartohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale dhe e miratuar nga Këshilli i Profesorëve. Për sa i përket vlerësimit të provimeve ai kryhet nga një komision, në përbërje të të cilit ka 5 profesorë të fushës kërkimore përkatëse, ose të përafërt me të. Studentët që marrin një rezultat mbi 80 % të pikëve, kanë të drejtë të vijojnë me pjesën kërkimore të studimeve doktrale. Ata që dështojnë në arritjen e këtij rezultati pajisen nga UET/shkolla doktrale me një dëshmi të veçantë për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet doktrale. Studentët që grumbullojnë 60 kreditet e sipërpërmendura kalojnë në vitin e dytë të studimeve doktrale.

UET-i ka filluar që në vitin akademik 2012-2013 angazhimin e një pjesë të doktorantëve në procesin e mësimdhënies, kryesisht në programin e ciklit të parë, mbi bazen e kontratës që ofrohet standard për pedagogët e jashtëm. Ky angazhim i jep mundësi atyre të fitojnë eksperiencë në procesin e mësimdhënies, si dhe të shkëmbimit të ideve dhe eksperiencave profesionale respektive.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies, (plotëso Tabelën 10)

Tabela 10

| Programi i Studimit Doktorat | | |
|------------------------------|-------------------------|------------------------|
| Format e mësimdhënies | | Orët totale në auditor |
| a. | Leksione | 275 |
| b. | Seminare | 102.5 |
| c. | Detyra Praktike | 57.5 |
| d. | Leksione te hapura | 35 |
| e. | Kërkimi shkencor/Pune e | 780 |

| | | |
|--|----------|------|
| | pavarur | |
| | Në total | 1250 |

- Format e kontrollit të njohurive (plotëso Tabelën 11)

Tabela 11

| Format e kontrollit të njohurive | Pjesa (në %) ndaj totalit |
|---|---------------------------|
| Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive | |
| Plotësimi i detyrimeve (Prezantime individuale dhe ne grup) | 1-2 Prezantime ose ese |
| Provimi përfundimtar | 100% |
| Në total | 100% |

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (ne nivel departamenti apo/dhe Fakulteti).(Plotëso Tabelën 12)

Tabela 12

| Aktiviteti shkencor i IAL | Numri i studentëve të aktivizuar |
|--|----------------------------------|
| Për punime shkencore individuale të pedagogëve | 10 |
| Për projekte shkencore në rang Fakulteti/ Departamenti/ Shkollë doktrate | 8 |
| Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë | 4 |

- Këto të dhëna janë provizore dhe përditësohen, ato reflektojnë gjendjen deri në dhjetor 2012.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | | Vlerësimi për Kriteret/standartet |
|---|---|--|
| Standardi I.2 - Ngritja e vazhdueshme e nivelit teorik dhe nxitja e punës në grup e studentëve janë objektiva të një programi studimi të ciklit të tretë të doktoratës | | |
| Kriteri 1 | Niveli i zhvillimit të kërkimit shkencor ndihmon në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit; | Kriteri 1 UET ka vendosur në dispozicion të kandidatëve doktorantë, një infrastrukturë mësimit dhe mbështetëse (IT, bibliotekë shkencore, litaraturë dhe revista shkencore), që i ofron atyre të gjithë mbështetjen për përfunduar në mënyrë të suksesshme studimet doktorale dhe kërkimin për disertacionin e tyre. Gjithashtu, disponimi i një stafi akademik udhëheqës të përgatitur (sipas CV-ve) ka ndihmuar edhe më shumë kandidatët për doktorë që të përmbushë objektivin e synuar prej tyre, në drejtim të kërkimit shkencor. |

| | | |
|-------------------------|---|--|
| <p>Kriteri 2</p> | <p>Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjekin studimet e doktoratës, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës; Punën e pavarur në laborator; Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe interneti) dhe administrimin e informacionit; Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit; | <p>Kriteri 2</p> <p>Platforma kërkimore e UET lidhur me kandidatët/studentët doktorantë është që këta të fundit të angazhohen aktivisht në konferenca shkencore, të zhvilluara nga UET, si dhe përgatitjen e artikujve të përbashkët shkencorë, kryesisht me udhëheqësit e tyre doktoralë, por jo vetëm. Në këto aktivitete dhe sipërmarrje ata udhëzohen dhe u kërkohet të ndjekin rigorozisht standardet ndërkombëtare të shkrimit të artikujve dhe përdorimin efcicent të burimeve dhe referencave shkencore, që disponohen në fondin e bibliotekës së UET dhe në vetë fondin personal të udhëheqësve shkencorë të tyre. Konkretisht, deri tani janë mjaft artikuj të botuar në revista shkencore dhe po ashtu referime në konferenca të ndryshme, si punime individuale apo të përbashkëta të studentëve me udhëheqësit, process i cili vazhdon dhe motivohet per doktorantet e fakultetit juridik nga strukturat drejtuese te ketij fakulteti.</p> <p>Gjithashtu, vitin e kaluar është organizuar një seminar vetëm me doktorantët e Fakultetit Juridik, në përmbushje të këtij qëllimi, ku prezantimet e tyre zinin vendin kryesor; si dhe përmendim faktin që Konferenca Shkencore e vitit të kaluar e Fakultetit Juridik, (Maj 2012) kishte një panel të veçantë vetëm për doktorantët.</p> <p>Gjithashtu, janë bërë përpjekje për aktivizimin e kandidatëve në projekte apo analiza vrojtuese, sipas teknikave bashkëkohore të kërkimit dhe analizimit, duke përdorur programet dhe teknikat e kohës. Kandidatët ndihmohen sipas rastit nga pedagogë të caktuar, për aplikimin e metodave të caktuara matematikore dhe statistikore, që i ndihmojnë ata në procesin e analizës kërkimit shkencor. Në këtë drejtim një ndihmesë ka dhënë dhe fondi voluminoz i librave, artikujve dhe revistave shkencore që disponohen në bibliotekën e UET, ekspertiza e stafit akademik udhëheqës, sikurse dhe infrastruktura e IT-se dhe shërbimet mbështetëse.</p> |
| <p>Kriteri 3</p> | <p>Studentët e doktoratës marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara të doktoratës jashtë punës kërkimore të tyre. Një doktorant është i lirë të marrë pjesë si dëgjues</p> | <p>Kriteri 3</p> <p>Doktoranët janë ftuar dhe inkurajuar të ndjekin dhe marrin pjesë në të</p> |

| | | |
|--|---|--|
| | <p>apo si referues në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligjërata; Seminare; Debate ndërdisiplinare, të organizuara në kuadër të programit të studimit të doktoratës; Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të studentëve të postdoktoratës dhe të projekteve kërkimore, madje edhe kur kjo nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të studentit. Udhëheqësit shkencorë i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore; <p>Kriteri 4</p> <p>Studentët kanë fituar aftësi për komunikimin e duhur me nivel shkencor (Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të shkruar në mënyrë të qartë dhe me një stil të përshtatshëm; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikullimin e qartë të ideve para publikut të interesuar; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në mësimdhënie, mbikëqyrje ose demonstrime);</p> <p>Kriteri 5</p> <p>Studentët kanë fituar aftësi për komunikim korrekt me të tjerët, aftësi e nevojshme kjo për një studiues, por edhe në situata të tjera (të qenë në gjendje të zhvillojnë dhe të ruajnë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e punës me të tjerët, vetëdijesimin se si sjellja e tyre prek atë vetë dhe të tjerët dhe për të qenë i gatshëm për të dëgjuar, për të dhënë dhe për të marrë, me mprehtësi, reagimet dhe përgjigjet);</p> | <p>gjitha aktivitetet dhe eventet e organizuara nga UET, (konferenca, seminare, prezantime, promovime librash, projekte, etj), në funksion të sigurimit të një interaktiviteti të lartë jo vetëm me sfatin akademik të UET, por me gjithçka diskutohet dhe ballafaqohet në rrethin akademik e universitar mbarëshqiptar.</p> <p>Gjithashtu, UET në kuadër të studimeve doktrale, organizon të ashtuquajturat “klasa doktrale”, të cilat konsistojnë në krijimin e grupeve të vogla, të përbëra nga studentët doktorantë dhe udhëheqësit e tyre. Këto klase grupohen sipas drejtimeve dhe akteve kërkimore që ka shpallur çdo udhëheqës, duke u krijuar mundësi studentëve për një diskutim interaktiv, ballafaqim dhe shkëmbim eksperiencash me kandidatët dhe udhëheqësit e tjerë.</p> <p>Gjithashtu, dhëheqësit shkencorë i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore dhe i sugjerojnë aktivitete te tilla, që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore duke i mbështetur dhe motivuar ata.</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Studentët doktrale nga prezantimet dhe artikujt e paraqitur deri më sot në eventet dhe botimet shkencore të UET kanë treguar një nivel të kënaqshëm në drejtim të përgatitjes me kompetencë, sipas formatit të kërkuar shkencor të artikujve, cilësisë së argumentimit dhe mbrojtjes së ideve si dhe hipotezave të ngritura në to. Gjithashtu, konstatohet një nivel i kënaqshëm kompetence lidhur me debatin ndërpersonal të studentëve në këto evente si dhe në ditët doktrale, duke kontribuar kështu në ofrimin e qasjeve dhe këndvështrimeve të reja, për problematikat aktuale të fushës ekonomike dhe të IT-së.</p> <p>Kriteri 5</p> <p>Nga eksperiencia e ‘klasave doktrale’, por dhe nga ndjekja e debateve dhe diskutimeve në eventet e organizuara nga UET, evidentohet një zhvillim cilësor i aftësive komunikuese të studentëve doktrale me udhëheqësit, por dhe me studentët e tjerë. Nga studentë të ndryshëm pohohet</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>Kriteri 6</p> | <p>Zhvillimi i aftësive të komunikimit të studentëve të doktoratës ka nxitur inkurajimin e tyre për angazhim në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë (p.sh. duke u angazhuar në mësimdhënie si lektorë, në mbështetje të profesorëve udhëheqës të disertacionit të tyre).</p> | <p>mundësia që u është krijuar dhe pozitiviteti i mjedisit të krijuar nga UET, në këtë drejtim. Gjithashtu, studentët kanë filluar të vendosin një lidhje bashkëpunuese, duke i krijuar mundësi njëri-tjetrit që të marrin pjesë në konferencat respektive të organizuara në universitetet e tyre.</p> <p>Kriteri 6 Studentet doktorantë kanë filluar të angazhohen në procesin e mësimdhënies kryesisht në nivelin Bachelor, në mbështetje të udhëheqësve të tyre apo të stafit akademik në department, në përputhje me drejtimin kërkimor të tyre.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Në përfundim pohohet se ky standard plotësohet, duke i ndihmuar në mënyrë thelbësore studentët doktoralë në ngritjen e nivelit të tyre teoriko-shkencor, përvetësimin e teknikave dhe modeleve bashkëkohore të kërkimit dhe analizës shkencore, stilit shkencor të shkruarit të artikujve dhe materialeve përkatëse, si dhe nxitjen dhe energjizimin e debatit ndërpersonal, brenda mjedisit akademik e shkencor të shkollës doktorale të UET.</p> | | |

9. Studentët doktorantë

Pjesa përshkrimore

Kriteret akademike dhe procedurat e pranimit të studentëve doktorantë janë të parashikuara në pikat 6 dhe 7 të rregullores UET për “Organizimin e programeve të studimit të doktoratës”. Konkretisht, Shkolla Doktorale ka publikuar kriteret akademike dhe procedurat e pranimit të studentëve doktorante në faqen e website të UET <http://www.uet.edu.al/index.php/it/jeta-akademike-3/broshurat-e-uet>, si dhe në organe të medias së shkruar duke përmendur këtu gazetën MAPO, News 24, Balkan Web, Gazeta Panorama etj.

Studentët gjithashtu marrin informacion nga Zyra e Koordinimit të Shkollës Doktorale përpara se të përgatisin dosjen për aplikim. Pasi përgatitet dosja e plotë, Zyra e koordinimit të Shkollës Doktorale verifikon plotësimin e dosjes, sipas kriterëve akademike dhe dokumentat e aplikimit dhe i pasqyron rezultatet në formularin përmbledhës që i bashkangjitet secilës dosje. Për shqyrtimin e secilit propozim Këshilli i Profesorëve ngre grupe ad-hoc sipas fushës përkatëse të çdo programi studimi, të cilët pasi shqyrtojnë propozimet paraqesin listën e kandidatëve fitues në Këshillin e Profesorëve. Më pas përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Këshilli i Profesorëve. Drejtori i Shkollës Doktorale shpall listën e kandidatëve fitues si dhe përcakton afatet e ankimimit të kandidatëve të shpallur jo-fitues.

Cilësia në hyrje e studentëve përcaktohet në pikën 6.1,b ku studentët që kandidojnë duhet të kenë një notë mesatare të përgjithshme në studimet e ciklit të dytë 8 e lart e llogaritur në bazë të grup-lëndëve profesionale të programit të studimit. Numri i studentëve në hyrje për Fakultetin Juridik është 126, ndërsa nuk ka ende studentë në dalje pasi nuk ka përfunduar cikli i studimeve për brezin e parë të studentëve.

Koha mesatare e zgjatjes së studimeve të doktoratës, parashikuar në pikën 12 të rregullores, nuk mund të kapërcejë afatin 4 vjeçar nga rregjistrimi në program. Në ç’do rast shtyrja miratohet nga Këshilli i Profesorëve mbi bazën e argumentimit dhe dokumentave të

paraqitura nga kandidati që kërkon këtë shtyrje. Për studentët të cilët janë të përfshirë në programe studimi specializuese afatgjata të ciklit të tretë ose që janë në marrëdhënie pune koha e përfundimit të programit të doktoraturës mund të shkojë deri në 6 vjet. Kjo për arsye se kjo kategori studentësh nuk është në gjendje të sigurojë frekuentim të plotë të aktiviteteve të parashikuara për doktoratën.

Deri më sot Shkolla Doktorale nuk ka të rregjistruar kërkesa për zgjatjen e programeve të doktoratës. UET nuk ka nxjerrë ende brezin e parë të studentëve të doktoratës për t'i mundësuar komunikimin me ish të studentët e diplomuar. Por, UET disponon të gjitha mënyrat e komunikimit dhe database-in e nevojshëm për ta kryer këtë proces në të ardhmen, siç e realizon në nivelet e tjera të studimit përkatësisht Bachelor dhe Master. Informimi i studentëve doktorantë kryhet përmes Zyrës së Koordinimit pranë Shkollës Doktorale. Studentët informohen përmes komunikimit elektronik për ç'do informacion që Shkolla Doktorale duhet të dërgojë te ata. Informimi i studentëve është i shpeshtë dhe në kohën e duhur. Për aktivitetet apo konferencat studentët përvec komunikimit elektronik informohen përmes posterave të vendosura në ambientet e UET.

Tregues të matshëm:

Të dhëna statistikore për studentët e pranuar:

| NR. | Të dhëna statistikore për studentët e pranuar | |
|------------|---|-------------|
| 1 | Nr.Total i Doktorantëve | 126 |
| 2 | Nr. i Doktorantëve për çdo vit | — |
| 3 | Nr. i Doktorantëve Jashtë njësisë që ka hapur programin | — |
| 4 | Nr. i Diplomave të lëshuara për marrjen e gradës "Doktor" | — |
| 5 | Kohëzgjatja mesatare e Doktoraturës Cila ka Qenë Tendencë e këtij treguesi | — |
| 6 | Numri dhe % që zë në nivel programi studimesh, i atyre që kanë ndërprerë Studimet | 5 / 3.96% |
| 7 | Nr. në % i Doktorantëve nga Kosova dhe Diaspora | 53 / 42.06% |
| 8 | Nr. në % i Doktorantëve që vijnë nga Ballkani | 53 / 42.06% |
| 9 | Nr. në % i Doktorantëve që vijnë nga vendet e BE-së | 0 |
| 10 | Nr. në % i Doktorantëve që vijnë nga vendet e tjera të botës | 0 |

Të dhëna për mobilitetin e studentëve doktorantë në Universitetet jashtë vendit - NA

Të dhëna për vlerësimin përfundimtar të studentëve në Doktoratë - NA

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi për Kriteret dhe standardet |
|--|---|
| Standardi I.3 - Pranimi i studentëve në një program studimi doktorate | |
| Kriteri 1 | <p>Studenti i pranuar në programin e studimit të doktoratës ka përfunduar me notë mesatare (> 80% të pikëve) ciklin e dytë të studimeve dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”/“Master i arteve të bukura” ose një diplomë ekuivalente me të, pas përfundimit të studimeve universitare që përfshijnë një tezë shkencore të vlerësuar me 30-40 kredite ECTS;</p> |
| Kriteri 2 | <p>Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, doktoratën, ka njohuri të thelluara teorike në fushën përkatëse të studimit. Disa nga njohuritë bazë që doktoranti ka, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të menduarit krijues; Zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit; Lidhjet mes fushave të ndryshme të kërkimit; Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore; Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit; |
| Kriteri 3 | <p>Studenti i pranuar në programin e studimeve të doktoratës është i gatshëm të zbatojë në praktikë</p> |
| Kriteri 1. | <p>Sikurse parashikohet dhe në kriteret e pranimit në shkollën doktorale UET, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, doktoranti i pranuar në programin e studimit të doktoratës ka përfunduar me notë mesatare mbi 7.5 ne ciklin e dytë të studimeve e llogaritur mbi bazën e grup-lëndëve profesionale të programit të studimit, dhe ka marrë diplomën universitare “Master i Shkencave” / “Master i Arteve te Bukura”, ose një diplomë ekuivalente me të, pas përfundimit të studimeve universitare që përfshijnë një tezë shkencore të vlerësuar me 30-40 kredite ECTS.</p> |
| Kriteri 2. | <p>Kërkesat e vendosura për mesataren përkatëse, sikurse dhe kërkesat për paraqitjen e rekomandimeve pozitive nga profesorë të familjarizuar me punën dhe kapacitetin akademik të doktorantit aplikant, në sintezë me kriteret e tjera të pranimit të listuara më poshtë në kriterin 6 të po këtij standarti, dëshmojnë që kandidatët për zgjidhen në bazë të aftësive akademike, potencialit kritik e krijimtarisë kërkimore shkencore. Ekzistojnë disa mënyra për të testuar njohuritë bazë të doktorantit:</p> <ol style="list-style-type: none"> Propozimi (propozimi doktorale) për temën e doktoraturës (pika 6.2.2, c e rregullores) Sipas pikes 6.2.2,b, të rregullores kandidati paraqet në dosjen e tij bibliografinë e punimeve shkencore në fushën për të cilën aplikon, nëse ka të tilla. Dy rekomandime të kërkuara (pika 6.2.2, h e rregullores) nga persona me titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit. Në ditët doktorale studenti prezanton ecurinë e punës së tij si dhe ka mundësi të tregojë problemet e dala gjatë punës kërkimore dhe kompetencat për zgjidhjen e tyre; Gjithashtu provimi i gjendjes teorike të disiplinës është një tregues i çështjeve që përmbledh ky kriter. |
| Kriteri 3. | <p>Shkolla doktorale UET synon nxjerrjen</p> |

| | | |
|--|--|--|
| | <p>dijet dhe njohuritë e fituara nga puna kërkimore në fushën përkatëse të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Studenti zotëron gjuhën angleze të certifikuar në nivelin internacional, së paku “C1”, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare dhe një gjuhë të dytë të huaj si frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht ose rusisht. Në shkencat shoqërore mund të jetë gjuha latine, greqishtja e vjetër, persishtja ose ndonjë gjuhë tjetër e nevojshme për hulumtime në fushën përkatëse;</p> <p>Kriteri 5 Këshilli i Profesorëve ka përcaktuar kriteret për t'u pranuar në programin e studimeve të doktoratës të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të doktoratës;</p> | <p>e produkteve kërkimore aplikative nga ana e doktorantëve që përfundojnë një cikël studimi doktoral. Çdo kandidat duhet të plotësojë projekt propozimin për kërkimin e temës së doktoraturës (propozimi doktoral). Në këtë formular te pjesa e parashtrimit të problemit studenti i kthen përgjigje pyetjes pse është e nevojshme të bëhet kërkimi shkencor apo studimi. Po kështu te pjesa “Rëndësia e studimit”, kandidatit i kërkohet të parashtrijë ndikimet sesi rezultatet e studimit mund të ndikojnë kërkimet akademike, teori, praktika, ndërhyrjet edukative, kurrikulat, konsulencat dhe politikën, veprimtarinë e shoqërisë civile apo grupeve të interesit etj;</p> <p>Kriteri 4. Sikurse parashikohet dhe në kriteret për t'u plotësuar nga çdo doktorant për rregjistrim pranë shkollës doktorale UET/ Fakulteti Juridik, (kriteret të listuara më poshtë në pikën 5 të këtij seksioni) doktoranti paraqet një dëshmi zotërimi të gjuhës së huaj angleze, të certifikuar në nivel internacional, së paku në nivelin “C1” dhe në CV-në e tij liston të paktën edhe një gjuhë të huaj të dytë.</p> <p>Kriteri 5. Për të kërkuar regjistrimin në programet e studimit të doktoratës studenti duhet të plotësojë këto kriteret sipas rregullores së miratuar të shkollës doktorale, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli i Profesorëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi:</p> <ol style="list-style-type: none"> të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e kërkuar dhe të zotërojë një diplomë Master i Shkencave ose një diplomë sipas sistemit të vjetër, apo titull akademik të barasvlershëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente; te kete note mesatare te pergjithshme ne studimet e ciklit te dyte te studimeve 7,5 e lart, e llogaritur ne baze te grup-lendeve profesionale te programit të studimit; të ketë dëshmi zotërimi të gjuhës së huaj angleze, sipas përcaktimeve ligjore. të marrë përsipër përmbushjen e standardeve shkencore dhe etike. <p>Procedura e aplikimit sipas Rregullores</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|---|
| | | <p>për organizimin e programeve të studimeve të doktoraturës, përcaktohet në pikën 6.2 të saj. Aty detajohen se:</p> <p>6.2.1 Aplikimi për regjistrim në programet e doktoratës bëhet pranë Zyrës së Koordinimit të Shkollës Doktorale.</p> <p>6.2.2 Dosja individuale e aplikimit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:</p> <p>a. Kërkesa e kandidatit drejtuar Këshillit Drejtues të Shkollës Doktorale;</p> <p>b. CV personale shoqëruar me bibliografinë e punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla;</p> <p>c. Projekt-propozimin për temën e disertacionit (2500 - 3000 fjale);</p> <p>d. Kopje të noterizuar të diplomës Master i Shkencave ose Master i Arteve të Bukura, apo të një diplome tjetër studimi ekuivalente me to, të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga MASH. Preferohet që diploma me të cilën kandidati pranohet në program të jetë në fushë të njëjtë, të ngjashme ose të përafërt studimi;</p> <p>e. Kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose çertifikate ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati disponon një të tillë;</p> <p>f. Vërtetim për vazhdimin e programeve të studimit të specializimit, së bashku me listën e notave të fituara deri në atë moment, nëse kandidati është duke ndjekur një program të tillë;</p> <p>g. Fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit/pasaportës;</p> <p>h. Dy rekomandime nga persona me titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;</p> <p>i. Një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, sipas përcaktimeve të bëra nga vetë institucioni;</p> <p>j. Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja, sipas legjislacionit në fuqi; k. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar; l. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurrim; m. Dy fotografi për dokument.</p> <p>Zyra e Koordinimit të Shkollës Doktorale, pasi verifikon rregullsinë e</p> |
|--|--|---|

| | | |
|-------------------------|---|---|
| <p>Kriteri 6</p> | <p>Aplikanti ka marrë informacion të detajuar për programin e studimit të doktoratës, para se të pranohet në të. Ai është plotësisht i informuar lidhur me:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kohëzgjatjen e programit të studimit; Kushtet që duhet të plotësojë studenti përpara paraqitjes në provimin e doktoratës; Mbështetjen që institucioni i siguron studentit nëpërmjet strukturave administrative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit (laboratorë, biblioteka, etj.); Modalitetet e ushtrimit të veprimtarisë kërkimore apo krijuese të studentëve të doktoratës, veçanërisht lidhur me përgatitjen e tezës së doktoratës; | <p>plotësimin të dosjeve të aplikimit, i shpërndan ato në departamentet përkatëse, përgjegjëse për programin e doktoratës.</p> <p>Kriteri 6. Aplikanti për doktoraturë në shkollën doktrale UET/ Fakulteti Juridik informohet nëpërmjet një sërë hapash, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Informimi nëpërmjet broshurave të shkollës doktrale me programet përkatëse, kriteret e pranimit, kohëzgjatjen e studimit, lëndët e ofruara, provimin formues (Comprehensive Examination), dhe stafin akademik. Informimi nëpërmjet konsultimeve të ofruara nga zyra e koordinimit dhe informacionit të shkollës doktrale Informimi kontraktual i realizuar nëpërmjet kontratës dhe anekseve të saj së bashku me rregulloret përkatëse të programit. Informimi për procesin mësimor e kërkimor, për ditët doktrale, pjesëmarrjen në colloqume shkencore nëpërmjet koordinatores së shkollës doktrale për fakultetin juridik . |
| <p>Kriteri 7</p> | <p>Në kriteret e pranimit përfshihet edhe intervista dhe mbështetjet që mund të sigurohen nga referencat dhe dokumente të tjera shtesë;</p> | <p>Kriteri 7. Sikurse është përmendur edhe në kriteret e pranimit të listuara në pikën 5 të këtij seksioni, pranimi në doktoraturë bazohet në përmbushjen e plotë të dokumentacionit të nevojshëm, që nga diplomat e studimeve të ciklit të dytë, dëshmia e anglishtes, CV-ja, letrat e referencës dhe vërtetime të tjera shtesë që dëshmojnë mbi aftësitë dhe potencialin kërkues të doktorantit.</p> |
| <p>Kriteri 8</p> | <p>Në politikatat e pranimit përfshihet edhe provimi i pranimit për doktoratë.</p> | <p>Kriteri 8. Pranimi fillestar në shkollën doktrale UET/ Fakulteti Juridik bazohet mbi plotësimin e të gjitha kriterëve të listuara në pikën 5 të këtij seksioni. Zhvillimi i një provimi formues ndodh pas vitit të parë të doktoraturës si për doktorantët e sistemit 2 vjeçar edhe për ata të sistemit 3 vjeçar. Provimi formues ndërtohet në bazën e pyetjeve nga një literaturë e selektuar dhe njoftuar paraprakisht për çdo</p> |

| | | |
|---|--|---|
| | | doktorant sipas drejtimet përkatës në Fakultetin Juridik, ku përmbahen botimet kryesore relevante për çdo drejtim (20-25 libra për drejtimin doktoral). |
| Standardi II.5 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve në këtë cikël studimesh | | |
| Kriteri 1 | <p>Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri të thelluara në fushën përkatëse shkencore; Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; Aftësi profesionale në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet kritike që lidhen me fushën e tij të kërkimit; Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese; Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja që nxisin kërkimin shkencor.; | N/A (për të gjitha kriteret, pasi është ende në proces dhe nuk ka ardhur ende faza e vlerësimit përfundimtar). |
| Kriteri 2 | Studenti jep prova që me anë të kërkimit shkencor të realizuar, ai ka sjellë produkte shkencore origjinale, punime shkencore të një niveli të lartë shkencor, disa prej të cilave kanë merituar a meritojnë publikimin në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; | |
| Kriteri 3 | Vlerësimi përfundimtar i studentëve të doktoratës bazohet mbi të gjitha në një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij; | |
| Kriteri 4 | Mbi bazën e një marrëveshjeje të arritur që në fazën e miratimit të programit të studimeve, rezultati i kërkimit të paraqitet si tezë disertacioni, ose kumulativ me 3 artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti me koeficient mbi 1; | |
| Kriteri 5 | <p>Në rastin e provimit në doktoratë me tezë disertacioni doktoranti ka plotësuar kushtet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ka realizuar si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare, në një vend perëndimor (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN-je; Ka botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, dy prej artikujve janë botuar ose pranuar për botim në revista të njohura perëndimore, me bord editorial; Ka përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e | |

| | | |
|-------------------|---|--|
| Kriteri 6 | <p>Profesorëve të fakultetit disertacionin, së bashku me një përmbledhje, të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Struktura e disertacionit dhe e përmbledhjes së tij përcaktohen në rregulloren e studimeve të doktoratës.;</p> <p>Këshilli i Profesorëve përcakton dy ose tre oponentë, një prej të cilëve është nga jashtë institucionit. Oponentët janë edhe anëtarë të jurisë për vlerësimin e disertacionit. Ata kanë titujt akademikë të kërkuar dhe një veprimtari kërkimore e botuese të pasur, brenda e jashtë vendit, në fushën përkatëse të studimeve në të cilën ofrohet edhe programi i studimeve të doktoratës;</p> | |
| Kriteri 7 | <p>Nuk emërohen oponentë të cilët kanë pasur një përfshirje substanciale në punën e studentit të doktoratës, ose puna e të cilëve është vetë fokusi i projektit të kërkimit;</p> | |
| Kriteri 8 | <p>Një kopje e disertacionit i jepet çdo oponenti, duke i dhënë kohën e mjaftueshme për ta lexuar dhe për të shkruar për të një raport të veçantë.</p> | |
| Kriteri 9 | <p>Oponentët nuk duhet të komunikojnë midis tyre, as me doktorantin ose me udhëheqësin shkencor të tij gjatë kësaj periudhe. Oponentët duhet të verifikojnë edhe vërtetësinë e të dhënave të përdorura në disertacion, respektimin e praktikës së punës kërkimore si edhe citimet e punimeve kërkimore dhe artikujve të autorëve të tjerë.</p> | |
| Kriteri 10 | <p>Oponentët shprehen qartë për pastërtinë e punimit shkencor nga plagjiatura. Në rast se vërejnë e konstatojnë se kjo ka ndodhur, ata kërkojnë ndërprerjen e vlerësimit të disertacionit;</p> | |
| Kriteri 11 | <p>Disertacioni shoqërohet me një përmbledhje, rreth 10 faqe, në gjuhën angleze. Kjo përmbledhje shpallet në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën e caktuar për informimin për këtë program studimi;</p> | |
| Kriteri 12 | <p>Udhëheqësi shkencor i studentit nuk duhet të jetë oponent;</p> | |
| Kriteri 13 | <p>Kur oponentët kanë përfunduar raportet e tyre, ata thirren nga dekani dhe kryetari i Këshillit të Profesorëve për të rënë dakord për zhvillimin e provimit me gojë;</p> <p>Është e rekomandueshme, që një anëtar i jurisë së provimit të doktoratës të jetë nga universitete të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, i cili ka së paku gradën shkencore “Doktor” të fituar në fushën shkencore në të cilën vazhdon studimet doktoranti dhe mbi 5 vjet përvojë akademike e kërkimore. Ky kriter mund edhe të mos zbatohet për shkencat albanologjike. Vlerësimi i doktorantit në provim bëhet i hapur me konsensus, me kusht që të gjithë anëtarët të jenë shprehur për një notë kaluese. Nëse, qoftë edhe një anëtar e ka vlerësuar, me argumente bindëse, doktorantin/ten me notë jokaluëse, edhe rezultati përfundimtar do të jetë jokaluës;</p> | |

| | | |
|--|--|--|
| Kriteri 14 | Oponentët i dorëzojnë dekanit të njësisë që e organizon programin e studimeve të doktoratës dhe kryetarit të jurisë së provimit të doktoratës nga një kopje të raporteve individuale të tyre; | |
| Kriteri 15 | Mbrojtja e disertacionit për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor” është publike. Ajo njoftohet së paku 4 javë përpara dhe bëhet në prani të anëtarëve të departamentit, studentëve dhe pedagogëve të interesuar të Institucionit përkatës të Arsimit të Lartë; | |
| Kriteri 16 | Vlerësimet që mund të bëjnë oponentët përfshijnë: dhënien e diplomës për gradën shkencore “Doktor”; ose riparaqitjen e punimit kërkimor me shkrim, pas plotësimit të rekomandimeve të tyre; ose një zgjatje të mëtejshme të programit të studimeve; ose refuzimin e dhënies së diplomës për gradën shkencore “Doktor”; | |
| Kriteri 17 | Nga një kopje e disertacionit, të studentit që ka marrë diplomën për gradën shkencore “Doktor” të depozitohet në bibliotekën e fakultetit, të institutit kërkimor, qendrave kërkimore universitare, universitetit ku është realizuar programi i studimit dhe punimi shkencor dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare. Diploma për gradën shkencore “Doktor” nuk lëshohet pa u depozituar në institucionet e lartpërmendura disertacioni i botuar, në letër dhe në disk, (CD) dhe pa u bërë publik në faqen zyrtare të Institucionit përkatës të Arsimit të Lartë; | |
| Kriteri 18 | Diploma për gradën shkencore “Doktor” nuk lëshohet pa u regjistruar më parë në Regjistrin Kombëtar të Doktoratave të Komisioni të Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) në MASH. | |
| <u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> | | |
| Të gjitha kriteret e standarteve I.3 që lidhen me pranimin e studentëve në doktoraturë plotësohen. Kriteret e standartit II.5 parashikohen në rregulloren për organizimin e studimeve të doktoratës në UET, por aktualisht janë të paaplikueshme pasi ky proces vazhdon dhe ende nuk jemi para fazës së vlerësimit përfundimtar të studentëve në këtë program. | | |

POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT

10. Kërkimi shkencor dhe përfshirja e kërkimeve të studentëve të doktoratës.

Pjesa përshkimore:

Politikat e kërkimit shkencor të IAL/Shkollës së Doktoratës janë të lidhura me objektivat formuese të programit të studimit të doktorates. Programet e studimit të doktoratës nga ana tjetër përfshijnë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarur, si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës. (Udhëzim Nr.5, datë 22.1.2008/pikat 5,7; programi i studimit)

Shkolla doktorale ka një rëndësi kyçe, sepse nxjerr hulumtuesit e parë dhe punonjësit e parë shkencorë të përgatitur në UET. Po ashtu, Shkolla doktorale ofron udhëheqje

shkencore për kandidatet doktorale dhe strukturon punën kërkimore të stafit pedagogjik sipas drejtimeve specifike kërkimore. Në bashkëpunim me tre Fakultetin Juridik, Shkolla Doktorale në UET ka strukturuar kërkimin shkencor dhe drejtimin e punës kërkimore të kandidatëve doktorale sipas Drejtimeve Kërkimore për secilin program të studimit. Drejtimet Kërkimore të Shkollës Doktorale drejtohen pedagogë dhe studiues me gradën më të lartë dhe numrin më të madh të botimeve në fushën përkatëse dhe përbëhet si nga studentë doktorale ashtu dhe nga 3 deri në 5 udhëheqës doktorale. Konferencat doktorale janë strukturuar sipas Drejtimeve Doktorale për shkenca juridike.

Organizimi sipas Drejtimeve Kërkimore synon të arrijë të paktën tre objektiva: Së pari, të prodhojë ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në një fushë të caktuar dhe të kthejë UET-in në një burim të vazhdueshëm dijeje dhe konsulencesi për komunitetin akademik, ashtu dhe për aktorë të tretë. Së dyti, rritja profesionale e stafit akademik dhe kërkimor të UET-it brenda ekspertizave dhe fushave të tyre të interesit shkencor. Së fundi, krjimi i njëkomuniteti—ose disa komuniteteve—kërkimore të cilët ndërveprojnë vazhdimisht me njëri tjetrin në funksion të gjetjeve dhe analizave sa më të arrira dhe bindëse.

Është për t'u theksuar kërkesa nga autoritetet e Universitetit për një punë shkencore të vazhdueshme nga ana e pedagogëve. Formalisht kjo gjë shprehet dhe në faktin se pedagogu është i detyruar në bazë të kontratës të realizojë të paktën dy artikuj në vit, të marrë pjesë të paktën në dy konferenca, si dhe të ketë pjesëmarrje në projekte me karakter aplikativ ose kërkimor shkencor, punë kjo që bën të mundur udhëheqjen e doktorantëve.

Për pedagogët që udhëheqin doktorantë, politika e Universitetit është arritja e një emëruesi të përbashkët midis punës shkencore të pedagogut udhëheqës dhe interesave të studentëve doktorantë duke mundësuar kështu cilësi më të lartë në udhëheqje. (Strategjia e Kërkimit Shkencor të UET).

Në tërësi, Universiteti European i Tiranës është duke zhvilluar projektet e mëposhtme:

- Projekti **Jean Monnet Chair** ‘*Shqipëria dhe Zhvillimi Rajonal i Bashkimit European*’ financuar dhe mbështetur nga Komisioni European në kuadër të programit të BE-së për LifeLong Learning. Për herë të parë *Programi Jean Monnet* aplikohet në Shqipëri nëpërmjet themelimit të *Jean Monnet Chair* pranë UET-it.

Qëllimi i *Jean Monnet Chair* është të zhvillojë njohuri teorike dhe praktike si dhe ekspertizë mbi Bashkimin European dhe zhvillimin rajonal, midis studentëve, akademikëve, shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale duke synuar rritjen e kapaciteteve shqiptare për të përfutur nga Fondet Strukturore në kuadër të integritimit në Bashkimin European.

Aktivitetet kryesore në projekt për jetëgjatësinë e tij 2012-2015 janë:

- i. organizimin e ‘Doctoral Colloquiums’. Në këto aktivitete studentët e doktoraturës në UET, të cilët kanë projekte kërkimore të lidhura me Bashkimin European dhe Zhvillimin Rajonal zhvillojnë seanca diskutimi mbi projektin e tyre doktorale. Këto seanca synojnë ndër të tjera përfshirjen e aktorëve të tretë, ekspertë në fushat përkatëse, në zhvillimin dhe progresin e kërkimit shkencor;
 - ii. publikimin e artikujve shkencorë me tematika të Bashkimit European dhe Zhvillimit Rajonal në revistat akademike të UET-it si dhe më gjerë nga stafi kyç i projektit si dhe studentët doktorant. Kjo përfshin edhe publikime në versionin online në faqen e Jean Monnet (<http://uet.edu.al/index.php/it/jean-monnet-chair-home>) si dhe në shtyp (Gazeta MAPO);
 - iii. pjesëmarrja e studentëve të doktoraturës në tryeza të rrumbullakta me aktorë të tjerë të qeverisë, sektorit privat, shoqërisë civile në fushën e Zhvillimit Rajonal ku diskutohen tema të lidhura me proceset e aksesimit, fondet strukturore, politikat e BE-së etj.
- Projekti ‘**Studimi i Qëndrueshmërisë Kulturore**’ – **COST** - në Fushën Individët, Shoqëritë, Kulturat dhe Shëndeti’ (ISCH). UET është institucioni i vetëm nga një vend jo-COST, i ftuar të marrë pjesë në Aksionin IS1007, në bashkëpunim me 23 institucione të BE-së. COST (Bashkëpunimi European për Shkencë dhe Teknologji) është një nga programet më të hershme europiane që mbështesin bashkëpunimin midis shkencëtarëve dhe kërkuesve në Europë.
 - UET-i drejton **projektin kërkimor rajonal në kuadër të RRPP-së** – “Fëmijët e rrugës në Shqipëri, Bosnie Hercegovinë, Maqedoni dhe Kosovë: Hapësira dhe identite në përpjekjen për mbijetesë” (Qershor 2012 – Qershor 2013). Programi i

Promovimit të Kërkimit Rajonal (RRPP) koordinohet Universiteti i Fribourg-ut në Zvicër dhe financohet nga Agjencia Sviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Ky projekt kërkimor analizon dinamikat e mënyrave të jetesës dhe larmishmërinë e profileve të fëmijëve të rrugës në rajon, duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në proceset e shoqërizimit dhe ndërtimit të identiteteve në hapësirën e ‘rrugës’. Projekti përfundon me botimin e studimit si dhe me organizimin e një conference finale rajonale ku marrin pjesë të gjithë partnerët në projekt, udhëheqësi shkencor ndërkombëtar, përfaqësues nga RRPP-ja, Universiteti i Fribourg-ut, e të tjerë të interesuar.

- UET-i është pjesë e Konkortiumit të projektit **Tempus** Skema IV (2011-2014)– “Vendosja e të drejtave të njeriut në zemër të arsimit të lartë”, drejtuar nga Universiteti i Roehampton-it në Britani. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të mbështesë themelimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve multi-disiplinare të edukimit të cilat përqëndrohen në fushën e të drejtave të njeriut dhe qytetarisë për nivelin universitar dhe pasuniversitar në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt përfshin një konsortium prej 11 universitetesh nga Shqipëria, Serbia, Kosova, Bosnia-Hercegovina, Mali i Zi, Gjermania, Suedi, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar.
- UET-i organizon **Forumit e Librit Akademik** ‘51 tituj akademikë – 51 ide inovatore për zhvillimin e politikave në Shqipëri’. Qëllimi i këtij projekti është të nxisë zhvillimin e debatit në hapësirën publike mbi mirëqeverisjen dhe proceset e demokratizimit përmes diskutimeve interaktive dhe të hapura rreth titujve akademikë e shkencorë të botuar në Shqipëri. Ky projekt vjen si një iniciativë e një grupi kërkuesish, lektorësh, studentësh doktorantë në UET që marrin pjesë aktive në këtë forum përmes recensave/diskusimeve rreth titujve akademikë/shkencorë. Ky projekt realizohet si një veprim i përbashkët i: UET; UET Press; Instituti i Dialogut dhe Komunikimit; Institutit Shqiptar i Medias; Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare; Shtëpia Botuese: 55; Onufri; Dituria; Toena; Dudaj.
- UET-i ka iniciuar aktivitetet në kuadër të **RCE** Albania, (Qendra Rajonale e Ekspertizës për Edukimin në Zhvillimin e Qëndrueshëm), në bashkëpunim me Universitetin e Kombeve të Bashkuara në Japoni (UNU-IAS), duke u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të RCE-ve. RCE synon realizimin e aktivitetve të përbashkëta akademike dhe zhvillimore në fushën e Edukimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të cilat mbështesin ndër të tjerave edhe veprimtarinë akademike e shkencore të studentëve të doktoratës në UET.
- UET-i, me mbështetjen e Fondacionin ABC ka përfunduar me sukses projektin **‘Ide të reja për Sipërmarrje të reja’**. Ky projekt synonte të ofronte mekanizma për zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme biznes-akademi, nëpërmjet krijimit të një klime nxitëse për ndërmarrjen e iniciativave inovatore në vend. Në kuadër të projektit u zhvilluan tryeza dhe një konferencë finale ‘Ide të reja për sipërmarrje të reja’ në nëtor 2012. Kjo e fundit solli së bashku përfaqësues nga qeverisja qendrore dhe lokale, akademikë të shquar nga fusha të ndryshme, përfaqësues nga biznesi i madh, i mesëm dhe i vogël në Shqipëri si dhe aktorë të tjerë kombëtar dhe ndërkombëtar të interesuar të ndihmojnë zhvillimin e biznesit në Shqipëri. Idetë e reja për sipërmarrje të reja, të gjeneruara nga aktivitetet e mësipërme u botuan në revistën shkencore të UET-it, “Economicus”, Nr. 9 (ISSN: 2223-6295).
- Këshilli Britanik dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë në bashkëpunim me Qendrën UET për Zhvillim dhe Kërkim realizuan projektin kërkimor: **‘Zhvillimi i gjuhës angleze në arsimin e lartë në Shqipëri** si një instrument për arritje të suksesshme akademike dhe profesionale të studentëve në nivel kombëtar dhe European’. Ky projekt kërkimor interesohet për dinamikat e përdorimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek mësimdhënia dhe eksperiencat e mësimnxënies si për stafin pedagogjik ashtu edhe për studentët në mjedisin universitar. Një takim prezantues për studimin u organizua në dhjetor 2012 dhe studimi u publikua online.
- Në kuadër të themelimit të Katedrës Jean Monnet Chair në UET, UET-i në bashkëpunim me Shoqatën e Ish-Anëtarëve të Parlamentit European, nën Programin **‘European Parliament to Campus’**, organizuan vizitën dy-ditore të Z. Jens-Peter Bonde në Shqipëri. Z. Bonde ka një eksperiencë të gjerë dhe kontribut të çmuar në strukturat dhe politikat e Bashkimit European, duke qenë anëtar i Parlamentit European për periudhën 1979-2008, ku për 17 vjet ka mbajtur pozicionin e kryetarit

të Grupit në EP. Z. Bonde është autor i mbi 60 librave mbi Bashkimin European. U organizuan:

- i. Leksioni i hapur me studentë e lektorë me temë: 'Rinia dhe integrimi në Bashkimin European: Perspektiva dhe Sfida'.
- ii. Tryeza e Rrumbullakët: "Shqipëria drejt Bashkimit European përmes Zhvillimit Rajonal" u zhvillua me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve qeveritare, si dhe kërkues dhe doktorantë në fushën e integritit european dhe zhvillimit rajonal.
- iii. Takim me Kryetarin e Komisionit Parlamentar të Integritit European Z. Ditmir Bushati me qëllim ndarjen e pikëpamjeve dhe qëndrimeve mbi procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin European.
- iv. Z. Bonde mori pjesë në disa emisione në media lokale e kombëtare.

Universiteti European i Tiranës në bashkëpunim me partnerë të tjera ka organizuar këto aktivitete në fushën kërkimore me pjesëmarrjen e studentëve të Shkollës Doktorale:

- Tryeza e rrumbullakët 'Ide të reja për Sipërmarrje të reja', me qëllim nxitjen e bashkëpunimit mes qeverisë, akademisë dhe biznesit. Partnerë në aktivitet: Fondacioni ABC dhe Instituti i Shërbimeve të Konsulencës Menaxheriale. (Nëntor 2012)
- Tryeza e rrumbullakët 'Anti-Korrupsioni' në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) ku u diskutua roli i universiteteve në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri dhe mirë qeverisjen. (Dhjetor 2012)
- Tryeza e rrumbullakët 'Kërkimi dhe Politikëbërja për Gjithëpërfshirjen Shoqërore në Shqipëri' në bashkëpunim me UNICEF-in në Shqipëri ku u diskutuan mekanizmat e ndikimit të kërkimit në politikëbërje dhe rritje të rolit të universitetit në politikat e gjithëpërfshirjes shoqërore. (Shkurt 2013)

Botimet në vite:

Në kuadrin e rregullores se programit të studimit të doktorates kërkimi shkencor, që është dhe qëllimi i doktoraturës, është konkretizuar në forma të ndryshme. Format kryesore janë referime në konferenca, botime të cilat janë të përbashkëta me pedagogun udhëheqës ose individualë të vete doktoranti. Nga ana tjetër puna kërkimore e pedagogut udhëheqës është një nga agazhimet kryesore të tij në universitet. Është kjo punë që ushqen dhe doktorantët e tij me ide dhe aktivitetin e tyre shkencor të përbashkët. Çka thamë ilustrimet dhe nga informacioni i tabelës 3. Ka një numër të konsiderueshëm botimesh nga doktorantët të Fakultetit Juridik, ku mes të tjerash përmendim edhe punën e përbashkët shkencore të pedagogëve udhëheqës me doktorantët si dhe të doktoranëve vetë: deri tani ka 30 botime nga doktorantët në revista shkencore të vendit dhe të huaja, si dhe 85 referime në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.

Kjo punë kërkimore ndihmon bashkëpunimin e Institucionit tonë me Universitete me të cilët doktorantët kanë lidhje duke bërë të mundur referime dhe punime të përbashkëta në kuadrin e aktiviteteve të këtyre Universiteteve.

Pjesëmarrja e studentëve doktorantë në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit

Një pjesë e mirë e doktorantëve vijnë nga jashtë Shqipërisë dhe ky fakt ka nxitur një pjesëmarrje të doktorantëve në aktivitete të institucioneve të kolegëve të tyre, duke krijuar një klimë të mirë bashkëpunimi shkencor midis Institucioneve të Arsimit të Lartë. Kjo gjë ka ndikuar dhe në pjesëmarrje të pedagogëve në këto aktivitete. Pedagogët dhe doktorantët kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Më poshtë paraqiten aktivitetet brenda dhe jashtë vendit në dy vitet e fundit për doktorantët e Fakultetit juridik: (tabelat bashkangjitur)

Tabela e Konferencave/aktiviteteve shkencore

| Nr | Emri | Konferenca Kombëtare | Konferenca Ndërkombëtare | Tema e Prezantuar | Te dhena rreth Organizimit | ISBN |
|----|-----------------|----------------------|---|---|---|-------------------|
| 1 | Myzafer ELEZI | | Reformat institucionale, domosdoshmëri për integrimin në BE | “Si zgjidhet nga e drejta penale ndërkombëtare çështja e ekstradimit të subjekteve që i nënshtrohen përgjegjësisë penale?”. | Universiteti Kristal, Tiranë, datë 07.07.2012 | |
| 2 | Adem Shala | | 1- Arsimi i lartë, masivizimi dhe sfidat e tij drejt integritimit European | Arsimi I lartëkosovar,masivizimi dhe sfidat e tij drejt integritimit evropian | UET, në bashkëpunim me Universitetin AAB, Prishtinë, 26-27 Tetor 2012, Tiranë | |
| 3 | Eurela Mujaj | | 1-South-East European Countries Toward European Integration | Ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të integritimit të Shqipërisë në EU | Universiteti "Aleksander Xhuvani", dhe Fakulteti Ekonomik, Elbasan, 20 Tetor 2012. | 978-9928-115-13-3 |
| | | | 2-Identity, Image & Social Cohesion in the Era of Integration and Globalization | Ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë në lidhje me Korrupsionin | Universiteti Ismail Qemali" Vlore; "Albanian Institute of Sociology(AIS)"; "Albanian University" Tirane; "UniversitetiPavaresia" Vlore, "UniversitetiReald" Vlore, "Universiteti Marin Barleti" Tirane; "AULEDA" International Economic Development Agency, "International School" Vlore; 26-28 Nëntor 2012 | 9789928-4100-4-7 |
| | | | | 1-"Bashkejetesa në konflikt, mes pozitivizmit dhe ligjit moral" 2-"Ndryshimet e kodit penal të republikës së Shqipërisë në lidhje me barazimin gjinor dhe unen në familje" | Aleksander Moisiu" me datë 15 Mars 2013. | |
| 4 | Kemal Ademaj | | Punëtori, Dedikuar Sektorit të Policisë – Prokurorisë – Gjyqësorë | Veprimtaria e organeve gjyqësore dhe administrative-reflektimet në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale | Zyra e BE-së, përmes projektit TAIEEX, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës 19-20 Nëntor 2012, Prishtinë. | |
| 5 | Lirika Kutrulli | | 1. "Towards future sustainable development " | Legal Framework in Albania and integration in Europe | International Conference Shkodra"Luigj Gurakuqi", Albania. Realizuar datë 16- | |

| | | | | | | |
|---|--------------|---|---|--|--|--|
| | | | | | 17/11/2012 | |
| | | | 2. "Education for the Knowledge Society" | "The right for property" and its place in the University curricula | Ministria e Arsimit dhe Shkencës , Tiranë realizuar datë 7 dhe 8 dhjetor 2012. | |
| | | | 3. International Conference on Education | "Different Missions The University Education Institutions" | Universiteti Europian i Tiranës Realizuar datë 26-27 tetor 2012 | |
| | | | 4. "Identity, Image & Social Cohesion in the time of Integrations and Globalization" Realizuar nga | "Quality in higher education as a necessity and a challenge because of the great increase of the number of students in the higher education" | Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe "Marin Barleti" Tiranë Realizuar 26-27 nëntor 2012, në Vlorë | |
| | | | 5. "Decentralization process in Republik of Macedonia main issues, trends and developments in the future" | "The management of immovable property, resources by the Local Government in Republic Albania" | Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare SEE-University – Tetovo and SEE-University – Skopje, R.Macedonia 25-26 janar 2013 | |
| | | | 6. The state, society and law: human rights' challenges, | Legal status of agricultural land in the Republic of Albania in the level of comparison. The problems that he brings. (RIGHT TO PROPERTY) | Aleksander Moisiu University of Durrës, Durrës-Tirana, 15-16 mars 2013 | |
| | | Institucionet Politiko-Juridike dhe e Drejta në 100 vjet Shtet të Pavarur Shqiptar. | | Legjislacioni dhe institucionet për realizimin e reformës mbi tokën bujqësore: Ligji bazë Nr.7501/1991 "Për Tokën" | Universiteti Luarasi Realizuar në datë 15 dhjetor 2012 | |
| 6 | Blendi Dibra | | 1. "Sfidat e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, 2011", | "Pjesëmarrja lokale në procesin e vendimarrjes | Fakulteti Ekonomik i Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkoder, 4 Nëntor 2011 | |
| | | | 2. "Te drejtat e njeriut në shekullin e XXI" | "Pjesëmarrja qytetare si një instrument i rëndësishëm për forcimin e demokracisë" | Universiteti Beder në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, 18-19 Maj 2012, | |
| | | | 3. "Towards future sustainable development" | "Public participation as important tool to promote sustainable development" | Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder, 16-17 November 2012 | |
| 7 | Resmi Hoxha | | | 1- Corrections in Post-Conflict Situation- Korrektimi i të burgosurve në Institucionet e Kosovës pas konfliktit të luftës 1999-2009, | Konferenca nga ICPA në bashkëpunim me Sherbimin e Burgjeve të Barbadosit – International Corrections and Prisons Association | |

| | | | | | | |
|----|-----------------|---|---|---|---|--|
| | | | | http://www.icpa.ca/ 2- Planifikimi i dënimit për të burgosur | (Asociacioni Nderkombëtar për Korrektues dhe Burgje), Bridgetown, Barbados prej dates 25 tetor deri me 30 th tetor 2009 . | |
| 8 | Pranvera Xhafa | 1. Shteti dhe drejtësia shqiptare në 100 vjet pavarësi. | | Ndërtimi i një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të ndërgjegjshëm – Garanci për funksionimin e shtetit të së drejtës. | Universiteti Europian i Tiranës. - Data e zhvilluar: 17 maj 2012. | |
| | | | 1.The process of decentralization in the Republic of Macedonia- Key issues, tendencies and developments in the future”. | Making use of IPA and International Funds. | Institute for political and international studies in collaboration with South-East European University of Tetovo and Skopje. January 25th – 26th 2013. | |
| | | | 2. Second international scientific conference “The state, society and law: human right’s challenges in Albania”. | Civil and political rights. | Faculty of Political Sciences and Law, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës and Faculty of Law, University “Luarasi”, Albania. - Data e zhvilluar: March 15th – 16th 2013. | |
| 9 | Rakel Mucaj | | | Shqipëria dhe pakicat kombëtare, etnike dhe kulturore. | Universiteti "Marin Barletit" dhe Institutit Shqiptar për çështjet publike, Tiranë | |
| | | | | The state, society and law: Human right's challenges in Albania. | Univeristet i Durrësit "Aleksandër Moisiu" dhe Univesiteti "Luarasi", Tiranë, | |
| 10 | Muhamet Berisha | Respektimi i të drejtave të njeriut në stacionet policore (dhomat e ndalimit) në Kosovë | | | Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, e mbeshtetur nga Zyra e Komisionerit të Lartë të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuar -Zyra në Prishtinë.Me 29.03.2013 në Prishtinë. | |
